FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 23	2000	Gusht

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr. 8636, datë 6.7.2000	Për Zonat e Lira	1139
Ligj nr.8643, datë 20.7.2000	Për Gradat në Policinë e Shtetit	1149
Ligj nr.8644, datë 20.7.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së Kredisë të Zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për Projektin e Reformës në Arsim"	1157
Ligj nr.8645, datë 20.7.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së Kredisë të Zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për Projektin e Asistencës Teknike për Sektorin Financiar"	1171
Ligj nr.8646, datë 20.7.2000	Për ratifikimin e "Konventës Europiane "Për Pastrimin, Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit"	1183
Ligj nr.8647, datë 20.7.2000	Për disa ndryshime në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha"	1200

Vendim i Kuvendit Nr.455, datë 24.7.2000	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	1201
Dekret nr.2705, Datë 28.7.2000	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të Organeve të Pushtetit Vendor	1202
Vendim i KM Nr.360, datë 14.7.2000	Për lirimin nga Shërbimi Civil	1202
Vendim i KM Nr.373, datë 14.7.2000	Për rivendosjen e sistemit të kujdestarëve dhe të rojeve, në objektet Monument Kulture	1204
Vendim i KM Nr.413, datë 27.7.2000	Për trajtimin e problemeve të ngritura nga familjet që u janë përmbytur tokat nga ujëmbledhësi i Hidrocentralit të Fierzës	1205
Vendim i Gj.K Nr.44	Me objekt: Shfuqizimin e vendimit nr.239, datë 23.6.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë	1207
Vendim i Gj.K Nr.45	Me objekt: Shfuqizimin e nenit nr.9, të ligjit nr.8578, datë 10.2.2000 "Për Teatrin"	1209
Vendim i Gj.K Nr.46	Me objekt: Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.338, datë 12.10.1999 të Kolegjit të Gjykatës së Lartë	1211
Vendim i Gj.K Nr.47	Me objekt: Shfuqizimin e pikave 2.2/4, 2.2/5 dhe 2.3/6 të V.K.M nr.217, datë 5.5.2000 "Për Kontrollin Financiar"	1213
Vendim i Gj.K Nr.48	Me objekt: Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.480, datë 22.12.1999 të Kolegjit të Gjykatës së Lartë	1218
Vendim i Gj.K Nr.49	Me objekt: Interpretimin e pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë	1221
Vendim i Gj.K Nr.50	Me objekt: Shfuqizimin si antikushtetues të V.K.M nr.260, datë 25.5.2000 "Për lirimin nga funksioni të kryetarit të Komunës Stavraj të rrethit Librazhd	1223
Vendim i Gj.L Nr.901	Me objekt: Detyrimin e Portit Detar Shëngjin të paguajnë shumën 2.450.000 lekë, si dhe interesin 5% mbi këtë shumë	1226
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të Nazmi Abduramanit	1232
	Kërkesë për shpallje të vdekur të Nastas Dhoskës	1233

L I G J
Nr.8636, datë 6.7.2000

PËR ZONAT E LIRA

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon krijimin, funksionimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zonave të lira, të drejtat dhe detyrimet e zhvilluesve, të përdoruesve dhe të subjekteve të tjerë që veprojnë në to, llojin e veprimtarive që kryhen brenda tyre, si dhe mënyrën e përcaktimit të trojeve e të kufijve.

Neni 2
Përkufizime

Për zbatimin e këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ent" është Enti Kombëtar i Zonave të Lira, i cili organizohet dhe e ushtron veprimtarinë sipas dispozitave të këtij ligji.

2. "Këshill Drejtues" është Këshilli Drejtues i Entit Kombëtar të Zonave të Lira, i cili ushtron veprimtarinë sipas dispozitave të këtij ligji.

3."Operator" është personi fizik ose juridik, privat ose shtetëror, vendas ose i huaj që vepron brenda kufijve të zonës së lirë me synim zhvillimin e veprimtarive të nevojshme për të nxitur, menaxhuar dhe administruar zonën e lirë në përputhje me marrëdhëniet kontraktuale midis tij dhe zhvilluesit

4. "Përdorues" është personi fizik ose juridik, i licencuar privat ose shtetëror, vendas ose i huaj, i cili investon dhe ushtron veprimtari ekonomike brenda zonës së lirë, sipas dispozitave të këtij ligji.

5. "Zonë e lirë" është një sipërfaqe e përcaktuar, e rrethuar dhe e mbrojtur trojesh, ndërtesash dhe pasurish të tjera të paluajtshme të veprimtarive prodhuese, të tregtimit dhe të shërbimeve, që konsiderohen pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, por që është i ndarë nga ky territor në aspektin e politikave tatimore e tregtare, të detyrimeve të import-eksportit dhe rregullohet sipas dispozitave të këtij ligji.

6. "Zhvillues" është çdo person fizik ose juridik i licencuar, privat ose shtetëror, vendas ose i huaj, i cili zhvillon dhe organizon ndërtimin dhe funksionimin e zonës së lirë, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 3
Qëllimi i krijimit të zonave të lira

Qëllimi i krijimit të zonave të lira në Shqipëri është që të ndikohet për:

a) zhvillimin e investimeve të reja në veprimtaritë e prodhimit për eksport;

b) futjen e teknologjisë së përparuar;

c) shpejtimin e lëvizjes së mallrave dhe kapitaleve;

ç) hapjen e vendeve të reja të punës dhe të ardhura në valutë;

d) përshpejtimin e zhvillimeve rajonale dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut shqiptar me atë ndërkombëtar.

Neni 4
Shpallja e zonave të lira

1. Në bazë të studimeve rajonale dhe të zhvillimit ekonomik të vendit, Enti, mbështetur në vendimin e Këshillit Drejtues, i paraqet Kryeministrit propozimin për krijimin e një zone të lirë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, miraton rast pas rasti shpalljen e një zone të lirë.

3. Shpallja e çdo zone të lirë përfshin:

a) kufijtë e zonës së lirë;

b) llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në të;

c) procedurat e krijimit dhe të funksionimit të zonës së lirë;

ç) kohën e funksionimit të zonës së lirë.

4. Veprimtaria ekonomike e zonës së lirë fillon pas përfundimit të ndërtimit të kufijve rrethues, të portave të hyrjes e të daljes dhe të funksionimit të pikës doganore.

5. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të kërkojë pranë Entit shpalljen zonë të lirë të një trualli ose pasurie të paluajtshme, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 5
Veprimtaritë e lejuara në zonat e lira

Në zonat e lira mund të kryhet çdo lloj veprimtarie ekonomike, që nuk cenon mjedisin, florën, faunën dhe pasuritë kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ZONAVE TE LIRA

Neni 6
Enti Kombëtar i Zonave të Lira

1. Për krijimin, zhvillimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zonave të lira organizohet dhe kryen veprimtarinë Enti Kombëtar i Zonave të Lira, i cili është person juridik me qendër në Tiranë.

2. Enti ndjek të gjitha procedurat ligjore që kanë të bëjnë me nxitjen, zhvillimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zonave të lira.

3. Organet drejtuese të Entit janë Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv.

4. Enti varet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7
Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues i Entit përbëhet nga 7 anëtarë. Kryetari i Këshillit Drejtues të Entit është anëtar i Këshillit të Ministrave. Kryetari i Këshillit Drejtues të Entit dhe Drejtori Ekzekutiv i Entit Kombëtar të Zonave të Lira emërohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Kyeministrit.

Këshilli Drejtues i Entit përbëhet nga:

a) Zëvendësministri i Financave;
b) Zëvendësministri që mbulon veprimtarinë e industrisë;
c) Zëvendësministri që mbulon veprimtarinë e tregtisë;
ç) Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;
d) Kryetari i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
dh) Drejtori Ekzekutiv i Entit Kombëtar të Zonave të Lira.
Enti Kombëtar i Zonave të Lira kryen funksionet e sekretarisë së Këshillit Drejtues të Entit.
2. Këshilli i Ministrave bën zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues kur:
a) janë në pamundësi fizike ose mendore për të kryer detyrat;
b) ndryshojnë marrëdhëniet e punësimit me institucionin që e ka zgjedhur;
c) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
ç) japin dorëheqjen.

Neni 8
Kompetencat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës për drejtimin dhe funksionimin e Entit. Këshilli Drejtues e zhvillon veprimtarinë e vet përmes mbledhjeve të anëtarëve. Ai mblidhet sa herë është e nevojshme dhe jo më pak se një herë në tre muaj.

2. Kompetencat kryesore të Këshillit Drejtues janë:

a) Organizon, vlerëson, programon dhe mbikëqyr të gjithë punën e Entit.

b) Miraton dhe kontrollon buxhetin vjetor të Entit, duke vlerësuar veprimtarinë ekonomike të tij.

c) Bën rekomandime në lidhje me strukturën organizative të Entit, të cilat nëpërmjet Entit i paraqiten për miratim Këshillit të Ministrave.

ç) Shqyrton procedurën e licencimit të zhvilluesve dhe të përdoruesve të zonave të lira dhe nëpërmjet Entit ia kalon për miratim Këshillit të Ministrave.

d) Vlerëson kërkesat e zhvilluesve dhe të përdoruesve për të ushtruar veprimtari në zonat e lira.

dh) Bën rekomandime në lidhje me kërkesat për zhvilluesit dhe nëpërmjet Entit ia paraqet Këshillit të Ministrave.

e) Miraton dhënien e licencave të përdoruesit.

ë) Shqyrton rregulloren e zonës së lirë dhe nëpërmjet Entit ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

f) Mbikëqyr zbatimin e kushteve të licencave dhe të kërkesave të kontratave nga zhvilluesit dhe përdoruesit.

Neni 9
Pagesat, shpërblimet dhe kufizimet për anëtarët e Këshillit Drejtues

1. Pagesat dhe shpërblimet për Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të Entit caktohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Gjatë afatit të kryerjes së detyrave, asnjëri nga anëtarët e Këshillit Drejtues nuk lejohet të ushtrojë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, veprimtari ekonomike në zonat e lira. Ky kufizim shtrihet edhe mbi pjesëtarët e tjerë të familjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues, të përcaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10
Struktura organizative e Entit Kombëtar të Zonave të Lira

1. Struktura organizative e Entit miratohet nga Këshilli i Ministrave. Veprimtaria e Entit mbeshtetet në Rregulloren e funksionimit te tij.

2. Drejtori ekzekutiv raporton para Këshillit Drejtues për veprimtarinë e Entit, përfaqëson Entin me të tretët dhe nënshkruan kontratat që lidhen me zhvilluesit.

Neni 11
Kompetencat e Entit Kombëtar të Zonave të Lira

Enti, si organ ekzekutiv, ka këto kompetenca:

1. Nxit dhe ndihmon zhvilluesit dhe përdoruesit për krijimin, zhvillimin, drejtimin dhe funksionimin e zonave të lira në Shqipëri.

2. Përgatit procedurën e licencimit të zhvilluesve dhe të përdoruesve në zonat e lira dhe ia paraqit për shqyrtim Këshillit Drejtues.

3. Pranon dhe vlerëson kërkesat e zhvilluesve që janë të interesuar të zhvillojnë zona të lira. I propozon Këshillit Drejtues kandidatët-zhvillues të një zone të lirë.

4. Pranon dhe vlerëson kërkesat e përdoruesve, të interesuar të zhvillojnë veprimtari ekonomike në një zonë të lirë dhe ia paraqet për miratim Këshillit Drejtues.

5. Mbikëqyr dhe kontrollon zhvillimin, funksionimin dhe drejtimin e zonës së lirë.

6. Bashkëpunon me institucionet qendrore e vendore dhe me agjenci të tjera shtetërore, për të lehtësuar veprimtaritë e zhvilluesve dhe përdoruesve në zonat e lira.

7. Harton Rregulloren e Funksionimit të Zonave të Lira dhe ia paraqet për shqyrtim Këshillit Drejtues.

Neni 12
Rregulloret

1. Këshilli i Ministrave miraton Rregulloren e Funksionimit të Zonave të Lira, e cila përcakton procedurat e përzgjedhjes së zhvilluesve, procedurat e licencimit të përdoruesve, detyrimet e zhvilluesve dhe të përdoruesve në zonat e lira dhe rregullat e funksionimit të Këshillit Drejtues.

2. Këshilli Drejtues miraton Rregulloren e Funksionimit të Entit.

KREU III
MARRËDHËNIET ME ZHVILLUESIT DHE PËRDORUESIT,
TAKSAT DHE LEHTËSITË

Neni 13
Trualli në zonën e lirë

Ndërtimi i zonave të lira mund të bëhet në truall dhe në pasuri të tjera të paluajtshme, qofshin këto private ose shtetërore. Zhvilluesi, në të dyja rastet, miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14
Shpronësimi dhe garancia ndaj shpronësimit

1. Trualli dhe pasuritë e tjera të paluajtshme, të nevojshme për krijimin, zhvillimin dhe funksionimin e një zone të lirë, mund të shpronësohen, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

2. Ndërtimet në zonat e lira ose në zonat e lira të zhvilluara nga sektori privat nuk shpronësohen.

Neni 15
Zona e lirë në truall shtetëror

Në rastin kur trualli ose pasuritë e tjera të paluajtshme janë në pronësi shtetërore:

a) kandidati zhvillues i nënshtrohet procedurës së tenderimit;

b) zhvilluesi merr me qira truallin ose pasuritë e tjera të paluajtshme deri në 35 vjet dhe gëzon të drejtën e dhënies me nënqira për përdoruesit;

c) zhvilluesi merr në koncesion truallin ose pasuritë e tjera të paluajtshme, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet” dhe gëzon të drejtën e dhënies me qira për përdoruesit.

Neni 16
Zona e lirë në truall privat

1. Në rastin kur trualli ose pasuritë e tjera të paluajtshme janë në pronësi private, kandidati zhvillues paraqet kërkesën pranë Entit për shpalljen e zonës së lirë, pasi ka përcaktuar marrëdhëniet me pronarin e tyre.

2. Marrëdhëniet që lindin ndërmjet zhvilluesit dhe pronarit të truallit ose të pasurive të tjera të paluajtshme, nuk janë objekt i këtij ligji.

Neni 17
Legjislacioni i zbatueshëm

Në zonat e lira zbatohet legjislacioni shqiptar.

Neni 18
Përjashtimet nga detyrimet fiskale

1. Mallrat që sillen në zonën e lirë nga personat e licencuar dhe shërbimet që iu kryhen atyre brenda zonës së lirë përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vleren e shtuar.

2. Përjashtimi nga detyrimet doganore e tatimore, sipas pikës 1 të këtij neni, fillon që nga çasti i licencimit.

3. Personat që ushtrojnë veprimtari brenda zonës së lirë nuk paguajnë tatim mbi fitimin për 10 vitet e para të veprimtarisë së tyre që nga koha e licencimit.

Neni 19
Hyrja e mallrave dhe e shërbimeve në zonën e lirë

1. Mallrat që hyjnë në zonën e lirë dhe shërbimet që kryhen brenda saj, përfitojnë përjashtimet e përmendura në këtë ligj.

2. Mallrat që hyjnë në zonën e lirë i nënshtrohen kontrollit doganor në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor dhe rregullat për zbatimin e tij.

3. Mallrat, që sillen në zonën e lirë nga një pjesë tjetër e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe nuk janë në tranzit në zonën e lire, përfitojnë të gjitha lehtësitë që zbatohen për mallrat e eksportit.

4. Shërbimet e infrastrukturës që ofrohen nga pjesa tjetër e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për zhvilluesit dhe përdoruesit e licencuar brenda zonës së lirë, përfitojnë të gjitha lehtësitë që zbatohen për eksportin e shërbimeve.

Neni 20
Dalja e mallrave dhe shërbimeve nga zona e lirë

1. Mallrat që dalin nga një zonë e lirë mund të jenë:

a) eksporte ose rieksporte, kur dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) hyrje në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Mallrat që hyjnë nga zona e lirë në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe nuk janë tranzit për një shtet tjetër:

a) hidhen në qarkullim të lirë në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet e importit. Kur këto mallra janë përftuar nga përpunimi në zonën e lirë, me përbërës nga tregu i brendshëm, vlera e këtyre përbërësve zbritet nga vlera e produkteve të përftuara prej tyre përsa i përket detyrimeve doganore. Taksat dhe tatimet e tjera zbatohen mbi vlerën e plotë;

b) futen në njërën nga procedurat e tjera doganore ose lloje të tjera destinacioni doganor.

3. Origjina e mallrave, që dalin nga zona e lirë, përcaktohet në përputhje me Kodin Doganor të

Republikës së Shqipërisë.

Neni 21
Mallrat për përdorim vetjak në zonën e lirë

Mallrat që vendosen në zonë për përdorim ose konsum vetjak u nënshtrohen të gjitha detyrimeve doganore dhe tatimore para hyrjes në zonën e lirë.

Neni 22
Vendosja e mallrave brenda zonës së lirë

1. Në zonat e lira hyjnë të gjithë mallrat pavarësisht nga natyra, cilësia, origjina, prejardhja ose vendmbërritja e tyre, përveç atyre për të cilat ndalohet nga autoritetet përkatëse importimi, eksportimi ose tranzitimi nëpër territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Kur mallrat që kanë hyrë në një zonë të lirë humbasin pa një shpjegim të arsyeshëm, drejtoria e doganës së zonës të lirë i kërkon subjektit të licencuar të paguajë detyrimin për këto mallra sipas tarifave në fuqi në kohën e hyrjes në zonë dhe shtesën e ndonjë gjobe të detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23
Pagesat

Pagesat, që lidhen me veprimtarinë e personave fizikë dhe juridikë që veprojnë brenda zonës së lirë, mund të kryhen me monedhën e vendit ose me monedhë të huaj.

KREU IV
LICENCAT

Neni 24
Licencimi

1. Asnjë person fizik ose juridik nuk mund të ndërtojë, të zhvillojë, të verë në funksionim ose të drejtojë një zonë të lirë pa licencën e zhvilluesit, të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe të lëshuar nga Enti.

2. Asnjë person fizik ose juridik nuk mund të ushtrojë veprimtari ekonomike pa licencën e përdoruesit, të miratuar dhe të lëshuar nga Enti.

Neni 25
Paraqitja e kërkesës për licencë

1. Çdo person fizik ose juridik mund të paraqesë kërkesën për licencë zhvilluesi ose përdoruesi. Paraqitja e kërkesës për licencë zhvilluesi ose përdoruesi duhet të bëhet me shkrim dhe t'i adresohet Entit dhe të shoqërohet me të gjitha të dhënat e kërkuara prej tij.

2. Çdo person fizik ose juridik i licencuar mund të paraqesë kërkesën për t'u rilicencuar ose për të përsëritur licencën, sipas procedurave përkatëse.

Neni 26
Dhënia e licencës

1. Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave, për dhënie ose heqje të licencës zhvilluesit, Këshilli Drejtues jep ose jo licencën cilitdo personi fizik ose juridik që ka paraqitur kërkesën për të ndërtuar, për të zhvilluar dhe për të vënë në funksionim ose drejtuar një zonë të lirë.

2. Këshilli Drejtues i jep ose jo licencën e përdoruesit çdo personi fizik ose juridik që ka paraqitur kërkesën, për të ushtruar veprimtari të lejuar në një zonë të lirë.

Neni 27
Kushtet që i bashkëlidhen licencës

1. Këshilli Drejtues, me miratimin e Këshillit të Ministrave, mund t'i bashkëlidhë licencës së zhvilluesit kushte që ai i gjykon të nevojshme. Kushtet specifikohen në kontratë.

2. Këshilli Drejtues mund t'i bashkëlidhë licencës së përdoruesit kushte, të cilat ai i gjykon të nevojshme. Kushtet specifikohen në kontratë.

3. Licencat e zhvilluesit dhe të përdoruesit nuk tjetërsohen.

Neni 28
Heqja ose ndryshimi i licencës

1. Këshilli Drejtues, me miratimin e Këshillit të Ministrave, ia heq licencën zhvilluesit kur:

a) pushon së vepruari zona e lirë;

b) vërtetohet se i licencuari nuk respekton kushtet e licencës;

c) vërtetohet se i licencuari ka kryer shkelje të ligjeve doganore ose të rregullores së zonës së lirë;

ç) shpallet falimentimi i të licencuarit;

d) vërtetohet se i licencuari nuk ka shlyer detyrimet ndaj shtetit;

dh) mbaron afati i licencës dhe nuk është bërë kërkesë për licencim;

e) një institucion shtetëror kontrolli kërkon heqjen e licencës.

2. Këshilli Drejtues ia heq licencën përdoruesit kur:

a) pushon së vepruari zona e lirë;

b) vërtetohet se i licencuari nuk ka respektuar kushtet e licencës;

c) vërtetohet se i licencuari ka kryer shkelje të ligjeve doganore ose të rregullores së zonës të lirë;

ç) shpallet falimentimi i të licencuarit;

d) vërtetohet se i licencuari nuk ka shlyer detyrimet ndaj shtetit;

dh) mbaron afati i licencës dhe nuk është bërë kërkesë për rilicencim;

i licencuari vendos të largohet nga zona e lirë me kërkesën e tij;

ë) një institucion shtetëror kontrolli kërkon heqjen e licencës.

3. I licencuari duhet të marrë njoftim nga Enti 30 ditë përpara heqjes së licencës së zhvilluesit ose përdoruesit për arsyet e këtij vendimi.

4. Këshilli Drejtues, me miratimin e Këshillit të Ministrave, ndryshon kushtet e licencës së zhvilluesit me kërkesën e vetë zhvilluesit.

5. Këshilli Drejtues mund të ndryshojë kushtet e licencës së përdoruesit me kërkesën e vetë përdoruesit.

Neni 29
Regjistri i Licencave

Enti mban një regjistër për licencat e lëshuara për zhvilluesit dhe përdoruesit, ku shënohen emri i të licencuarit, biznesi ose veprimtaria e lejuar me licencë dhe kushtet që i bashkëlidhen licencës.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 30
Kontabiliteti

1. Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike në zonën e lirë, mbajnë kontabilitet në bazë të dispozitave të ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin" dhe të kërkesave të doganës, si dhe zbatojnë dispozitat për kontrollin ligjor të llogarive.

2. Ky kontabilitet vihet në dispozicion të organeve doganore dhe tatimore, për të ushtruar kontroll sa herë që këto të fundit e shohin të nevojshme.

Neni 31
Financimi

1. Enti Kombëtar i Zonave të Lira financohet nga buxheti i shtetit. Përveç financimit nga buxheti, Enti mund të përdorë edhe :

a) pagesat e arkëtuara për dhënien e licencave;

b) pagesat e parashikuara nga kontratat e lidhura me personat fizikë dhe juridikë që veprojnë në zonat e lira;

c) të ardhura të tjera.

2. Mënyra e ndarjes së të ardhurave në favor të Entit të realizuara nga burimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 32
Bashkëpunimi me autoritetet doganore dhe tatimore

Enti bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 33
Ushtrimi i kompetencave

Këshilli Drejtues i Entit Kombëtar të Zonave të Lira, i caktuar sipas ligjit nr.8072, datë 15.2.1996 "Për zonat e lira", do të ushtrojë kompetencat e parashikuara në këtë ligj deri në emërimin e Këshillit të ri Drejtues, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Neni 34
Zbatimi

Ngarkohet Enti Kombëtar i Zonave të Lira, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij ligji.

Neni 35
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshjesh ndërmjet përdoruesit dhe zhvilluesit ose organizmave të tjerë, palët bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhje me bisedime. Në rast të kundërt palët i drejtohen, sipas rastit, gjykatës kompetente e cila ka në juridiksion zonën e lirë ose Qendrës për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve për Investime (konventa ICSID).

Neni 36
Shfuqizim

Ligji nr.8072, datë 15.2.1996 "Për zonat e lira" shfuqizohet.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2709, datë 28.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8643, datë 20.7.2000

PËR GRADAT NË POLICINË E SHTETIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi i ligjit

1. Objekt i këtij ligji është kuptimi dhe sistemi i gradave si shprehje e hierarkisë në Policinë e Shtetit.

2. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i gradave për çdo rol, kriteret për fitimin e gradës, si dhe ecuria në karrierë e punonjësit të policisë në përputhje me statusin institucional të miratuar në ligjin nr. 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

Neni 2
Përkufizime

Për zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Grada" është shprehje e nivelit të ndërmjetëm brenda rolit që përmban cilësitë dhe ushtrimin e funksioneve në përputhje me hierarkinë në strukturën e Policisë së Shtetit.

2. "Roli" është grupimi i niveleve të njëpasnjëshme të gradave, që shpreh raportet themelore hierarkike të Policisë së Shtetit.

Neni 3
Kriteret për fitimin e gradës

Gradat për punonjësit e Policisë së Shtetit fitohen sipas arsimit, vjetërsisë në shërbim, kualifikimit profesional dhe karrierës në strukturat e policisë.

Neni 4
Vjetërsia për efekt gradimi

1. Vjetërsia për efekt gradimi llogaritet nga data e daljes së urdhrit për gradim.
2. Ndërprerja e karrierës për shkak të paaftësisë shëndetësore, qëndrimit në dispozicion ose pezullimit për më shumë se 6 muaj, nuk llogaritet si vjetërsi për efekt gradimi. Kur qëndrimi në dispozicion ose pezullimi kanë qenë rezultat i një urdhri ose vendimi të paligjshëm ose të padrejtë, koha e ndërprerjes rillogaritet si vjetërsi për efekt gradimi.
3. Periudha e paaftësisë shëndetësore deri 12 muaj, shkaktuar në ushtrim ose për shkak të detyrës, njihet si vjetërsi për efekt gradimi.

Neni 5
Ndarja e gradave sipas roleve

Në Policinë e Shtetit përcaktohen gradat sipas roleve si vijon:
a) Roli bazë:
- agjent,
- agjent i parë,
- asistent,
- asistent i parë,
- kryeasistent.

b) Roli i mesëm:
- nëninspektor,
- inspektor,
- kryeinspektor.

c) Roli i lartë:
- nënkomisar,
- komisar,
- kryekomisar.

ç) Roli madhor:
- drejtues,
- drejtues i parë.

Neni 6
Hierarkia e roleve dhe gradave

1. Hierarkia midis pjesëtarëve në role përcaktohet si vijon:
Drejtues, komisar, inspektor, asistent-agjent.
2. Përbërja e secilit rol, sipas përkatësisë së shërbimit ndahet në:
aktiv/operues, administrativ, shkencor dhe teknik.
3. Brenda rolit hierarkia përcaktohet nga grada dhe për të njëjtën gradë nga vjetërsia ose nga funksioni.

Neni 7
Përcaktimi i funksioneve për gradë

Funksionet organike që mbulohen nga punonjësit e Policisë së Shtetit, sipas gradave të cilat fitohen në bazë të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8
Paraqitja formale

Forma dhe ndërtimi i secilës gradë për punonjësit e Policisë së Shtetit, caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Punonjësit e Policisë në pension (ose në rezervë) kanë të drejtë të mbajnë uniformë me gradën e fundit të fituar, të cilën mund ta përdorin në raste festash zyrtare.

KREU II
PËRBËRJA E ROLEVE

Neni 9
Ndarja në rolin bazë

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit në rolin bazë kryen detyra ekzekutive dhe me iniciativë të kufizuar, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe kualifikimin që ka vetë personeli që i përket këtij roli. Agjentëve të parë dhe asistentëve mund t'u jepen detyra që kanë të bëjnë me komandimin ose drejtimin e një ose më shumë agjentëve ose të njësive të vogla operative.

2. Gradimet në këtë rol bëhen sipas kualifikimit, aftësisë vetjake dhe vjetërsisë si më poshtë:

- Nga agjent në agjent i parë 4 vjet
- Nga agjent i parë në asistent 5 vjet
- Nga asistent në asistent i parë 5 vjet
- Nga asistent i parë në kryeasistent 10 vjet

Neni 10
Fitimi dhe ecuria në gradat e rolit bazë

1. Grada agjent, jepet pas përfundimit të kursit të formimit në Institutin e Policisë. Nga agjent në agjent i parë, gradimi bëhet sipas vjetërsisë së shërbimit dhe vlerësimit të punës "mirë". Për gradat asistent deri në kryeasistent, gradimi bëhet sipas vjetërsisë së shërbimit dhe me konkurrim në bazë të vendeve të disponueshme.

2. Konkurruesit për gradën më të lartë të radhës sigurohen nga punonjësit e Policisë së Shtetit që kanë plotësuar afatin maksimal të qëndrimit në gradën paraardhëse.

3. Për 20 për qind të vendeve të disponueshme të punës mund të konkurrojnë, me përzgjedhje, sipas vlerësimit periodik të punës "shumë mirë" edhe personel nga rradhët e punonjësve që kanë plotësuar jo më pak se dy të tretat e kohës së qëndrimit në atë gradë.

4. Gradimet për rolin bazë bëhen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, me propozimin e komisionit përkatës të gradimeve.

Neni 11
Ndarja në rolin e mesëm

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit që bën pjesë në rolin e mesëm të inspektorëve, kryen detyra specifike që i referohen veprimtarisë gjurmuese hetimore, instruktimit dhe stërvitjes profesionale të agjentëve dhe asistentëve, si dhe i atribuohen funksione të drejtimit dhe bashkërendimit të njësive operative.

2. Gradimi në rolin e mesëm bëhet sipas arsimit, kualifikimit, aftësive vetjake dhe vjetërsisë në shërbim si më poshtë:

- Nga nëninspektor në inspektor 4 vjet
- Nga inspektor në kryeinspektor 5 vjet

Neni 12
Fitimi dhe ecuria për gradat në rolin e mesëm

1. Në rolin e mesëm pranohen ata që kanë fituar titullin “specialist i lartë policie” pasi kanë kryer Akademinë e Policisë, ata që kanë kryer shkolla të tjera të njëvlefshme me Akademinë e Policisë, si dhe ata që kanë kryer shkolla të tjera të larta dhe kanë konkurruar e fituar kursin përkatës të kualifikimit, me kohëzgjatje jo më pak se 4 muaj për punonjës policie. Mund të pranohen, edhe personel nga roli bazë, kur kanë përfunduar Akademinë e Policisë dhe nuk janë titulluar “oficer” sipas ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 “Për Policinë e Rendit”.

2. Grada nëninspektor jepet menjëherë pas përfundimit të Akademisë së Policisë, ose pas përfundimit dhe ekuivalentimit për ata që kanë mbaruar shkolla të tjera të njëvlefshme me Akademinë e Policisë, si dhe të kursit të kualifikimit për ata që kanë kryer shkolla të tjera të larta.

3. Gradimet e tjera brenda rolit bëhen sipas vjetërsisë, vlerësimit të përgjithshëm të punës “mirë”, pas shqyrtimit në komisionin përkatës të gradimeve.

4. Për 10 për qind të vendeve të disponueshme të punës për çdo gradë mund të konkurrojnë, me përzgjedhje, sipas vlerësimit periodik të punës “shumë mirë” edhe personel nga radhët e punonjësve që kanë plotësuar jo më pak se dy të tretat e kohës së qëndrimit në atë gradë.

Neni 13
Ndarja e rolit të lartë

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit që bën pjesë në rolin e lartë kryen detyra në funksione drejtimi të organeve, reparteve e sektorëve.

2. Kalimi në rolin e lartë, përkatësisht fitimi i gradës së nënkomisarit bëhet pas përfundimit të kursit të kualifikimit me kohëzgjatje jo më pak se 3 muaj. Gradimi në rolin e lartë bëhet duke pasur si kriter themelor vlerësimin e përgjithshëm të punës “mirë”, arsimin, kualifikimin, aftësitë profesionale dhe vjetërsinë në shërbim, si më poshtë:

- Nga kryeinspektor në nënkomisar5 vjet
- Nga nënkomisar në komisar4 vjet
- Nga komisar në kryekomisar5 vjet

3. Për 10 për qind të vendeve të disponueshme të punës mund të konkurrojnë, me përzgjedhje, sipas vlerësimit periodik të punës “shumë mirë” edhe personel nga radhët e punonjësve që kanë plotësuar jo më pak se dy të tretat e kohës së qëndrimit në gradën e kryeinspektorit.

4. Për gradë më të lartë, brenda këtij roli, mund të konkurrojnë për 10 për qind të vendeve të disponueshme të punës, me përzgjedhje, sipas vlerësimit të përgjithshëm të punës “shumë mirë” edhe personel nga rradhët e punonjësve që kanë plotësuar jo më pak se dy të tretat e vjetërsisë për gradën që mbajnë.

Neni 14
Gradimi për rolin e mesëm dhe të lartë

Gradimi për gradat në rolin e mesëm dhe të lartë bëhet me urdhër të Ministrit të Rendit Publik në bazë të propozimit të komisionit përkatës të gradimit dhe vendeve të disponueshme të punës.

Neni 15
Gradat në rolin madhor

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit në rolin madhor kryejnë detyra të drejtimit, bashkërendimit e të kontrollit të strukturave të Policisë së Shtetit, që janë nën varësinë e tyre. Ky personel përzgjidhet nga radhët e kryekomisarëve. Kalimi nga kryekomisar në drejtues dhe nga drejtues në drejtues i parë bëhet pa afat kohor të përcaktuar.

2. Gradimet në rolin madhor bëhen me dekret të Presidentit të Republikës, me propozim të Ministrit të Rendit Publik dhe me miratim të Kryeministrit.

3. Kalimi në rolin madhor, përkatësisht fitimi i gradës drejtues, bëhet pas përfundimit të një kursi kualifikimi me afat jo më pak se 3 muaj. Nëpërmjet këtij kursi duhet të arrihet formimi më i plotë profesionalo-teknik, duke e plotësuar këtë me kulturën juridike dhe parimet e drejtimit, të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të larta drejtuese. Procedurat e funksionimit të kursit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16
Organizimi i konkurrimeve

1. Konkurrimet për fitimin e gradave zhvillohen çdo vit me urdhër të Ministrit të Rendit Publik. Në këtë urdhër përcaktohet numri i vendeve të disponueshme për çdo gradë, afatet e paraqitjes dhe të pranimit të kërkesës, si dhe procedurat e zhvillimit të konkurrimit.

2. Shpallja e fituesve bëhet nga komisioni përkatës i gradimeve.

3. Kurset e kualifikimit, afatet dhe procedurat për zhvillimin e tyre për çdo rol përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17
Komisionet e gradimeve

1. Përbërja dhe procedurat e Komisionit të Gradimeve për rolin bazë miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe komisioni kryesohet nga Drejtori i Drejtorisë së Policisë së Qarkut.

2. Përbërja dhe procedurat e Komisionit të Gradimeve për rolin e mesëm dhe të lartë miratohen nga Ministri i Rendit Publik, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe komisioni kryesohet nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë. Ky komision propozon edhe për gradimet e rolit bazë për personelin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe të institucioneve, organeve e reparteve në varësi të drejtpërdrejtë të saj.

3. Komisioni i gradimeve për rolin madhor përbëhet nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë, anëtarët e Shtabit të Policisë dhe punonjës që mbulojnë funksione të larta drejtuese në Ministrinë e Rendit Publik dhe të Policisë së Shtetit. Përbërja dhe procedurat e komisionit miratohen nga Ministri i Rendit Publik dhe komisioni kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

4. Komisionet e gradimeve, si rregull, mblidhen tremujorin e fundit të çdo viti dhe jo më vonë se muaji i parë i vitit pasardhës.

Neni 18
Shkallët e vlerësimeve për fitimin e gradave

1. Për punonjësit e Policisë së Shtetit me gradë më të ulët se kryekomisar, brenda muajit janar të çdo viti hartohet një “vlerësim vjetor”, i cili mbyllet me gjykimin përmbledhës “shumë i mirë”, “i mirë”, “i mjaftueshëm” dhe “i pamjaftueshëm”.

2. Parametrat e gjykimit dhe elementet e vlerësimit, koeficientët numerikë përkatës për çdo element vlerësimi, organi kompetent që bën “vlerësimin vjetor”, organi kompetent për dhënien e gjykimit përmbledhës, si dhe mënyra e hartimit të “vlerësimit vjetor” përcaktohen në “Rregulloren e personelit të Policisë së Shtetit”.

3. Organi kompetent, që duhet të shprehet për gjykimin përmbledhës, duke motivuar mund të ndryshojë koeficientët numerikë përkatës për çdo element të veçantë vlerësimi.

4. Vlerësimi vjetor dhe vlerësimi i përgjithshëm i bëhen të ditur punonjësit të interesuar, i cili mund të bëjë ankim në shkallë hierarkike brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim.

Neni 19
Humbja e të drejtës për konkurrim

Punonjësit e Policisë së Shtetit, që në vitin e fundit janë ndëshkuar me masën disiplinore më të rëndë se dënimi me gjobë ose një vlerësim të përgjithshëm më pak se "mirë", humbasin të drejtën e konkurrimit për gradën më të lartë të radhës.

KREU III
GRADAT PËR FUNKSIONET E VEÇANTA ADMINISTRATIVE,
SHKENCORE E TEKNIKE

Neni 20
Përcaktimi i funksioneve të roleve administrative, shkencore e teknike

Funksionet administrative, shkencore e teknike janë pjesë përbërëse e strukturave mbështetëse të Policisë së Shtetit, atyre ekonomike dhe administrative. Funksione të veçanta caktohen edhe brenda strukturave aktive/operuese.

Neni 21
Pranimi dhe fitimi i gradave

1. Pranimi dhe fitimi i gradave të personelit që do të punojë në funksionet e parashikuara sipas nenit 20 të këtij ligji, bëhet në përputhje me veçoritë e funksionit organik, të miratuara me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

2. Arsimi, cilësitë profesionale dhe përvoja në punë e kandidatëve që do të punojnë në funksione, që kërkojnë njohuri të posaçme teknike dhe shkencore, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Grada fillestare për personelin që do të punojë në këto funksione do të jetë ajo e miratuar për atë funksion.

Neni 22
Kalimi nga shërbimet aktive/operuese dhe ecuria në gradë

1. Në funksione të shërbimeve administrative dhe teknike, për aq sa është në përputhje me veçoritë e funksionit organik, punojnë dhe punonjës policie të shërbimit aktiv/operues, që kanë kryer formim dhe kualifikim profesional ose plotësues në institutet dhe Akademinë e Policisë.

2. Kalimi në funksionet e parashikuara në shkronjën "a" të këtij neni bëhet kur grada për funksion është e njëjtë me atë që gëzon punonjësi në çastin e kalimit. Ecuria në gradë në këto funksione bëhet sipas kritereve të parashikuara në kreun II të këtij ligji.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 23
Vënia në dispozicion në rolin madhor

1. Pjesëtarët e rolit madhor të Policisë së Shtetit, kur e kërkojnë interesat e shërbimit, mund të vihen në dispozicion të Ministrisë së Rendit Publik. Vënia dhe koha e qëndrimit në dispozicion përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pjesëtarët e rolit madhor në dispozicion nuk mund të jenë më shumë se dy për çdo gradë dhe për një periudhë jo më shumë se 12 muaj.

Neni 24
Ruajtja e gradës jashtë strukturave të Policisë së Shtetit

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit, që mund të punojnë në strukturat e administratës qendrore ose në prefektura me cilësinë e këshilltarit ose në funksione të ngjashme më të për probleme të rendit dhe të sigurisë publike, ruajnë gradën që kanë.

2. Punonjësit, që do të punojnë në strukturat e parashikuara në shkronjën "a" të këtij neni përzgjidhen nga ata që kanë fituar gradën komisar e lart.

3. Periudha kohore në këto institucione, e cila nuk duhet t'i kalojë 4 vjet, llogaritet në kohën e vjetërsisë për gradë.

Neni 25
Rifitimi i gradës

Punonjësit e Policisë së Shtetit, që rimerren në polici, marrin gradë sipas vjetërsisë së shërbimit, të arsimit e kualifikimit dhe të funksionit për të cilin konkurrojnë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 26
Parimet e inkuadrimit dhe afatet

1. Për efekt të zbatimit të këtij ligji, si vjetërsi shërbimi llogaritet e gjithë periudha e njohur si vjetërsi shërbimi ushtarak, sipas ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit". Për rolin e lartë dhe madhor, si vjetërsi gjatë inkuadrimit llogaritet koha e punës në strukturat e policisë.

2. Kualifikimi i punonjësit të Policisë duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara për rolin në të cilin përfshihet funksioni.

3. Karriera vlerësohet në vite shërbimi dhe në funksione të mbuluara në strukturat e Ministrisë së Rendit Publik.

4. Funksioni përcaktohet si detyra që mbulon ose ka mbuluar punonjësi i policisë në strukturat e Ministrisë së Rendit Publik.

5. Për plotësimin e vendeve të punës të disponueshme për çdo gradë, afatet e inkuadrimit të personelit në çdo gradë, brenda të njëjtit rol janë jo më shumë se 3 vjet dhe jo më pak se sa koha e nevojshme për kryerjen e kursit të kualifikimit ose atij plotësues. Brenda këtyre afateve punonjësi i Policisë së Shtetit mund të fitojë gradën sipas funksionit dhe, nëse nuk arrin të kualifikohet caktohet në funksion më të ulët, duke marrë gradën korresponduese të funksionit të ri.

6. Kur punonjësi i policisë mban një gradë më të lartë që nuk përputhet me vjetërsinë për gradë, inkuadrimi sipas këtij ligji bëhet duke i dhënë gradën më të ulët të funksionit kur vjetërsia në shërbim nuk është më pak se dy të tretat e gradës korresponduese.

7. Kur punonjësi i policisë mban gradë më të ulët dhe sipas vjetërsisë e arsimit i takon gradë më e lartë, atëherë merr gradën përkatëse që fiton sipas kritereve të këtij ligji.

8. Kur punonjësi i policisë kryen një funksion që në bazë të vjetërsisë, arsimit, karrierës dhe parimeve të tjera të parashikuara nga ky ligj i takon një grade që nuk përputhet me funksionin që mbulon, inkuadrimi bëhet me gradën sipas këtij ligji dhe mund t'i lihet një afat deri në 3 vjet që të konkurrojë për gradën sipas funksionit kur grada që mban është e një niveli më të ulët se grada korresponduese për funksion. Kur grada që mban është e një niveli më të lartë se ajo korresponduese për funksion, mbi bazën e vlerësimit periodik të punës "shumë mirë", për dy vitet e fundit, punonjësi i policisë mund të caktohet në një funksion që përputhet me gradën e fituar sipas parimeve të parashikuara në këtë ligj. Në asnjë rast funksioni nuk mund të jetë më i lartë se një shkallë për gradën korresponduese.

Neni 27
Mbajtja e gradës

Këshilli i Ministrave në kuadrin e miratimit të strukturës së Ministrisë së Rendit Publik përcakton funksione dhe të drejtën e mbajtjes së gradës për secilin funksion.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2710, datë 28.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8644, datë 20.7.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E REFORMËS NË ARSIM"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e Kredisë së Zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e reformës në arsim".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2706, datë 28.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

NUMRI I KREDISË 3343 ALB

MARRËVESHJE KREDIE PËR ZHVILLIM

Marrëveshja, e arritur më datën 8 Qershor 2000, midis Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata).

Ndërsa Huamarrësi, pasi është bindur për përshtatshmërinë dhe prioritetin e Projektit të përshkruar në Shtesën 2 të kësaj Marrëveshje, i ka kërkuar Shoqatës të ndihmojë për financimin e Projektit.

Ndërsa Shoqata ka rënë dakord, midis të tjerash, për sa më sipër për t'i dhënë këtë kredi

Huamarrësit sipas kushteve dhe afateve që parashikohen në këtë Marrëveshje.

Palët kanë rënë dakord si pasojë për sa vijon :

Neni 1
Kushtet e Përgjithshme; Përcaktimet

Seksioni 1.01. "Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjeve të Kredisë së Zhvillimit" të Shoqatës të datës 1 Janar, 1985 (e modifikuar deri më 2 Dhjetor, 1997), me modifikimet e përcaktuara më poshtë (Kushtet e Përgjithshme) të cilat përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje:

(a) Një paragraf i ri (c) i është shtuar Seksionit 3.04 dhe lexon si më poshtë:

"Nëse Shoqata në çfarëdo kohë merr më pak se pagesa e plotë që i takon dhe që paguhet nën Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit, Shoqata ka të drejtë të alokojë dhe të përdorë shumën e marrë në çdo mënyrë dhe për ato qëllime të Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit, për të cilat Shoqata ka të drejtë të marrë vendim për të vendosur", dhe

(b) Seksioni 11.01 është modifikuar duke e zëvendësuar, në fjalinë e dytë, fjalën "radiogram" me fjalën "faksimile" dhe duke shtuar një fjali të re në fund të Seksionit që lexon:

"Korrespondenca nëpërmjet faksit duhet të dërgohet dhe me postë".

Seksioni 1.02. Vetëm në rastet kur është kërkuar ndryshe, termat e përkufizuara në Kushtet e Përgjithshme dhe në Preambulën e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet respektive të përcaktuara dhe termat e mëposhtme shtesë kanë kuptimet e mëposhtme :

(a) "Kategoritë e Lejueshme" do të thotë kategoritë (1), (2), (3) dhe (4), të paraqitura në tabelën në Pjesën A.1 të Shtesës 1 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) "Shpenzime të Lejuara" janë shpenzimet për mallra dhe shërbime të paraqitura në Seksonin 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(c) "PMM" kupton Planin e Menaxhimit të Mjedisit për Projektin, të pranueshëm nga Shoqata, të adaptuar nga Huamarrësi më 15 Mars 2000, plan i cili është bërë për të parashikuar ndikimet në mjedis dhe për të propozuar masat e reduktimit të këtyre pasojave;

(d) "MASH" kupton Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Huamarrësit;

(e) "NJZP" kupton Njësinë e Zbatimit të Projektit e ngritur më 1 gusht 1999;

(f) "Llogaria e Projektit" kupton llogarinë e hapur nga Huamarrësi në përputhje me Seksionin 5.01(b) të kësaj Marrëveshje;

(g) "Raporti i Menaxhimit të Projektit" kupton çdo raport të përgatitur në përputhje me Seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshje;

(h) "Fondet Avancë për Përgatitjen e Projektit" janë fondet avancë që Shoqata ia jep Huamarrësit në bazë të një letërmarrëveshje të firmosur nga Shoqata më 29 nëntor 1999 dhe nga ana e Huamarrësit më 15 mars 2000;

(i) "Llogaria Speciale" është llogaria e referuar në Seksionin I.B të kësaj Marrëveshje;

(j) "SHBLSH" kupton Shtëpinë Botuese të Librit Shkollor të themeluar më 26 maj, 1967, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.62; dhe

(k) "NSHLSH" kupton Ndërmarrjen e Shpërndarjes së Librit Shkollor të themeluar më 2 mars 1993 në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.279.

Neni 2
Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t'i huajë Huamarrësit, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara apo të referuara në Marrëveshjen e Kredisë të Zhvilimit, një shumë në monedha të ndryshme të barabarta me nëntë milionë SDR (të Drejta Speciale Tërheqjesh) (SDR 9.000.000).

Seksioni 2.02 (a). Sasia e Kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e Shtesës 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzime të bëra (ose në rast se është dakord Shoqata, që do të bëhen) me kosto të arsyeshme për mallra dhe shërbime që kërkohen për Projektin, dhe të financohen në bazë të dispozitave të Kredisë.

(b) Menjëherë pasi Kredia të bëhet efektive, Shoqata duhet që në emër të Huamarrësit, të tërheqë nga Llogaria e Kredisë, shumën e përdorur deri më atë datë nga Fondet Avancë për Përgatitjen e Projektit. Pjesa tjetër e fondeve e papërdorur nga Fondi Avancë për Përgatitjen e Projektit, anulohet.

Seksioni 2.03. Data e mbylljes do të jetë korrik 31, 2004 apo ndonjë datë e mëvonshme siç do të përcaktohet nga Shoqata. Shoqata do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04 (a). Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës një pagesë të detyruar mbi shumën kryesore të Kredisë që nuk është tërhequr herë pas here në një shumë që do të përcaktohet nga Shoqata më datë 30 Qershor të çdo viti, por që nuk duhet të kalojë gjysmë përqind (1/2 e 1%) për vit.

(b) Shuma e detyruar do të rritet; (i) pas gjashtëdhjetë ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje (data e interesit) deri në datat respektive në të cilat do të tërhiqen, ose anullohen shumat nga Huamarrësi nga Llogaria e Kredisë; dhe (ii) në shumën e caktuar në 30 Qershor menjëherë përpara datës së interesit dhe me shuma të tjera siç mund të caktohen herë pas here në bazë të paragrafit (a) më sipër. Shuma e caktuar më datë 30 Qershor të çdo viti do të zbatohet që nga data tjetër e atij viti, datë kjo e përcaktuar në seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Shuma e detyruar do të paguhet; (i) në vende të tilla të kërkuara nga Shoqata brenda arsyes; (ii) pa kufizime të çdo lloji të vendosura në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme apo në ndonjë monedhë apo monedha të tjera të përshtatshme që mund të caktohen ose përzgjidhen herë pas here në bazë të dispozitave të atij Seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi duhet t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi prej tre të katërtat e një përqind (3/4 e 1%) në vit mbi shumën principale të Kredisë të tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë.

Seksioni 2.06. Shumat e detyrueshme dhe ato të shërbimit do të jenë të pagueshme çdo gjysmë viti, më 15 Janar dhe 15 korrik të çdo viti.

Seksioni 2.07 (a). Në bazë të paragrafëve (b), (c) dhe (d) më poshtë, Huamarrësi do të paguajë shumën principale të kredisë me këste gjysmë vjetore të pagueshme në çdo 15 janar dhe 15 korrik, duke filluar nga 15 korrik 2010 dhe duke përfunduar në 15 janar 2040. Çdo këst duke përfshirë këstin e pagueshëm në 15 janar 2000 do të jetë një dhe një të katërtat për qind (1-1/4%) e kësaj shume principale dhe çdo këst i mëvonshëm do të jetë dy dhe një gjysmë për qind (2-1/2%) i kësaj shume principale.

(b) Kur (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë (GNP-ja) e Huamarrësit, siç është vendosur nga Shoqata, do të ketë kaluar për tre vjet rresht një pas një nivelin e përcaktuar për vit nga Shoqata për të vendosur të drejtën e kërkesës së fondit nga Shoqata; dhe (ii) Banka do ta konsiderojë Huamarrësin të vlefshëm për t'i dhënë kredi, Shoqata mundet që pas rishikimit dhe aprovimit nga Drejtorët Ekzekutivë të Shoqatës dhe pas një periudhe konsiderimi nga ana e tyre të zhvillimit të ekonomisë të Huamarrësit, të modifikojë pagesën e kësteve në bazë të paragrafit (a) më sipër;

(A) ku i kërkohet Huamarrësit të shlyejë dyfishin e shumës të secilit prej këtyre kësteve që nuk janë bërë ende për t'u paguar deri kur të paguhet shuma principale e Kreditit; dhe

(B) ku i kërkohet Huamarrësit të fillojë pagesën e shumës principale të kredisë që nga data e parë e pagesës gjysmë vjetore për të cilën bëhet fjalë në paragrafin (a) më sipër, pas gjashtë apo më shumë muajsh pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin që ngjarjet e përcaktuara në paragrafin (b) kanë ndodhur, duke pasur parasysh që do të ketë një periudhë faljeje prej një minimumi pesë vjetësh mbi këtë shlyerje të principalit.

(c) Nëse kërkohet nga Huamarrësi, shoqata mund të rishikojë modifikimet e referuara në paragrafin (b) më sipër që të përfshijë disa ose të gjitha rritjet në shumat e kësteve të tilla, pagesën e interesit në një tarifë vjetore të rënë dakord me Shoqatën mbi shumën principale të Kredisë së tërhequr herë pas here, duke pasur parasysh që në bazë të gjykimit të Shoqatës një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin e grantit që është marrë në bazë të modifikimit të mësipërm të shlyerjes.

(d) Nëse në ndonjë moment pas modifikimeve të termave në bazë të paragrafit (b) më sipër, Shoqata vendos që kushti ekonomik i Huamarrësit është përkeqësuar në mënyrë të ndjeshme, në rast se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mund të modifikojë më tej termat e pagesës për të qenë konform skedulit të kësteve siç paraqitet në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 2.08. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës specifikohet për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 3
Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01 (a). Huamarrësi i deklaron angazhimet e tij ndaj objektivave të Projektit siç përcaktohen në Shtesën 2 të kësaj Marrëveshje, dhe për këtë qëllim, duhet ta zbatojë Projektin nëpërmjet NJZP, me zellin dhe efektivitetin e duhur dhe në përputhje me praktikat e duhura administrative dhe financiare dhe duhet të sigurojë menjëherë kur të kërkohet, fondet, lehtësira, shërbimet dhe burime të tjera që i kërkon Projekti.

(b) Pa kufizime mbi dispozitat e paragrafit (a) të këtij seksioni dhe vetëm në rast se Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, Huamarrësi duhet të zbatojë projektin në përputhje me Programin e Zbatimit të Projektit të paraqitur në Shtesën 4 të kësaj Marrëveshje.

Seksioni 3.02. Me përjashtim të rasteve kur Shoqata do të bjerë dakord ndryshe, prokurimi i mallrave dhe shërbimeve të konsulencës që kërkohet për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Kredisë do të qeverisen nga Dispozitat e Shtesës 3 të kësaj Marrëveshje.

Seksioni 3.03. Për qëllimet e Seksionit 9.07 të Kushteve të Përgjithshme dhe pa kufizim, Huamarrësi duhet të:

(a) përgatisë, në bazë të udhëzimeve të pranuara nga Shoqata, dhe t'i japë asaj jo më vonë se gjashtë muaj (6) pas Datës së Përfundimit, ose një date tjetër të mëvonshme për të cilën do të bihet dakord midis Huamarrësit dhe Shoqatës, një plan që ka për qëllim të sigurojë vazhdimësinë e Projektit; dhe

(b) t'i ofrojë Shoqatës një mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer pikëpamje me Huamarrësin për Planin në fjalë.

Neni 4
Konventat Financiare

Seksioni 4.01. (a) Huamarrësi vepron mbi NJZP, për të vendosur dhe mbajtur sistemin e menaxhimit financiar, duke përfshirë të dhëna dhe llogari, dhe të përgatisë raporte financiare në një format të pranueshëm për Shoqatën, të përshtatshme të reflektojë operacione, burimet dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me zbatimin e Projektit.

(b) Huamarrësi duhet t'i kërkojë NJZP që të:

(i) ketë të dhënat, llogaritë dhe raportet financiare të cilave u referohet paragrafi (a) i këtij Seksioni, duke përshirë edhe dokumentet përkatëse dhe llogaritë për Llogarinë Speciale për çdo vit fiskal të audituar, në përputhje me parimet e duhura të kontrollit, të cilat duhet të zbatohen me përpikëri nga revizorë (auditor) të pavarur, të cilët duhet të jenë të pranueshëm për Shoqatën;

(ii) të vërë në dispozicion të Shoqatës sa më shpejt që të jetë e mundur, por sidoqoftë, jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti: (A) kopje të vërtetuara të raportit financiar, që u referohet paragrafi (a) për çdo vit të audituar; dhe (B) një opinion mbi këtë raport financiar të të dhënave, llogarive, si dhe raportin e auditimit që do të kryejnë auditorët e mësipërm, me ato hollësi dhe në atë gjerësi që e kërkon Shoqata; dhe

(iii) t'i japë Shoqatës informata të tjera në lidhje me këto dokumente dhe llogari si dhe auditimin e tyre sa herë që do t'ia kërkojë Shoqata.

(c) Për të gjitha shpenzimet për të cilat janë bërë tërheqje nga Llogaria e Kredisë në bazë të deklaratave të shpenzimeve, Huamarrësi duhet:

(i) të mbajë ose të kërkojë që të mbahen në përputhje me paragrafin (a) të këtij Seksioni, dokumentacioni dhe llogari që të pasqyrojnë këto shpenzime;

(ii) të mbajë, të paktën deri në një vit pasi Shoqata t'i ketë marrë raportet e kontrollit për vitin fiskal, gjatë të cilit është bërë tërheqja e fundit nga Llogaria e Kredisë, të gjitha dokumentacionet (kontratat, urdhrat, faturat, shpenzimet dhe pagesa e dokumente të tjera) që provojnë kryerjen e shpenzimeve në fjalë;

(iii) t'u japë mundësi përfaqësuesve të Shoqatës t'i shqyrtojnë këto dokumente; dhe

(iv) të marrë masa që këto të dhëna dhe llogari të përfshihen në auditimin vjetor, të cilit i referohet paragrafi (b) i këtij Seksioni dhe që raporti i këtij auditimi të përmbajë një mendim të veçantë nga auditorët në fjalë, ku të thuhet nëse deklaratat e shpenzimeve që janë paraqitur gjatë atij viti fiskal, bashkë me procedurat dhe kontrollet e brendshme që nevojiten për përgatitjen e tyre, janë të

tilla që të justifikojnë tërheqjet e bëra në bazë të tyre.

Seksioni 4.02. (a) Pa kufizime në provizionet e Seksionit 4.01 të kësaj Marrëveshje, Huamarrësi duhet të zbatojë planin e aksionit në bazë të afateve të përcaktuara të pranueshme për Shoqatën për të forcuar sistemin Menaxhues financiar, të cilit i referohet paragrafi (a) i Seksionit 4.01, në mënyrë që të mundësojë Huamarrësin, jo më vonë se 31 gusht 2000, ose në një datë të mëvonshme që do të bihet dakord nga Shoqata, të përgatisë çdo tre muaj Raporte të Menaxhimit të Projektit, të pranueshme për Shoqatën secili prej të cilëve

(i) (A) të paraqesë burimet aktuale financiare dhe aplikimet për fondet e Projektit, të harxhuara në mënyrë akumulative dhe shpenzimet e bëra gjatë periudhës që raportohet në raport, si dhe fondet që mendohen të harxhohen gjatë 6 muajve të ardhshëm nga periudha e raportuar; dhe (B) të raportohet në veçanti për shpenzimet jashtë procedurave të Kreditit, shpenzime këto të bëra gjatë periudhës që raportohet, si dhe shpenzimet që mendohen të mbulohen me fonde jashtë fondeve të Kredisë gjatë gjashtë muajve të ardhshëm nga periudha e raportuar;

(ii) (A) të përshkruaj progresin fizik në zbatimin e Projektit, në mënyrë përmbledhëse dhe për periudhën që përfshihet në raport, dhe (B) të shpjegojë ndryshimet ndërmjet arritjeve të parashikuara dhe aktuale të zbatimit të Projektit; dhe

(iii) të paraqesë statusin e prokurimit të Projektit dhe shpenzimet e bëra me kontratat e financuara nga fondet e Projektit, deri në datën e fundit të periudhës së raportuar.

(b) Me përfundimin e planit të aksioneve të paraqitur në paragrafin (a) të këtij Seksioni, Huamarrësi duhet të përgatisë, në përputhje me udhëzimet e pranuara nga Shoqata, t'i paraqesë Shoqatës, jo më vonë se 45 ditë mbas përfundimit të tremujorit, Raportin e Menaxhimit të Projektit për periudhën tre mujore.

Neni 5
Data Efektive; Mbarimi (Mbyllja)

Seksioni 5.01. Dukuritë e mëposhtme janë përcaktuar si kushte shtesë për efikasitetin e Marrëveshjes për Zhvillimin e Kredisë brenda kuptimit të Seksionit 12.01 (b) të Kushteve të Përgjithshme;

(a) Huamarrësi duhet të paraqesë një kopje të regjistrimit që provon se SHBLSH dhe NSHLSH janë shndërruar në shoqëri aksionare;

(b) Huamarrësi duhet të ketë hapur Llogarinë e Projektit për qëllimet e zbatimit të Projektit me një depozitë fillestare të barabartë me $ US 50,000; dhe

(c) Huamarrësi duhet të ketë zgjedhur auditorët (revizorët) siç është përcaktuar në Seksionin 4.01 (b) të kësaj Marrëveshje.

Seksioni 5.02. Në ditën e 90 pas datës së kësaj Marrëveshje këtu më poshtë specifikohet qëllimi i seksionit 12.04 të Kushteve të përgjithshme.

Neni 6
Përfaqësuesi(t) e Huamarrësit; Adresat

Seksioni 6.01. Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të Kushteve të përgjithshme.

Seksioni 6.02. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme.

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Adresa:

Teleks:
4295 Komplan
AB

Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H.Street, N.W.
Washington, D.C.20433
United States of America

Adresa:	Teleks
INDEVAS	248423 (MCI) or
Washington, D.C.	64145 (MCI)

NË PRANI TË DËSHMITARËVE, palët e mësipërme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, kanë përpiluar këtë Marrëveshje që të firmoset në emrat e tyre përkatës në Distriktin e Kolumbias, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas ditës dhe vitit që është shkruar më poshtë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË	SHOQATA NDËRKOMBËTARE E ZHVILLIMIT
Nga: Përfaqësuesi i Autorizuar	Nga: Për/ZËVENDËSPRESIDENTI RAJONAL
Anastas Angjeli	EUROPA DHE AZIA QËNDRORE
MINISTËR I FINANCAVE	Arntrand Hartmaun

SHTESA I
TËRHEQJET E TË ARDHURAVE TË KREDISË

A. Të Përgjithshme

1. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e zërave që do të financohen nga të ardhurat e Kredisë, alokimin e sasive të Kredisë për çdo Kategori, dhe përqindjen e shpenzimeve për çdo zë që do të financohen në secilën Kategori.

Kategori	Sasia e Kredisë së Alokuar (Shprehur në Ekuivalent SRD)	% e shpenzimeve për t'u financuar
(1) Punë		75 %
(a) Rehabilitimi i Shkollave	2,930,000	
(b) Punë të Tjera	100,000	
(2) Mallra	2,070,000	100% e shpenzimeve të huaja, 100% e shpenzimeve lokale (kostoja e ish-fabrikës) dhe 85% e shpenzimeve lokale për zëra të tjera të prokuruara në vend.
(3) Asistencë Teknike dhe Trainime		100%
(a) Zbatim Iniciativash	1,350,000	
(b) Asistencë Teknike Tjetër dhe Trainime	1,510,000	
(4) Kostot operative në rritje	130,000	50% deri më 1 gusht 2002 dhe 25% më pas
(5) Rifinancimi i fondit Avancë për Përgatitjen e Projektit	380,000	Shumë në bazë të Seksionit 2.02 (b) të kësaj Marrëveshje
(6) Të paalokuara	530,000	
TOTALI	9,000,000	

2. Për qëllimet e kësaj Shtese:
(a) termi "shpenzime të huaja" do të thotë shpenzime në monedhën e çdo vendi tjetër me

përjashtim të vendit Huamarrës për mallra dhe shërbime që i siguron çdo vend tjetër me përjashtim të vendit Huamarrës; dhe

(b) termi "shpenzime lokale" do të thotë shpenzime në monedhën e vendit Huamarrës, ose për mallra ose për shpenzime që sigurohen në vendin Huamarrës; dhe

(c) "Kostot Operative në Rritje" do të thotë kostot që paguhen nga Llogaria e Projektit, përfshirë këtu pajisje zyre, kancelari zyre, shpenzime për automjetin e Projektit, udhëtime, qera, komunikim dhe për auditim.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet në lidhje (a) me pagesa për shpenzime të bëra përpara datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshje; (b) pagesa të bëra për shpenzime të Kategorisë (1) (a) të paraqitura në tabelë në paragrafin e parë të kësaj Shtese, në se Huamarrësi nuk i ka paraqitur Huamarrësit listën e shkollave që do të rehabilitohen vitin e parë të Projektit, e pranueshme kjo listë nga Shoqata; dhe (c) pagesa të bëra për shpenzime të Kategorisë (3) (a) të paraqitura në tabelë në paragrafin 1 të kësaj Shtese, në se Huamarrësi deri më 1 gusht 2001, nuk ka nxjerrë vendimin për ngritjen e Njësisë së Planifikimit dhe Këshillin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, ku të jetë specifikuar buxheti i mjaftueshëm, numri i duhur i personelit, si dhe plani i detajuar i punës, në mënyrë që të vazhdohen iniciativat e reformës, nën Pjesën A të Projektit, si dhe programet mësimore, trajnimi i mësuesve, të pranueshme këto për Shoqatën.

4. Shoqata mund të kërkojë të bëhen tërheqje nga Llogaria e Kredisë në bazë të deklaratave të shpenzimeve për shpenzime: (i) mallra dhe punime në bazë të kontratave, secila prej tyre që nuk kalojnë ekuivalentin prej $ 500,000; (ii) për shërbime konsulence dhe trainime të kryera nga firma konsulente, me kontrata që secila prej tyre nuk kalojnë shumën ekuivalent prej $ 100,000; (iii) për shërbime konsulence dhe trainime të kryera nga individë me kontrata që secila prej tyre nuk kalon shumën ekuivalent prej $ 50,000; dhe (iv) për kostot në rritje operative me kushte dhe terma të specifikuara nga Shoqata dhe të bëra të njohura Huamarrësit.

B. Llogaritja Speciale

1. Huamarrësi duhet të hapë dhe të mbajë në Dollarë një Llogari Speciale depozite me kushte dhe terma të pranueshme nga Shoqata, përfshirë këtu dhe mbrojtjen nga prekja e kësaj llogarie për qëllime të paparashikuara në Projekt.

2. Mbasi Shoqata të ketë marrë evidenca të kënaqshme për Shoqatën, që kjo Llogari Speciale është hapur, atëherë aplikimet për mbushjen e kësaj Llogarie Speciale me fonde nga Llogaria e Kredisë do të bëhet si më poshtë:

(a) derisa Shoqata të ketë marrë (i) raportin e parë të Menaxhimit të Projektit të parashikuar në Seksionin 4.02 (b) të kësaj Marrëveshje dhe (ii) një kërkesë nga Huamarrësi për tërheqje në bazë të Raporteve të Menaxhimit të Projektit, tërheqjet duhet të bëhen në përputhje me provizionet e Aneksit A të kësaj Shtese 1; dhe

(b) sapo që Shoqata të marrë Raportin e Menaxhimit të Projektit sipas Seksionit 4.02 (b) të kësaj Marrëveshje, të shoqëruar nga një kërkesë e Huamarrësit për tërheqje fondesh në bazë të Raportit të Menaxhimit të Projektit, të gjitha tërheqjet e tjera duhet të bëhen në përputhje e provizionet e Aneksit B të kësaj Shtese 1.

3. Pagesat nga Llogaria Speciale duhet të bëhen ekskluzivisht vetëm për shpenzime të lejuara. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarrësi nga Llogaria Speciale, Huamarrësi duhet që me kërkesë të arsyeshme të Shoqatës, t'i dërgojë Shoqatës të gjitha dokumentet dhe evidentimet që vërtetojnë që të gjitha këto shpenzime janë Shpenzime të Lejuara ekskluzivisht.

4. Pa kufizime në provizionet e Pjesës B.2 të kësaj Shtese, Shoqatës nuk mund t'i bëhen kërkesa për tërheqje fondesh në Llogarinë Speciale:

(a) nëse Shoqata vendos në çdo kohë që Raporit i Menaxhimit të Projekti nuk jep informacion bindës dhe të mjaftueshëm sipas Seksionit 4.02 të kësaj Marrëveshje;

(b) nëse Shoqata vendos në çdo kohë që të gjitha tërheqjet e mëtejshme të bëhen direkt nga Llogaria e Kredisë; ose

(c) nëse Huamarrësi ka dështuar t'i dërgojë Shoqatës brenda periudhës së specifikuar në Seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshje, ndonjë nga raportet e auditimit të kërkuara nga Shoqata në Seksionin e dhënë ku flitet për auditimin e (A) dokumenteve dhe veprimeve të Llogarisë Speciale ose (B) të dokumenteve dhe veprimeve financiare që reflektojnë shpenzimet për të cilat tërheqjet janë

bërë në bazë të Raportit të Menaxhimit të Projektit.

5. Shoqatës nuk do t'i kërkohet të bëjë depozita të mëtejshme në Llogarinë Speciale në përputhje me dispozitat e Pjesës B.2 të kësaj Shtese, në se në çdo kohë Shoqata e ka informuar Huamarrësin për qëllimet që ka Shoqata për të ndërprerë plotësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të tërhequr nga Llogaria e Kredisë sipas Seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme. Me të marrë këtë njoftim, Shoqata do të vendosë, me të drejtën e vet, nëse do të bëjë depozitime të mëtejshme në Llogarinë Speciale dhe se çfarë procedurash do të ndiqen për të bërë depozitime të tilla. Për të gjitha këto vendime Shoqata do të njoftojë Huamarrësin.

6. (a) Nëse Shoqata vendos në çdo kohë që pagesat nga Llogaria Speciale janë bërë për shpenzime të palejuara, ose shpenzime që nuk janë të evidentuara me dokumente të dërguara në Shoqatë, Huamarrësi duhet, menjëherë sapo të njoftohet nga Shoqata, t'i dërgojë Shoqatës dokumentet evidentuese sipas kërkesës së Shoqatës, ose të depozitojë në Llogarinë Speciale (ose me kërkesë të Shoqatës dhe Llogarinë e Shoqatës) shumën e barabartë me shumën e shpenzimeve në fjalë. Vetëm nëse Shoqata bie dakord ndryshe, në Llogarinë Speciale nuk do të bëhet asnjë depozitim, derisa Huamarrësi të dërgojë evidenct e kërkuara dhe të duhura ose të bëjë depozitimin e shumës së harxhuar, sipas rastit.

(b) Nëse Shoqata vendos në çdo kohë që çdo shumë e papërdorur në Llogarinë Speciale nuk do të kërkohet që të përdoret për shpenzimet e lejuara gjatë 6-mujorit mbasi të jenë marrë vendimet e lartëpërmendura, Huamarrësi menjëherë mbasi të ketë marrë njoftimin nga Shoqata, duhet ta rimbursojë Shoqatën për shumën në fjalë.

(c) Huamarrësi, sapo të marrë njoftimin nga Shoqata, duhet të rimbursojë Shoqatën menjëherë ose me këste për fondet e depozituara në Llogarinë Speciale.

(d) Rimbursimi i Shoqatës bëhet sipas nen-paragrafet (a), (b) ose (c) të këtij paragrafi 6, duke kredituar Llogarinë e Kredisë për tërheqjet rrjedhojë ose për anullimin sipas dispozitave të Marrëveshjes së Zhvillimit të Kredisë.

ANEKSI A
I SHTESËS 1

Operimi i Llogarisë Speciale kur Tërheqjet e Fondeve nuk bëhen në bazë të Raporteve të Menaxhimit të Projektit

1. Për qëllime të këtij Aneksi:

a) termi "Alokim fondesh të Autorizuar" do të thotë ajo sasi parash që është ekuivalente me $ 500,000 që do të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë dhe depozitohet në Llogarinë Speciale në përputhje me paragrafet 2 të këtij Aneksi; duke mundësuar që nëse Shoqata bie dakord për të kundërt, Alokimi i Autorizuar të kufizohet në shumën ekuivalente me $ 200,000 deri sa shuma agregate e tërheqjes së fondeve nga Llogaria e Kredisë, plus shumën totale të të gjitha angazhimeve financiare speciale të bëra nga Shoqata sipas Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme, të arrijë ose të kalojë shumën ekuivalente SDR 2.500,000.

2. Tërheqjet e Alokimit të Autorizuar dhe tërheqjet rrjedhojë për të rimbushur Llogarinë Speciale duhet të bëhen si më poshtë:

a) Për tërheqje të Alokimeve të Autorizuara, Përftuesi do t'i bëjë një kërkesë/ ose kërkesa Shoqatës për të depozituar në Llogarinë Speciale një sasi, ose disa sasi parash, që nuk duhet ta kalojnë sasinë e përgjithshme të Fondeve të Autorizuara. Në bazë të kësaj kërkese ose këtyre kërkesave, në emër të Huamarrësit, Shoqata do të tërheqë ng Llogaria e Kredisë dhe do të depozitojë në Llogarinë Speciale atë / ato sasi parash që ka kërkuar Huamarrësi.

b) Për të furnizuar Llogarinë Speciale, Përftuesi do t'i bëjë një kërkesë Shoqatës për të depozituar para në Llogarinë Speciale sipas atyre intervaleve që do të përcaktojë Shoqata.

Përpara ose në kohën që bëhen kërkesa të tilla, Huamarrësi do t'i dërgojë Shoqatës dokumente dhe prova të tjera që kërkohen në përputhje me Pjesën B.3 të Shtesës 1 të kësaj Marrëveshje për pagesën/ pagesat për furnizimin e llogarisë. Në bazë të një kërkese të tillë, Shoqata do të tërheqë nga Llogaria e Kreditit, në emër të Huamarrësit dhe do të depozitojë në Llogarinë Speciale ato sasi që ka kërkuar Huamarrësi pasi që me anë të dokumenteve në fjalë dhe provave të tjera do të jetë provuar se ato para janë paguar nga Llogaria Speciale për shpenzime të duhura/ lejuara. Të gjitha këto depozita

do të depozitohen në llogarinë speciale duke u tërhequr nga Shoqata nga Llogaria e Kredisë në bazë të Kategorive përkatëse të Lejuara dhe në sasi përkatëse ekuivalente që do të justifikohen me dokumentet në fjalë dhe prova të tjera.

3. Shoqata nuk duhet që të bëjë depozitime të mëtejshme në Llogarinë Speciale, kur shuma totale e tërhequr nga Llogaria e Kredisë minus totalin e të gjitha fondeve të angazhuara speciale të bëra nga Shoqata sipas Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme, barazohen me ekuivalentin e shumës së Alokimit të Autorizuar. Që nga ky moment, tërheqja nga Llogaria e Kredisë e fondeve të pa tërhequra do të bëhet sipas procedurave të specifikuara dhe të bëra të njohura Huamarrësit nga Shoqata. Tërheqjet e mëtejshme do të bëhen vetëm me pëlqimin dhe pasi të jenë rënë dakord nga Shoqata që këto shuma të mbetura të depozituara në Llogarinë Speciale në datën kur është bërë ky njoftim, do të përdoren për pagesat e Shpenzimeve të Lejuara.

ANEKSI B
I SHTESËS 1

Operimi i Llogarisë Speciale kur Tërheqjet e Fondeve bëhet në bazë të Raporteve të Menaxhimit të Projektit

1. Vetëm nëse Shoqata specifikon dhe njofton Huamarrësin ndryshe, të gjitha tërheqjet nga Llogaria e Kredisë do të depozitohen nga Shoqata në Llogarinë Speciale në përputhje me dispozitat e Shtesës 1 të kësaj Marrëveshje. Secila nga këto depozita në Llogarinë Speciale do të tërhiqen nga Shoqata nga Llogaria e Krediti për një ose disa Kategori të Lejueshme.

2. Secila nga aplikimet për tërheqje fondesh nga Llogaria e Kreditit për t'u depozituar në Llogarinë Speciale, duhet të mbështetet nga Raporti i Menaxhimit të Projektit.

3. Sapo të marrë aplikimin për tërheqjen e fondeve të Kredisë, Shoqata duhet që në emër të Huamarrësit, të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe të depozitojë në Llogarinë e Speciale një shumë të barabartë jo më pak se: (a) shuma e kërkuar, dhe (b) shuma që ka vendosur Shoqata, bazuar në Raportin e Menaxhimit të Projektit, raport i bashkëngjitur aplikimit, e kërkuar të depozitohet në mënyrë që të financojë Shpenzimet e lejuara gjatë periudhës gjashtëmujore nga data në vazhdim të raportit; duke siguruar gjithashtu që shuma e depozituar, kur t'i shtohet shumës së kërkuar në Raportin e Menaxhimit të Projektit që do të mbetet në Llogarinë Speciale, të mos kalojë shumën ekuivalente me $ 500,000.

SHTESA 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objekti i Projektit është që të ndihmojë Huamarrësin të përmirësojë sektorin e arsimit dhe të forcojë dhënien e llogarisë.

Projekti konsiston në komponentët e mëposhtëm, të cilët dhe mund të modifikohen me aprovimin e Huamarrësit dhe Shoqatës herë pas here deri sa këto objektiva të arrihen:

1. Hartimi i Politikave, Menaxhimi dhe Përmirësimi i Sistemeve Arsimore

Reforma institucionale dhe organizative, si përfundimi i planit të reformës, mbështetje me anë të njësisë së planifikimit të politikave dhe iniciativave të sektorit, nëpërmjet punimeve mallrave, asistencës teknike dhe kualifikimeve.

2. Sistemi i Informacionit dhe Menaxhimit të Arsimit.

Ngritja e sistemit të Menaxhimit nëpërmjet punimeve, mallrave, asistencës teknike dhe kualifikimeve.

3. Vlerësimi i të Mësuarit dhe Provimet.

Krijimi i kapaciteteve për analizimin e vlerësimit të të mësuarit për klasat e 4-ta, përmirësimi i provimeve ekzistuese të administruara në klasat e 8-ta dhe 12-ta, dhe zhvillimi i cilësisë së lartë dhe administrim të njëanshëm të provimeve të hyrjes në universitet nëpërmjet punimeve, mallrave, asistencës teknike dhe kualifikimeve.

4. Rehabilitim Shkollash

Rehabilitim vendesh në shkolla, zhvillimi i kodeve të ndërtimit si dhe hartimi i standarteve për

shkollat dhe pajisjet e tyre nëpërmjet mallrave, punimeve dhe asistencës teknike.

5. Tekste Shkollore

Prokurimi i teksteve shkollore ekzistuese, si dhe botimi i teksteve shkollore në bazë të kurikulave të reja (programeve të reja mësimore) si provë për botimin privat të teksteve shkollore nëpërmjet mallrave, asistencës teknike dhe kualifikimit.

Projekti pritet të përfundojë më 31 janar 2004

SHTESA 3
PROKURIMI DHE SHËRBIMET KONSULENTE

Seksioni I: Prokurimi i Mallrave dhe Punës

Pjesa A: Të Përgjithshme

Mallrat dhe punimet do të prokurohen (a) në përputhje me dispozitat e Seksionit I të "Udhëzime për Prokurimet e Kredive dhe Huave të IBRD dhe IDA" botuar nga Banka në janar 1995 dhe të rishikuara në janar dhe gusht 1996, shtator 1997 dhe Janar 1999.

(Udhëzimet); dhe dispozitat e dhëna në Pjesën e mëposhtme të Seksionit I.

Pjesa B: Tenderi kompetitiv ndërkombëtar

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, mallrat dhe punimet do të prokurohen në bazë të dispozitave të Seksionit II të udhëzimeve dhe paragrafit 5 të Shtesës 1 si më poshtë:

2. Dispozitat e mëposhtme vlejnë për mallrat dhe punimet që do të prokurohen në bazë të kontratave që do të jepen në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të kësaj Pjese B.

(a) Preferencë për mallra të prodhuara në vend dhe kontraktues vendas.

Dispozitat e paragrafëve 2.54 dhe 2.55 të Udhëzimeve dhe të Shtesës 2 si më poshtë aplikohen si për mallrat e prodhuara në territorin e Huamarrësit, ashtu dhe për punimet e kryera nga kontraktues vendas.

Pjesa C: Procedura të Tjera Prokurimi

1. Tenderi Kompetitiv Kombëtar

Punë të cilat do të kushtojnë më pak se ekuivalenti prej $ 200 000 për çdo kontratë deri në shumën e përgjithshme që nuk duhet të kalojë ekuivalentin $ 2,700 000, mund të prokurohen në bazë të dispozitave të paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të Udhëzimeve.

2. Blerje Ndërkombëtare

Mallra që kushtojnë më pak se ekuivalenti prej $ 100,000 për çdo kontratë deri në shumën e përgjithshme që nuk duhet të kalojë ekuivalentin $ 176,500 të prokurohen në bazë të kontratave që do të lidhen në bazë të procedurave të blerjeve kombëtare në përputhje me dispozitat e paragrafit 3.5. dhe 3.6 të Udhëzimeve.

3. Blerje në Vend

Mallrat që vlerësohen që do të kushtojnë më pak se ekuivalenti prej $ 25,000, për çdo kontratë deri sa shuma e përgjithshme të mos kalojë shumën prej $ 39,200 për kontratë, mund të prokurohen sipas kontratave që do të lidhen në bazë të procedurave të blerjeve në vend në përputhje me dispozitat e paragrafeve 3.5 dhe 3.6 të Udhëzimeve.

4. Blerje Direkte

Mallrat që do të blihen nga furnizuesi origjinal, dhe që duhet të jenë të konvertueshme me pajisjet ekzistuese dhe që kushtojnë sa ekuivalenti $ 26,300 ose më pak në total, mund, që me aprovimin paraprak të Shoqatës, të prokurohen në përputhje me dispozitat e paragrafit 3,7 të Udhëzimit.

5. Blerje e Punimeve të vogla

Punimet që kushtojnë më pak se ekuivalenti prej $ 100,000 për çdo kontratë deri në shumën e përgjithshme që nuk duhet të kalojë ekuivalentin $ 1,900,000 mund të prokurohen në bazë të kontratave lump-sum, me çmim fiks, që do të lidhen në bazë të kuotimeve që do të merren nga tre (3) kontraktues të kualifikuar vendas dhe kuotimet duhet të bëhen me shkrim në përgjigje të flesës për kuotim me shkrim. Ftesa për kuotim duhet të përfshijë një përshkrim të detajuar të punimeve, përfshi këtu dhe specifikimet bazë, dita në të cilën punimet duhet të përfundojnë, një formë Marrëveshje që të jetë e pranueshme dhe nga Shoqata, dhe vizatimet/projektet/ planet që do të aplikohen në këto punime.

Kontrata i jepet (lidhet) me atë që ka ofertën më të ulët në çmim për punimet e kërkuara, dhe që ka eksperiencën dhe burimet për të përfunduar kontratën me sukses.

Pjesa D: Rishikimi i Vendimeve të Prokurimit nga Shoqata

1. Plani i Prokurimit

Përpara se të dërgohen ftesa që të bëhet parakualifikimi për tender ose të bëhet tenderi i dhënies së kontratave, Shoqatës i duhet dërguar plani që propozon Planin e Prokurimit të Projektit, për ta rishikuar dhe miratuar këtë plan në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të Shtesës 1 të Udhëzimeve. Prokurimi i të gjitha mallrave do të bëhet në përputhje me planin e prokurimeve që do ta miratojë Shoqata dhe në bazë të dispozitave të Paragrafit 1 në fjalë.

2. Rishikim paraprak

(a) Në lidhje me të gjitha kontratat e Seksionit I, Pjesa B, dhe C.4, procedurat e paraqitura në paragrafin 2 dhe 3 të Shtesës 1 të Udhëzuesit duhet të zbatohen.

(b) Në lidhje me tre (3) kontratat e Seksionit I, Pjesa C1, C2, C3 dhe C5, procedurat e paraqitura në paragrafin 2 dhe 3 të Shtesës 1 të Udhëzuesit duhet të zbatohen.

3. Rishikim që bëhet më pas

Në lidhje me çdo kontratë që nuk qeveriset nga paragrafi 2 i kësaj Pjese, do të zbatohen procedurat e përcaktuara në paragrafin 4 të Shtesës 1 të Udhëzimeve.

Seksioni II. Punësimi i Konsulentëve

Pjesa A: Të Përgjithshme

Shërbimet e konsulentëve do të sigurohen në përputhje me dispozitat e Hyrjes së Seksionit IV të "Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore" të botuara nga Banka në janar 1997 dhe të rishikuara në shtator 1997 dhe Janar 1999, të cilat mund të modifikohen siç është parashikuar në paragrafin 2 të kësaj Pjese A (Udhëzimet për Konsulentët) dhe (b) dispozitat përkatëse të Pjesëve si më poshtë të Seksionit II.

Pjesa B: Përzgjedhja në Bazë të Cilësisë dhe Kostos

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen në bazë të kontratave që do të jepen në përputhje me dispozitat e Seksionit II të Udhëzimeve për Konsulentët, paragrafi 3 i Shtesës së 1 të saj, Shtesës 2 të saj, dhe dispozitave të paragrafeve 3.13., Dhe 3.18 të tyre, që do të zbatohen për përzgjedhjen e konsulentëve në bazë të cilësisë dhe kostos.

Pjesa C: Procedura të Tjera për Përzgjedhjen e Konsulentëve

1. Përzgjedhje në bazë të kostos sa më të ulët

Shërbimet për një auditor mund të prokurohen nën kontratat në përputhje me dispozitat e paragrafeve 3.1 dhe 3.6 të Udhëzimeve për Konsulentët.

2. Konsulentë Individualë

Shërbimet e konsulencës për detyra që përmbushin kërkesat e paraqitura në paragrafin 5.1 të Udhëzimeve për Konsulentët duhet të prokurohen me kontrata individuale në përputhje me dispozitat e paragrafeve 5.1 deri 5.3 të Udhëzimeve të Konsulentëve.

Pjesa D: Rishikimi nga Shoqata e Përzgjedhjes së Konsulentëve

1. Planifikimi i Përzgjedhjes

Përpara se kërkesat për propozime t'u dërgohen konsulentëve, plani që propozohet për përzgjedhjen e konsulentëve në bazë të Projektit, duhet t'i dërgohet Shoqatës për ta rishikuar dhe miratuar, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të Shtesës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët. Përzgjedhja e shërbimeve të konsulentëve do të bëhet në përputhje me planin e përzgjedhjes, që do të ketë miratuar Shoqata, dhe me dispozitat e paragrafit 1.

2. Rishikimi Paraprak

a) Përsa i përket të gjitha kontratave punësimin e firmave konsulente, për shuma ekuivalente $ 100,000 ose me shumë, do të zbatohen procedurat që përcaktohen në paragrafet 1,2 (me përjashtim të nënparagrafit të tretë të paragrafit 2 (a) dhe 5 të Shtetës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët.

b) Përsa i përket të gjitha kontratave për punësimin e firmave konsulente, për shuma ekuivalente $ 50,000 ose më shumë, por më pak se ekuivalenti i $ 100,000 do të zbatohen procedurat që përcaktohen në paragrafët 1,2 (me përjashtim të nënparagrafit të tretë të paragrafit 2 (a) dhe 5 të Shtesës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët.

c) Përsa i përket secilës kontratë për punësimin e konsulentëve të veçantë, për shuma ekuivalente $ 50,000 ose më shumë, Shoqatës do t'i dërgohen për t'i parë paraprakisht dhe miratuar kualifikimet, përvojën, kushtet e referencës dhe të punësimit të konsulentëve. Kontrata do të jepet vetëm pasi Shoqata të ketë dhënë më parë miratimin e saj. Kontrata do të firmoset vetëm pasi Huamarrësi të ketë marrë miratimin nga Shoqata.

3. Rishikim i mëpasëm

Përsa i përket çdo kontrate jo qeverisur nga paragrafi 2 i kësaj Pjese do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafin 4 të Shtesës 1 të Udhëzimeve të Konsulentëve.

SKEDULI 4
PROGRAMI I ZBATIMIT

1. Huamarrësi duhet:

a) t'u përmbahet politikave dhe procedurave të përshtatëshme për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin në vazhdimësi, në përputhje me tregues të kënaqshëm për Shoqatën, zbatimin e Projektit dhe arritjen e objektivave të përcaktuara;

b) të përgatisë, në bazë të termave të referencës të aprovuara dhe nga Shoqata, dhe t'i dorëzojë Shoqatës me ose rreth datës 31 korrik 2002, një raport ku integrohen rezultatet e aktiviteteve të vlerësimit dhe monitorimit në përputhje me paragrafin (a) të këtij Seksioni, për progresin e arritur në zbatimin e Projektit gjatë periudhës përpara gjatë dhe mbas datave të raportimit. Të paraqiten masat e rekomanduara për të siguruar zbatimin me efektivitet të Projektit, si dhe arritjen e objektivave për periudhën e mëtejshme mbas datave të raportimit;

c) të rishikojë së bashku me Shoqatën deri më 30 shtator 2002, ose në një datë më të vonë të rënë dakord nga Shoqata, raportin e përmendur në paragrafin (b) të këtij Seksioni, dhe më vonë të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përfundimin eficent të Projektit dhe arritje e objektivave, të bazuara në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të lartpërmendur, si dhe në pikëpamjet e Shoqatës për çështjen në fjalë.

2. Huamarrësi duhet të sigurojë që të gjitha masat e nevojshme për të realizuar Planin e Menaxhimit të Mjedisit duhet të bëhen në kohë.

3. Deri më 31 tetor 2002, Huamarrësi duhet që t'i dërgojë Shoqatës një raport plani të detajuar dhe të pranueshme nga Shoqata, plan ky që do të adaptohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Arsimit të Huamarrësit, ku janë të përcaktuara afatet kohore, hapat ligjore dhe teknike për të sjellë në pikën e shitjes Ndërmarrjen e Botimit të Librit Shkollor dhe Ndërmarrjen e Shpërndarjes së Librit Shkollor.

L I G J
Nr.8645, datë 20.7.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E ASISTENCËS TEKNIKE PËR SEKTORIN FINANCIAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e Kredisë së Zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe

Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e asistencës teknike për sektorin financiar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2707, datë 28.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

NUMRI I KREDISË 3362 ALB

MARRËVESHJE KREDIE ZHVILLIMI

MARRËVESHJE, datë 8 qershor 2000 midis Shqipërisë (Huamarrësi) dhe SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (Shoqata).

MEQË: Huamarrësi, i kënaqur me përshtatshmërinë dhe përparësinë e Projektit të përshkruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshje, ka kërkuar nga Shoqata që ta ndihmojë në financimin e Projektit; dhe

MEQË: Shoqata ka pranuar, mbi bazën, ndër të tjera, të pohimeve të mësipërme, që t'i akordojë Huamarrësit kredinë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje:

PRANDAJ palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1
Kushtet e përgjithshme: Përkufizimet

Seksioni 1.01. "Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjes mbi Kreditë për Zhvillim" të Shoqatës, nënshkruar më datën 1 janar 1985 (ndryshuar në 6 tetor 1999). (Kushtet e Përgjithshme) përbëjnë pjesën integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02. Përveç kur konteksi kërkon ndryshe, termat e përcaktuara në Konditat e Përgjithshme kanë kuptimet e përcaktuara aty, ndërsa termat e mëposhtme shtesë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

a) "Kategori të mundshme" janë kategoritë (1) deri në (3) të dhëna në tabelën e paragrafit 1 të Skedulit 1 të kësaj marrëveshjeje.

b) "Shpenzime të mundshme" janë shpenzimet në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga Kredia, të alokuara herë pas here për Kategoritë e mundshme në përputhje me dispozitat e Skedulit 1 të kësaj Marrëveshje.

c) "INSIG" është kompania shtetërore e sigurimeve e krijuar më 31 korrik 1991 me ligjin nr. 7506 e regjistruar në 8 qershor 1999.

d) "PIU" është njësia e zbatimit të projekti e krijuar në 27 shkurt 1992 me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 49 dhe që u bë autonome në 29 Dhjetor 1999.

e) "Llogari speciale" nënkupton llogarinë e referuar në pjesën B të Skedulit 1 të kësaj Marrëveshje.

Neni 2
Kredia

Seksioni 2.1. Shoqata ka rënë dakord t'i japë huamarrësit, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e Kredisë për Zhvillim, një shumë në monedha të ndryshme baras me 4.900.000 SDR.

Seksioni 2.02. (a) Shuma e kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshje për shpenzimet e bëra (ose, nëse Shoqata pranon për shpenzimet që do të bëhen) për koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin dhe që do të financohen nga Kredia.

Seksioni 2.03. Data e mbylljes është 30 qershor 2005, ose një datë e mëvonshme e përcaktuar nga Shoqata. Shoqata menjëherë do të njoftojë Huamarrësin lidhur me datën e mëvonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë angazhimi mbi shumën kryesore të Kredisë së patërhequr nga koha në kohë, në një përqindje që do të vendoset nga Shoqata më 30 qershor të çdo viti, por duke mos tejkaluar gjysmë për qind (0,5 %) në vit.

(b) Pagesa e angazhimit do të fillojë: (i) gjashtëdhjetë ditë nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje (data e fillimit) deri në datat në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Kredisë ose do të anulohen; dhe (ii) sipas përqindjes së caktuar më 30 qershor menjëherë para datës së fillimit ose me një përqindje tjetër që pastaj mund të përcaktohet nga koha në kohë në përputhje me paragrafin (a) më sipër. Përqindja e caktuar më 30 qershor në çdo vit do të aplikohet nga data e ardhme e pagesës në atë vit të përcaktuar në Pjesën 2.06 të kësaj Marrëveshje.

(c) Pagesa e angazhimit do të paguhet: (i) në vende të tilla që në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë Shoqata: (ii) pa kufizime të çfarëdolloji që mund të vendosen nga, ose në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhë të përcaktuar në këtë Marrëveshje për nevojat e pjesës 4.02 të kushteve të përgjithshme ose në monedha të tjera të pranueshme që nga koha në kohë mund të përcaktohen ose të zgjidhen në përputhje me dispozitat e atij Seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë shërbimi me një përqindje prej tre të katërtat e një përqindi (0,75%) në vit të shumës së përgjithshme të kredisë të tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë.

Seksioni 2.06. Pagesat e angazhimit dhe pagesat e shërbimeve do të paguhen dy herë në vit në 1 prill dhe 1 tetor të çdo viti.

Seksioni 2.07. (a) në përputhje me paragrafët e mëposhtëm (b), (c) dhe (d), Huamarrësi do të shlyejë shumën e përgjithshme të kredisë në këste gjysmëvjetore çdo 1 prill dhe 1 tetor duke filluar nga 1 tetor 2010 dhe duke përfunduar më 1 prill 2040. Të gjitha pagesat deri dhe duke përfshirë pagesën më 1 prill 2020 duhet të jenë 1 për qind (1%) të shumës së përgjithshme, dhe në çdo këst pas kësaj date do të jetë 2 për qind (2%) e shumës principale.

(b) Kurdo që: (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë i Huamarrësit, i përcaktuar nga Shoqata, tejkalon për tre vite rresht nivelin vjetor të caktuar nga Shoqata në mënyrë vjetore për të përcaktuar mundshmërinë për përdorimin e burimeve të Shoqatës: dhe (ii) banka do ta konsiderojë huamarrësin të besueshëm për t'i dhënë hua. Shoqata, pas shqyrtimit dhe miratimit nga drejtorët ekzekutivë të shoqatës dhe pasi ata të kenë shqyrtuar zhvillimin e ekonomisë së huamarrësit, mund të ndryshojë kushtet e shlyerjes sipas dispozitave të paragrafit të mësipërm (a) duke:

(A) Duke i kërkuar huamarrësit të paguajë dyfishin e kështit që nuk i ka ardhur data e pagesës ende derisa të shlyhet e gjithë shuma e Kredisë: dhe

(B) Duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë shlyerjen e shumës principale të kredisë në datën e pagesës së parë gjysmëvjetore të referuar më sipër në paragrafin (a) që bie 6 muaj ose më shumë pas datës në të cilën Shoqata njofton huamarrësin se kanë ndodhur ngjarjet e thëna në këtë paragraf (b), duke shtuar se do të ketë një periudhë favorizuese (grace) prej minimumi pesë (5) vjetësh për këtë shlyerje të shumës principale.

(c) Në qoftë se kërkohet nga Huamarrësi, shoqata mund t'i ndryshojë modifikimet, referuar në paragrafin (b) më sipër, kështu që në vend të një pjese të pagesës ose të të gjithë shtesës së pagesës, të paguhet interesi me një përqindje vjetore të caktuar me Shoqatën mbi shumën principale të kredisë së tërhequr ose ende të papaguar nga koha në kohë, me kusht që në gjykimin e Shoqatës këto ndryshime nuk do të ndryshojnë elementin e grant të siguruar sipas modifikimeve të shlyerjes së lartpërmendur.

(d) Në qoftë se, në çdo kohë pas modifikimit të kushteve sipas paragrafit (b) më sipër, shoqata përcakton se gjendja ekonomike e huamarrësit është keqësuar dukshëm, Shoqata, nëse i kërkohet nga huamarrësi, mund të bëjë modifikime të tjera të kushteve të pagesës për t'iu përshtatur planit të shlyerjes parashikuar në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 2.08. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës caktohet si monedha e përdorshme për nevojat e Pjesës 4.02 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 3
Zbatimi i projektit

Seksioni 3.01. (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj qëllimeve të projektit të

përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj marrëveshjeje dhe për këtë qëllim do të zbatojë projektin me efiçencë në përputhje me praktikat administrative dhe financiare dhe do të sigurojë sapo të nevojiten fondet dhe lehtësitë, shërbimet ose burime të tjera të kërkuara për projektin.

(b) Pa kufizuar dispozitën e paragrafit (a) të këtij Seksioni dhe përveç kur Huamarrësi dhe shoqata do të bien dakord ndryshe, huamarrësi do të zbatojë projektin në përputhje me Programin e Implementimit të dhënë në Skedulin 4 të kësaj Marrëveshje.

Seksioni 3.02. Përveç kur shoqata bie dakord ndryshe, prokurimi i mallrave dhe shërbimeve të konsulencës të kërkuara për projektin dhe për t'u financuar nga kredia, do të kryhen në përputhje me dispozitat e Shtojcës 3 të kësaj Marrëveshje.

Seksioni 3.03. për qëllimet e Seksionit 9.06 të Kushteve të përgjithshme dhe pa asnjë kufizim, huamarrësi do të:

(a) përgatisë në bazë të udhëzuesve të pranueshëm nga Shoqata dhe do ta pajisë Shoqatën jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së mbylljes ose më vonë se kjo datë siç mund të jetë rënë dakord midis Huamarrësit dhe Shoqatës, me një plan të krijuar për arritjen e vazhdueshme të objektivave të projektit; dhe

(b) t'i ofrojë Shoqatës një rast të arsyeshëm për të shkëmbyer mendime me huamarrësin për planin e përmendur.

Neni 4
Angazhime financiare

Seksioni 4.01. (a) Huamarrësi do të bëjë që PIU të krijojë dhe mbajë një sistem menaxhimi financiar, duke përfshirë regjistrime dhe llogari dhe përgatisë pasqyra financiare në formatin e pranueshëm për shoqatën, të pranueshëm për të reflektuar operacionet, burimet dhe shpenzimet e lidhura me Projektin.

(b) Huamarrësi do të bëjë që PIU të:

(i) mbajë regjistrime, llogari dhe pasqyra financiare të referuara në paragrafin (a) më sipër dhe regjistrimet dhe llogaritë për Llogarinë Speciale për çdo vit të audituar, në përputhje me standardet e audimit të pranueshme për Shoqatën, të aplikuara siç duhet nga auditorë të pavarur të pranueshëm për Shoqatën;

(ii) dorëzojë Shoqatës sa më parë, por jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i vitit: (A) kopje të vërtetuara të pasqyrave financiare të referuara në paragrafin (a) të këtij Seksioni për vitin e audituar dhe (B) një opinion mbi këto pasqyra, regjistrime dhe llogari dhe raportin e auditimit me fushën dhe në detajet e kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Shoqata; dhe

(iii) t'i japë Shoqatës informacion tjetër në lidhje me regjistrimet dhe llogaritë, dhe auditimin dhe auditorët, si mund të kërkojë Shoqata kohë pas kohe.

(c) Për të gjitha shpenzimet në lidhje me tërheqjet nga Llogaria e Kredisë që u bënë mbi bazën e pasqyrave të shpenzimeve, Huamarrësi do të bëjë që PIU:

(i) të mbajë në përputhje me paragrafin (a) të këtij Seksioni, regjistrimet dhe llogari të veçanta që reflektojnë këto shpenzime;

(ii) të ruaj, të paktën një vit pasi shoqata të ketë marrë raportin e auditimit për vitin fiskal në të cilin tërheqja e fundit nga Kredia është bërë, të gjitha regjistrimet (kontratat, kërkesat, faturat, vërtetimet dhe dokumente të tjera që vërtetojnë shpenzimet;

(iii) të mundësojë përfaqësuesit e Shoqatës të ekzaminojë këto regjistrime; dhe

(iv) të sigurojë që këto regjistrime dhe llogari janë përfshirë në auditin vjetor të referuar në paragrafin (b) më sipër dhe raporti i auditit mban një opinion të veçantë nga auditorët nëse pasqyrat e shpenzimeve të dorëzuara gjatë vitit fiskal, bashkë me procedurat dhe kontrollin e brendshëm të përfshira në përgatitjen e tyre, janë të besueshme pëtr të justifikuar tërheqjet.

Seksioni 4.02 (a) Pa kufizim të dispozitave të Seksionit 4.01 të kësaj Marrëveshje, Huamarrësi do të ndjekë një plan kohor të pranueshëm për Shoqatën për forcimin e sistemit të menaxhimit financiar të referuar në paragrafin (a) të Seksionit 4.01 në mënyrë që të bëjë të mundur, jo më vonë se 30 qershor 2001 ose datë të mëvonshme siç mund të bierë dakord Shoqata, që Huamarrësi të përgatisë Raportet e Menaxhimit të Projektit 3-mujore, të pranueshme për Shoqatën, secila prej të cilave:

(i) (A) përcakton burimet aktuale dhe aplikimet e fondeve të Projektit, të dyja bashkë dhe periudhën e mbuluar nga raporti dhe burimet e projektuara dhe aplikimet e fondeve për projektin për

periudhën 6-mujore që pason periudhën e mbuluar nga raporti i thënë dhe (B) tregon veç e veç shpenzimet e financuara nga kredia gjatë periudhës së mbuluar nga raporti i thënë dhe shpenzimet e propozuara për t'u financuar nga Kredia gjatë periudhës 6-mujore që ndjek raportin e thënë.

(ii) (A) përshkruan progresin fizik në implementimin e Projektit, si bashkarisht dhe për periudhën e mbuluar nga raporti i thënë dhe (B) shpjegon ndryshimet midis qëllimeve të mëparshme dhe aktuale të implementimit të Projektit;

(iii) përcakton statusin e prokurimit sipas projektit dhe shpenzimet sipas kontratave të financuara nga Kredia në fundin e periudhës së mbuluar nga ky raport.

(b) me mbarimin e planit të referuar në paragrafin (a) të këtij Seksioni, Huamarrësi do të përgatisë dhe dorëzojë Shoqatës jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të çdo 3-mujori kalendarik një Raport të Menaxhimit të projektit për këtë periudhë.

Neni 5
Përfundimi

Seksioni 5.01 Data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj marrëveshje përcaktohet për qëllimet e pjesës 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 6
Përfaqësuesi i huamarrësit; Adresat

Seksioni 6.01 Ministri i financave i huamarrësit është caktuar si përfaqësues i huamarrësit për qëllimet e Pjesës 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 6.02 Adresat e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e Pjesës 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

Për Huamarrësin: Ministria e Financave Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tirana Albania	Për Shoqatën: International Development Association 1818 H Street, N.W. Washington, D.C. 20433 United States of America
Telefax: 355 42 284 94 Adresa telegrafike	Teleks
INDEVAS Washington, D.C.	24823 (RCA) 82987 (FTCC) 64145 (WUI) ose 197688(TRT)

PARA DËSHMITARËVE, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet me emrat e tyre përkatës në Distriktin e Columbias, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në datën dhe vitin e lartshënuar më parë.

SHQIPËRIA

Nga
Përfaqësuesi i autorizuar

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Nga
Nënpresident rajonal
Për Europën dhe Azinë Qendrore

SKEDULI I
TËRHEQJA E SHUMAVE TË HUASË

A. Të përgjithshme

1. Tabela më poshtë cakton kategoritë e zërave që do të financohen nga Kredia, shpërndarjen e shumave për çdo kategori dhe përqindjen e zërave që do të financohen nga çdo kategori:

Kategoria	Shuma e Kredisë së Alokuar (në SDR)	% e Shpenzimeve për t'u financuar
(1) Mallra	300.000	100% e shpenzimeve të huaja 100% e shpenzimeve lokale (me kosto fabrike) dhe 80% e mallrave të tjera të prokuruara në vend.
(2) Asistencë Teknike	4.070.000	100%
(3) Kosto operative	150.000	90%
(4) Të paalokuara	380.000	
TOTALI	**4.900.000**	

2. Për qëllimet e këtij Skeduli:

a) termi "shpenzime të huaja" nënkupton shpenzimet në monedhën e ndonjë vendi përveç atij të Huamarrësit për mallra e shërbime të ofruara nga territori i ndonjë vendi përveç atij të Huamarrësit;

b) termi "shpenzime lokale" nënkupton shpenzime në monedhën e huamarrësit për mallra ose shërbime të ofruara nga territori i huamarrësit; dhe

c) termi "kosto operative në rritje" nënkupton shpenzime në rritje të kryera nga PIU për llogari të implementimit të projektit, menaxhimit, monitorimit duke përfshirë pajisjet e zyrës, operimin e mjeteve, udhëtimin, qeranë, komunikimin dhe pagat e stafit të PIU-it duke përjashtuar ato të punonjësve civilë, të kryera për Projektin.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesën e shpenzimeve para datës së kësaj marrëveshje.

4. Shoqata mund të kërkojë tërheqje nga llogaria e kredisë mbi bazën e pasqyrave të shpenzimeve, për shpenzime për: (i) mallra me kontrata më pak se 100.000 USD secila; (ii) firmat konsulente me kontrata më pak se 100.000 USD secila; (iii) konsulente individuale me kontrata me pak se 50.000 USD secila, me terma dhe kushte si Shoqata do të specifikojë duke lajmëruar huamarrësin.

B. Llogaria Speciale

1. Huamarrësi do të hapë dhe mbajë në dollarë një llogari speciale në termat dhe kushtet e kënaqshme për Shoqatën, duke përfshirë mbrojtjen e duhur nga konfiskimi dhe shpronësimi.

2. Pasi Shoqata të ketë marrë evidencë të kënaqshme që Llogaria Speciale është hapur, tërheqjet nga Llogaria e kredisë të shumave që do të depozitohen në llogarinë Speciale do të bëhet si vijon:

a) derisa Shoqata të ketë marrë (i) Raportin e parë të menaxhimit të Projektit të referuar në seksionin 4.02 (b) të kësaj marrëveshje, dhe (ii) një kërkesë nga Huamarrësi për tërheqje mbi bazën e Raporteve të menaxhimit të projektit, tërheqjet që do të bëhen në përputhje me dispozitat e Aneksit A të këtij Skeduli 1; dhe

b) me marrjen nga Shoqata të Raportit të Menaxhimit të Projektit të kërkuar në seksionin 4.02 (b) të kësaj marrëveshje, të shoqëruar me një kërkesë nga Huamarrësi për tërheqjen mbi bazën e Raporteve të menaxhimit të projektit, të gjithë tërheqjet e mëtejshme do të bëhen në përputhje me dispozitat e Aneksit B të këtij Skeduli 1.

3. Pagesat nga Llogaria Speciale do të bëhen ekskluzivisht për shpenzimet e mundshme. Për çdo pagesë nga Llogaria Speciale, Huamarrësi do t'i japë Shoqatës, kur ajo të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, dokumente dhe evidencë tjetër që tregon që kjo pagesë është bërë ekskluzivisht për

Shpenzimet e mundshme.

4. Pavarësisht nga dispozitat e Pjesës B.2 të këtij Skeduli, Shoqata nuk do të kërkohet të bëjë depozita të tjera në Llogarinë Speciale:

(a) nëse në ndonjë kohë, Shoqata do të ketë vendosur se ndonjë nga raportet e Menaxhimit të projektit nuk jep informacionin e duhur të kërkuar sipas Seksionit 4.02 të kësaj Marrëveshje;

(b) nëse Shoqata vendos që tërheqjet e mëtejshme do të bëhen nga Huamarrësi direkt nga Llogaria e Kredisë; ose

(c) Huamarrësi nuk do t'i ketë dorëzuar Shoqatës, brenda periudhës së kohës së specifikuar në Seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj marrëveshje ndonjë nga raportet e auditimit të kërkuara për t'u dorëzuar Shoqatës në bazë të Seksionit të thënë për auditimin e (A) regjistrave dhe Llogarisë Speciale, ose (B) regjistrimeve dhe llogarive që reflektojnë shpenzimet në lidhje me të cilat janë bërë tërheqjet sipas Raporteve të Menaxhimit të Projektit.

5. Shoqata nuk do të kërkohet të bëjë depozita të mëtejshme në Llogarinë Speciale në përputhje me dispozitën e Pjesës B.2 të këtij Skeduli, nëse, në ndonjë kohë Shoqata do të ketë njoftuar Huamarrësin për qëllimin e saj për të pezulluar pjesërisht ose tërësisht të drejtën e huamarrësit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Kredisë sipas dispozitave të Seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme. Me këtë lajmërim, Shoqata do të vendosë vetë, nëse depozita të tjera në llogarinë Speciale mund të bëhen dhe çfarë procedurash duhet të ndiqen për të bërë këto depozita dhe do të lajmërojë Huamarrësin për vendimin e saj.

6. (a) Nëse Shoqata do të ketë vendosur ndonjëherë që pagesa nga Llogaria Speciale është bërë për një shpenzim që nuk është i mundshëm; ose nuk është justifikuar me evidencë dërguar Shoqatës, Huamarrësi menjëherë me lajmërimin nga Shoqata, do të sigurojë evidencë të tillë siç mund të kërkojë ajo ose depozitojë në Llogarinë Speciale (ose rimbursojë Shoqatën, nëse ajo kërkon) shumën e kësaj pagese ose pjesën e pajustifikuar. Përveç kur Shoqata bie dakord ndryshe, asnjë dispozitë e mëtejshme nuk do të bëhet në Llogarinë Speciale derisa Huamarrësi të ketë dhënë këtë evidencë ose të ketë bërë këtë depozitë ose rimbursim, siç mund të jetë rasti.

(b) Nëse Shoqata ka vendosur që ndonjë shumë e mbetur në Llogarinë Speciale nuk do të kërkohet për të mbuluar pagesa të tjera për shpenzime të tjera të mundshme gjatë periudhës 6-mujore që pason këtë vendim, Huamarrësi do të rimbursojë Shoqatën për shumën e mbetur, menjëherë me lajmërimin e Shoqatës.

(c) Huamarrësi me lajmërimin e Shoqatës, mund t'i rimbursojë Shoqatës të gjithë ose një pjesë të fondeve në depozitë në Llogarinë Speciale.

(d) Rimbursimet e Shoqatës, të bëra sipas paragrafëve 6 a, b dhe c të këtij Skeduli, do të kreditohen në Llogarinë e Kredisë për tërheqje të mëtejshme ose anulim në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj marrëveshje.

ANEKSI A
I SKEDULIT 1

OPERIMI I LLOGARISË SPECIALE KUR TËRHEQJET NUK BËHEN MBI BAZËN E RAPORTEVE TË MENAXHIMIT TË PROJEKTIT

1. Për qëllimet e këtij Aneksi, termi "alokim i autorizuar" nënkupton një shumë ekuivalente me 600 000 USD që mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë dhe depozitohet në Llogarinë Speciale sipas paragrafit 2 të këtij Ankesi, me kusht që përveç kur Shoqata bie dakord ndryshe, Alokimi i Autorizuar të kufizohet në një shumë ekuivalente me 300 000 USD deri kur shuma totale e tërheqjeve nga Llogaria e Kredisë, plus shumën totale të angazhimeve të papaguara speciale të marra nga Shoqata sipas Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme do të jenë të barabarta ose kalojnë 1 000 000 SDR.

2. Tërheqjet e Alokimit të Autorizuar dhe tërheqjet e mëpasme për të mbushur Llogarinë speciale do të bëhen si më poshtë:

(a) Për tërheqje të Alokimit të Autorizuar, Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës një kërkesë ose kërkesa për depozitë në Llogarinë speciale në një shumë ose shuma që nuk kalojnë shumën totale të alokimit të autorizuar. Mbi bazën e kësaj kërkese, Shoqata do të tërheqë në emër të Huamarrësit nga Llogaria e Kredisë dhe depozitojë në Llogarinë Speciale shumat e tilla si do të ketë kërkuar

Huamarrësi.

(b) Për mbushjen e Llogarisë Speciale, Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës kërkesa për depozitë në Llogarinë Speciale në intervale të tilla siç do të specifikojë Shoqata. Përpara ose në kohën e kësaj kërkese, Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës dokumentet dhe evidencë tjetër të kërkuar sipas Pjesës B.3 të Skedulit 1 për pagesa për të cilën është kërkuar mbushja. Mbi bazë të çdo kërkese të tillë, Shoqata në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe depozitojë në llogarinë speciale shumat e tilla si Huamarrësi do të ketë kërkuar dhe siç do të jenë treguar në dokumentet e përmendura dhe evidenca të tjera të jenë paguar nga Llogaria Speciale për shpenzime të mundshme. Të gjitha këto depozita në Llogarinë Speciale do të tërhiqen nga shoqata nga Llogaria e Kredisë sipas Kategorive respektive të mundshme.

3. Shoqata nuk do të kërkohet të bëjë depozita të tjera në Llogarinë Speciale kur shuma totale e tërhequr nga Kredia për Kategoritë e mundshme, minus shumën totale të të gjithë angazhimeve të ndërmarra nga Shoqata sipas Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme, do të arrijnë ekuivalentin e dyfishit të shumës së alokimit të autorizuar. Më pas tërheqjet nga Llogaria e Kredisë të shumës së mbetur do të ndjekin procedura të tilla si do të specifikojë Shoqata duke lajmëruar Huamarrësin. Tërheqjet e mëtejshme do të bëhen vetëm pasi Shoqata të jetë e kënaqur që të gjitha shumat e mbetura në depozitë në Llogarinë Speciale deri në datën e këtij lajmi do të përdoren për të bërë pagesa për shpenzime të mundshme.

ANEKSI B
I SKEDULIT 1

OPERIMI I LLOGARISË SPECIALE KUR TËRHEQJET BËHEN MBI BAZËN E RAPORTEVE TË MENAXHIMIT TË PROJEKTIT

1. Përveç kur Shoqata do të specifikojë ndryshe duke lajmëruar Huamarrësin, të gjitha tërheqjet nga Llogaria e Kredisë do të depozitohen nga Shoqata në Llogarinë Speciale në përputhje me dispozitat e Skedulit 1 të kësaj Marrëveshje. Çdo depozitë e tillë do të tërhiqet nga Shoqata nga Llogaria e Kredisë sipas njërës ose më shumë Kategorive të mundshme.

2. Çdo kërkesë për tërheqje nga Llogaria e Kredisë për depozitë në Llogarinë Speciale do të mbështetet nga një Raport i Menaxhimit të Projektit.

3. Me marrjen e kërkesës për tërheqjen e një shume të Kredisë, Shoqata, në emër të Huamarrësit do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe depozitojë në Llogarinë Speciale një shumë më të vogël se (a) shuma e kërkuar, dhe (b) shumën që ka vendosur Shoqata, bazuar në Raportin e Menaxhimit të Projektit që shoqëron këtë kërkesë që kërkohet për t'u depozituar në mënyrë që të financohen Shpenzimet e Mundshme gjatë periudhës 6-mujore pas datës së këtij raporti, me kusht që sidoqoftë, shuma e depozituar kështu, kur t'i shtohet shumës së treguar nga Raporti i përmendur i Menaxhimit të Projektit që do të mbetet në Llogarinë Speciale nuk do ta kalojë ekuaivalentin e 600 000 USD.

SKEDULI 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i Projektit është të ndihmojë Huamarrësin të forcojë sektorin e tij financiar, duke u përqendruar në industrinë bankare dhe të sigurimeve.

Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme, që mund të ndryshohen siç Huamarrësi dhe Shoqata mund të bien dakord kohë pas kohe për të arritur objektivat:

Pjesa A: Privatizimi i Bankës së Kursimeve

Sigurimi i Asistencës Teknike, përfshirë (i) këshillim financiar, teknik dhe ligjor dhe (ii) mbështetje menaxheriale dhe operacionale për ta sjellë Bankën e Kursimeve në pikën e shitjes.

Pjesa B: Infrastruktura Financiare

1. Sigurimi i mallrave dhe asistencës teknike për të (i) krijuar një sistem pagesash interbankar (ii) përmirësimi i standartit dhe procedurave të kontabilitetit për ndërmarrjet, bankat dhe sektorin e

sigurimeve dhe (iii) krijimi i një zyre informacioni për operimin e kredisë.

2. Sigurimi i asistencës teknike për të përmirësuar eficencën operative, financiare dhe menaxheriale të Agjencisë së Mbledhjes së Kredive të Huamarrësit.

Pjesa C: Sigurimet

1. Sigurimi i mallrave dhe asistencës teknike për të rishikuar dhe zhvilluar një kuadër ligjor rregullator për sektorin e sigurimeve.

2. Sigurimi i mallrave dhe asistencës teknike, duke përfshirë (i) këshillim financiar, teknik dhe ligjor dhe (ii) mbështetje dhe operative për të sjellë INSIG-un në pikën e shitjes.

Pjesa D: Tregjet e kapitalit

Sigurimi i Asistencës teknike për të rishikuar kuadrin ligjor dhe institucional të tregut të kapitalit.

Pjesa E: Menaxhimi i Projektit dhe Implementimi

Sigurimi i kostos operative të PIU-t

2. Sigurimi i asistencës teknike për auditimin e projektit dhe implementimin.

……

Projekti parashikohet të përfundojë më 31 dhjetor 2004.

SKEDULI 3
PROKURIMI DHE SHËRBIMET E KONSULENCËS

Seksioni I Prokurimi i Mallrave

Pjesa A: Të përgjithshme

Mallrat do të prokurohen në përputhje me (a) dispozitat e Seksionit I të "Udhëzimeve për prokurimin sipas Huave të IBRD dhe Kredive IDA" të botuara në janar 1995 dhe të ndryshuara në gusht 1996, shtator 1997 dhe janar 1999 (udhëzimet) dhe dispozitat e pjesëve të mëposhtme të këtij Seksioni I.

Pjesa B: Tenderi Ndërkombëtar

1. Përveç kur parashikohet ndryshe në pjesën C të këtij seksioni, mallrat do të prokurohen me kontrata të lidhura në përputhje me dispozitat e Seksionit II të Udhëzimeve dhe paragrafit 5 të Lidhjes 1.

2. Dispozitat e mëposhtme do të aplikohen për mallra që do të prokurohen me kontrata në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të pjesës B.

Preferencë për mallrat e prodhuara në vend

Dispozitat e paragrafëve 2.54 dhe 2.55 të Udhëzimeve dhe Lidhjes 2 do të aplikohen për mallrat e prodhuara në territorin e Huamarrësit.

Pjesa C: Procedura të tjera prokurimi

1. Blerja Ndërkombëtare

Mallrat e vlerësuara që kushtojnë më pak se 100 000 USD për kontratë, deri në shumën totale që nuk kalon 100 000 USD, mund të prokurohen me kontrata të dhëna mbi bazën e procedurave të blerjes ndërkombëtare në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.5 dhe 3.6 të Udhëzimeve.

2. Blerja Kombëtare

Mallrat e vlerësuara që kushtojnë më pak se 50 000 USD për kontratë deri në një shumë totale që nuk kaln 50 000 USD ekuivalent, mund të prokurohen me kontrata të dhëna mbi bazën e procedurave të blerjes kombëtare në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.5 dhe 3.6 të Udhëzimeve.

Pjesa D: Miratimi nga IDA i vendimeve të prokurimit.

1. Planifikimi i Prokurimit

Përpara lëshimit të ndonjë ftese për kontratë tenderi, plani i propozuar i prokurimit do t'i çohet Shoqatës për miratim, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të Lidhjes 1 të Udhëzimeve. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe punëve do të ndërmerret në përputhje me këtë plan prokurimi siç do të jenë miratuar nga Shoqata dhe me dispozitat e paragrafit 1 të përmendur më sipër.

2. Miratimi paraprak

(a) Për çdo kontratë të Seksionit I, Pjesa B me kosto të vlerësuar 100 000 USD ose më shumë, procedurat e dhëna në paragrafët 2 dhe 3 të Lidhjes I të Udhëzimeve do të aplikohen.

(b) Për kontratat e para të Seksionit I, Pjesa C.1 dhe C.2, procedurat e paragrafëve 2 dhe 3 të

Lidhjes 1 të Udhëzimeve do të aplikohen.

3. Miratimi më pas

Për çdo kontratë që nuk rregullohet nga paragrafi 2 i kësaj pjese, procedurat e paragrafit 4 të Lidhjes 1 të Udhëzimeve do të aplikohen.

Seksioni II: Punësimi i Konsulentëve

Pjesa A: Të përgjithshme

1. Shërbimet e konsulencës do të prokurohen në përputhje me (a) dispozitat e Hyrjes dhe Seksionit IV të "Udhëzime: Zgjedhja dhe punësimi i Konsulentëve nga Huamarrës të Bankës Botërore" i botuar nga Shoqata në janar 1997 dhe ndryshuar në shtator 1997 dhe janar 1999, me ndryshimet e dhëna në paragrafin 2 të kësaj pjese A (Udhëzimet e Konsulentëve) dhe (b) dispozitat e pjesëve të mëposhtme të këtij seksioni II.

Pjesa B: Zgjedhja mbi bazën e kostos dhe cilësisë

Përveç kur parashikohet ndryshe nga pjesa C e këtij seksioni, shërbimet e konsulencës do të prokurohen me kontrata të akorduara në përputhje me dispozitat e Seksionit II të Udhëzimeve të Konsulentëve, paragrafi 3 i Lidhjes 1, Lidhjes 2 dhe dispozitat e paragrafëve 3.13 deri në 3.18 të aplikueshme në zgjedhjen mbi bazën e cilësisë dhe kostos të konsulentëve.

Pjesa C: Procedura të tjera për zgjedhjen e konsulentëve.

1. Zgjedhja mbi bazën e kostos më të ulët.

Shërbimet për auditimin mund të prokurohen me kontrata të akorduara në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.1 dhe 3.6 të Udhëzimeve të Konsulentëve.

2. Zgjedhja mbi bazën e kualifikimit të konsulentëve.

Shërbimet që llogariten të kushtojnë më pak se 100 000 USD për kontratë mund të prokurohen me kontrata të akorduara në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.1 dhe 3.7 të Udhëzimeve të Konsulentëve.

3. Konsulentët individualë.

Shërbimet për detyra që plotësojnë kërkesat e dhëna në paragrafin 5.1 të Udhëzimeve të Konsulentëve, që kushtojnë jo më shumë se 230 000 USD në total, mund të prokurohen me kontrata të akorduara konsulentëve individualë në përputhje me dispozitat e paragrafëve 5.1 deri 5.3 të Udhëzimeve të Konsulentëve.

Pjesa D: Miratimi nga Shoqata i Zgjedhjes së Konsulentëve

1. Planifikimi i Zgjedhjes.

Përpara lëshimit të ndonjë kërkese për propozim konsulentësh, plani i propozuar për zgjedhjen e konsulentëve të projektit do t'i dërgohet Shoqatës për miratim, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të Lidhjes 1 të Udhëzimeve të Konsulentëve. Zgjedhja e të gjithë shërbimeve të konsulencës do të ndërmerret në përputhje me planin e zgjedhjes siç do të jetë miratuar nga Shoqata dhe me dispozitat e paragrafit 1 më sipër.

2. Miratimi paraprak

(a) Për çdo kontratë që llogaritet të kushtojë 100 000 USD ose më shumë, procedurat e dhëna në paragrafët 1.2 (përveç nënparagrafit të tretë 2(a) dhe 5 të Lidhjes 1 të Udhëzimeve të Konsulentëve do të aplikohen.

(b) Për çdo kontratë për punësimin e konsulentëve individualë të llogaritura të kushtojnë 50 000 USD ose më shumë, kualifikimet, eksperienca, termat e referencës dhe termat e punësimit të konsulentëve do t'i dërgohen Shoqatës për miratim paraprak. Kontratat do të lidhen vetëm pasi të jepet ky miratim.

3. Miratimi pas.

Për çdo kontratë që nuk rregullohet nga paragrafi 2 i kësaj pjese, procedurat e dhëna në paragrafin 4 të Lidhjes 1 të Udhëzimeve të Konsulentëve do të aplikohen.

SKEDULI 4
PROGRAMI I IMPLEMENTIMIT

Huamarrësi do të:

(a) mbajë politika dhe procedura të përshtatshme për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin mbi baza të vazhdueshme, në përputhje me tregues të kënaqshëm për Shoqatën, kryerjen e

projektit dhe arritjen e objektivave të tij;

(b) përgatisë, sipas termave të referencës të kënaqshme për Shoqatën dhe dorëzojë Shoqatës, në ose rreth 31 tetorit 2002, një raport që përmban rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të ndërmarrë mbi bazën e paragrafit (a) të këtij Seksioni, mbi progresin e arritur në projekt gjatë periudhës së datës që i paraprin datës së raportit të dhënë dhe marrjes së masave të rekomanduara për të siguruar vazhdimin eficent të projektit dhe arritjen e objektivave gjatë periudhës që ndjek këtë datë;

(c) rishikojë, bashkë me Shoqatën deri më 31 dhjetor 2002 ose ndonjë datë tjetër siç mund të kërkojë Shoqata, raportin e referuar në paragrafin (b) të këtij seksioni dhe më pas, të marrë të gjitha masat e kërkuara për të siguruar përfundimin efiçent të projektit dhe arritjen e objektivave të tij, bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të sipërpërmendur dhe pikëpamjeve të shoqatës për këtë çështje.

L I G J
Nr.8646, datë 20.7.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS EUROPIANE "PËR PASTRIMIN, DEPISTIMIN, KAPJEN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË KRIMIT""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa Europiane "Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2708, datë 28.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

KONVENTA
MBI PASTRIMIN, DEPISTIMIN, KAPJEN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TE KRIMIT

Strasburg, 8.XI.1990
Seria e traktateve evropiane Nr. 141

HYRJE

Shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës dhe Shtetet e tjerë nënshkrues të kësaj Konvente,

Duke konsideruar se qëllimi i Këshillit të Evropës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë midis anëtarëve të saj;

Të bindur për domosdoshmërinë e ndjekjes së një politike penale të përbashkët që synon mbrojtjen e shoqërisë;

Duke konsideruar se lufta kundër kriminalitetit të rëndë, që është bërë gjithnjë e më shumë problem ndërkombëtar, kërkon përdorimin e metodave moderne dhe efikase në shkallë ndërkombëtare;

Duke çmuar se njëra nga këto metoda konsiston në privimin e kriminelëve nga produktet e krimit;

Duke konsideruar se me qëllim të arritjes të këtij objektivi, duhet të ngrihet një sistem i kënaqshëm bashkëpunimi ndërkombëtar;

Ranë dakord përsa vijon:

KREU I
TERMINOLOGJIA

Neni 1
Terminologjia

Në kuptim të kësaj Konvente, shprehja:

a. "produkt" tregon çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri ashtu siç përcaktohet në nënparagrafin b të këtij neni;

b. "pasuri" do të thotë pasuri të çdo natyre, qoftë trupore ose jotrupore, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose një të drejtë mbi këtë pasuri;

c. "instrument" do të thotë të gjitha objektet e përdorura ose të destinuara për t'u përdorur me çfarëdo mënyre qoftë, plotësisht ose pjesërisht, për të kryer një ose disa vepra penale;

d. "konfiskim" do të thotë dënim ose masë e urdhëruar nga një gjykatë pas një procedimi lidhur me një ose disa vepra penale, dënim ose masë që përfundon me privimin e përhershëm të pasurisë;

e. "vepër penale kryesore" do të thotë çdo vepër penale në vijim të së cilës janë krijuar produkte dhe që mund të bëhen objekt i një vepre penale sipas nenit 6 të kësaj Konvente.

KREU II
MASAT QË DUHEN MARRË NË SHKALLË KOMBËTARE

Neni 2
Masat e konfiskimit

1. Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme për t'i lejuar asaj konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve ose pasurive, vlera e të cilave u përket këtyre produkteve.

2. Çdo Palë mundet, në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë se paragrafi 1 i këtij neni zbatohet vetëm për vepra penale ose kategori veprash penale të saktësuara në deklaratë.

Neni 3
Masat hetimore dhe masat e përkohshme

Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme për t'i lejuar asaj të identifikojë dhe të kërkojë pasuritë që i nënshtrohen konfiskimit konform nenit 2, paragrafi 1, dhe të parandalojë çdo veprim, çdo transfertë ose çdo tjetërsim lidhur me këto pasuri.

Neni 4
Kompetenca dhe teknika hetimi

1. Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme t'u dhënë atribute gjykatave ose autoriteteve të tjera kompetente për të urdhëruar marrjen në dorë të dosjeve bankare, financiare ose tregtare për të realizuar masat e parashikuara në nenet 2 e 3. Pala nuk mund të ngrejë çështjen e sekretit bankar për të refuzuar që t'u japë efekt dispozitave të këtij neni.

2. Çdo Palë merr parasysh të përshtasë masat ligjore dhe masat e tjera për t'i lejuar asaj përdorimin e teknikave speciale të hetimit që lehtësojnë identifikimin dhe kërkimin e produktit si dhe grumbullimin e provave që kanë të bëjnë me të. Ndër këto teknika, mund të përmenden urdhërat për mbikqyrjen e llogarive bankare, vrojtimi, kapja e telekomunikimeve, hyrja në sistemet informatike dhe urdhërat për të lëshuar dokumente specifike.

Neni 5
Ankimet ligjore

Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme me qëllim që personat e prekur nga masat e parashikuara nga nenet 2 e 3 të kenë të drejtë për t'u ankuar në rrugë gjyqësore për të mbrojtuar të drejtat e tyre.

Neni 6
Vepra penale e pastrimit

1. Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme për t'i atribuar aktit karakterin e veprës penale konform të drejtës së brendshme kur akti është kryer qëllimisht për:

a. kthimin ose transfertin e pasurive, për të cilat, ai që i bën, e di që këto pasuri përbëjnë produkte me qëllim që të fshihet ose të maskohet origjina e paligjshme e pasurive të tilla ose që ndihmon çdo person që është i ngatërruar në kryerjen e veprës penale kryesore për t'u shpëtuar pasojave juridike të akteve të tij;

b. fshehja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë reale të pasurive ose të drejtave të lidhur me to, për të cilat autori është në dijeni që këto pasuri përbëjnë produkte;

dhe, me rezervën e parimeve kushtetuese të saj dhe të koncepteve themelorë të sistemit juridik;

c. të fituarit, mbajtja ose përdorimi i pasurive, të cilat, ai që i fiton, i mban ose i përdor, është në dijeni, në kohën kur ai i merr, se ato përbëjnë produkte;

d. pjesëmarrja në njërën nga veprat penale të treguara konform këtij neni ose çdo shoqërim, marrëveshje, tentativë ose bashkëpunim me anë të dhënies të pranisë, të ndihmës ose të këshillave për kryerjen.

2. Me qëllim të realizimit ose të zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni:

a. nuk merret parasysh fakti që vepra penale kryesore është ose jo në kompetencë të juridiksioneve penale të Palës;

b. mund të parashikohet se veprat penale të shpallura nga ky paragraf nuk zbatohen ndaj autorëve të veprës penale;

c. pasja dijeni, qëllimi ose motivimi, të nevojshëm si elementë të veprave penale të shpallura nga ky paragraf, mund të nxirren nga rrethanat faktike objektive.

3. Çdo Palë mund të përshtasë masat që ajo i çmon të nevojshme për t'u dhënë, në bazë të së drejtës së brendshme, karakterin e veprave penale tërësisë ose pjesës së akteve të përmendura në paragrafin 1 në njerin ose në tërësinë e rasteve të mëposhtëm, kur autori:

a. duhej t'a dinte se pasuria ishte produkt;

b. ka vepruar për qëllime fitimprurëse;

c. ka vepruar për të lehtësuar vazhdimin e një veprimtarie kriminale.

4. Çdo Palë mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë se paragrafi 1 i këtij neni zbatohet vetëm për veprat penale kryesore ose kategori veprash penale kryesore të saktësuara në këtë deklaratë.

KREU III
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Ndarja 1 – Parimet e bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 7
Parimet e përgjithshme dhe masat e bashkëpunimit ndërkombëtar

1. Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim të hetimeve dhe procedimeve që synojnë konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve.

2. Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që do të jenë të nevojshme për t'i lejuar asaj, me kushtet e parashikuara në këtë kre, t'u përgjigjet kërkesave:

a. për konfiskimin e pasurive të caktuara që përbëjnë produkte ose instrumente, si dhe për konfiskimin e produkteve që përbëjnë detyrimin për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së produktit;

b. për ndihmën e ndërsjellë për qëllim të hetimit dhe të masave të përkohshme që kanë për qëllim njërën nga format e konfiskimit të përmendura në pikën "a" këtu me sipër.

Ndarja 2 – Ndihma e ndërsjellë për qëllime hetimi

Neni 8
Detyrimi për ndihmë të ndërsjellë

Palët, me kërkesë, u japin njëra-tjetrës, sa më shumë që të jetë e mundur, ndihmën e ndërsjellë për identifikimin dhe depistimin e instrumenteve, produkteve dhe pasurive që lidhen me konfiskimin. Kjo ndihmë e ndërsjellë konsiston në çdo masë që ka të bëjë me vendosjen e masës siguruese të provave lidhur me ekzistencën e pasurive të lartpërmendura, vendndodhjen ose zhvendosjen e tyre, natyrën, statusin juridik ose vlerën e tyre.

Neni 9
Ekzekutimi i ndihmës së ndërsjellë

Ndihma e ndërsjellë e parashikuar në nenin 8 ekzekutohet sipas të drejtës së brendshme të Palës së kërkuar dhe, në bazë të kësaj, dhe sipas procedurave të saktësuara në kërkesë, në masën që ato nuk janë në kundërshtim me këtë të drejtë të brendshme.

Neni 10
Transmetimi i informacioneve me nismë vetjake

Pa cenuar hetimet ose procedimet e veta, Pala mundet, edhe pa kërkesë paraprake, t'i transmetojë një Pale tjetër informacione për instrumentet dhe produktet kur ajo çmon se komunikimi i këtyre informacioneve mund të ndihmojë Palën marrëse për fillimin ose mbarëvajtjen e hetimeve ose të procedimeve, ose kur këto informacione mund të përfundojnë me një kërkesë të formuluar nga kjo Palë në bazë të këtij kreu.

Ndarja 3 – Masa të përkohshme

Neni 11
Detyrimi për të urdhëruar marrjen e masave provizore

1. Me kërkesë të një Pale që ka filluar një procedim ose një veprim për konfiskim, Pala merr masat e përkohshme që i kërkon rasti, të tilla si ngrirja ose kapja, për të parandaluar çdo veprim, çdo transfertë ose çdo tjetërsim lidhur me çdo pasuri që, më pas, mund të bëhet objekt i një kërkese konfiskimi ose që mund t'i japë rrugë plotësimit të kërkesës.

2. Pala që ka marrë një kërkesë konfiskimi konform nenit 13 merr masat e përmendura në

paragrafin 1 të këtij neni, kur për këtë është bërë kërkesa, lidhur me çdo pasuri që është objekt i kërkesës ose që mund t'i'japë rrugë plotësimit të kërkesës.

Neni 12
Ekzekutimi i masave të përkohshme

1. Masat e përkohshme të parashikuara në nenin 11 ekzekutohen konform të drejtës së brendshme të Palës së kërkuar dhe në bazë të kësaj, dhe konform procedurave të saktësuara në kërkesë në masën që ato nuk janë të papajtueshme me të drejtën e brendshme.

2. Para se të hiqet çdo masë e përkohshme që është marrë konform këtij neni, Pala e kërkuar, brenda mundësive, i jep Palës kërkuese mundësinë të paraqesë arsyet në favor të mbajtjes së masës.

Ndarja 4 – Konfiskimi

Neni 13
Detyrimi për konfiskim

1. Pala që ka marrë nga një Palë tjetër një kërkesë konfiskimi lidhur me instrumentet ose produktet që ndodhen në territorin e saj duhet:

a. të ekzekutojë vendimin e konfiskimit që del nga një gjykatë e Palës kërkuese lidhur me këto instrumente ose këto produkte; ose

b. t'ia paraqesë këtë kërkesë autoriteteve të veta kompetente për të marrë një vendim konfiskimi dhe, kur ky është dhënë, atëherë ai ekzekutohet.

2. Me qëllim të zbatimit të paragrafit 1.b të këtij neni, çdo Palë ka kompetencë, nëse e lyp nevoja, të fillojë një procedim konfiskimi në bazë të së drejtës së vet të brendshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen gjithashtu për konfiskimin lidhur me detyrimin për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së produktit, nëse pasuritë mbi të cilat mund të bëhet konfiskimi ndodhen në territorin e Palës së kërkuar. Në raste të tilla, duke proceduar me konfiskimin konform paragrafit 1, Pala e kërkuar, kur pagesa nuk është bërë, mbulon kreditimin e saj me çdo pasuri të disponueshme për këtë qëllim.

4. Kur kërkesa për konfiskim cakton një pasuri të përcaktuar, Palët mund të merren vesh që Pala e kërkuar të mund të procedojë për konfiskimin në formën e një detyrimi për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së pasurisë.

Neni 14
Ekzekutimi i konfiskimit

1. Procedurat për marrjen dhe ekzekutimin e konfiskimit në bazë të nenit 13 rregullohen sipas ligjit të Palës së kërkuar.

2. Pala e kërkuar konsiderohet e lidhur nga konstatimi i fakteve në masën që këto janë paraqitur në një dënim ose vendim gjyqësor të Palës kërkuese, ose në masën që këto mbështeten në mënyrë implicite në to.

3. Çdo Palë mundet, në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, me një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë se paragrafi 2 i këtij neni zbatohet vetëm me rezervën e parimeve kushtetuese dhe koncepteve themelorë të sistemit të vet juridik.

4. Kur konfiskimi konsiston në detyrimin për të paguar një shumë parash, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar e konverton shumën në devizë të vendit të vet sipas kursit të këmbimit në fuqi në çastin kur merret vendimi i ekzekutimit të konfiskimit.

5. Në rastet e parashikuara në nenin 13, paragrafi 1.a, vetëm Pala kërkuese ka të drejtë të vendosë lidhur me çdo kërkesë rishikimi të vendimit të konfiskimit.

Neni 15
Pasuri të konfiskuara

Pala e kërkuar disponon sipas të drejtës së saj të brendshme për të gjitha pasuritë e konfiskuara

prej saj, veç kur Palët janë marrë vesh ndryshe.

Neni 16
E drejta e ekzekutimit dhe shuma maksimale e konfiskimit

1. Kërkesa për konfiskim bërë konform nenit 13 nuk prek të drejtën e Palës kërkuese të ekzekutojë vetë kërkesën për konfiskim.

2. Asgjë nuk do të interpetohet në këtë Konventë sikur kjo të lejojë që vlera totale e pasurive të konfiskuara të jetë më e madhe se shuma e fiksuar me vendimin e konfiskimit. Kur një Palë konstaton se kjo mund të ndodhë, Palët përkatëse bëjnë konsultime për të shmangur një rrjedhojë të tillë.

Neni 17
Burgimi si masë shtrënguese

Pala e kërkuar nuk mund të vendosë burgimin si masë shtrënguese dhe as të marrë ndonjë masë tjetër kufizuese të lirisë në zbatim të një kërkese të paraqitur në bazë të nenit 13 kur Pala kërkuese nuk e ka specifikuar këtë në kërkesë.

Ndarja 5 – Refuzimi dhe shtyrja e bashkëpunimit.

Neni 18
Motivet e refuzimit

1. Bashkëpunimi në bazë të këtij kreu mund të refuzohet në rast se:

a. masa e kërkuar është në kundërshtim me parimet themelorë të rendit juridik të Palës së kërkuar; ose

b. ekzekutimi i kërkesës rrezikon të prekë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera thelbësorë të Palës së kërkuar; ose

c. pala e kërkuar çmon se rëndësia e çështjes me të cilën ka të bëjë kërkesa nuk justifikon marrjen e masës së kërkuar; ose

d. vepra penale, me të cilën lidhet kërkesa, është vepër penale politike ose fiskale; ose

e. pala e kërkuar konsideron se masa e kërkuar do të binte në kundërshtim me parimin “ne bis in idem”; ose

f. vepra penale me të cilën lidhet kërkesa nuk është vepër penale në vështrim të së drejtës së brendshme të Palës së kërkuar nëse ajo do të ishte kryer në territorin e juridiksionit të saj. Megjithatë, ky motiv refuzimi zbatohet për bashkëpunimin e parashikuar nga ndarja 2 vetëm në masën që ndihma e ndërsjellë e kërkuar passjell marrjen e masave shtrënguese.

2. Bashkëpunimi i parashikuar në ndarjen 2, në masën që ndihma e ndërsjellë e kërkuar passjell marrjen e masa shtrënguese, dhe ai i parashikuar në seksionin 3 të këtij kreu, mund të refuzohen gjithashtu në rastet kur masat e kërkuara nuk mund të merren në bazë të së drejtës së brendshme të Palës së kërkuar për qëllime hetimesh ose procedimesh, nëse kjo Palë do të kishte një çështje të brendshme të ngjashme.

3. Kur e kërkon legjislacioni i Palës së kërkuar, bashkëpunimi i parashikuar në ndarjen 2, në masën që ndihma e ndërsjellë passjell marrjen e masave shtrënguese, dhe ai i parashikuar në seksionin 3 të këtij kreu mund të refuzohen gjithashtu në rastet kur masat e kërkuara ose të gjitha masat e tjera që kanë efekte analoge nuk lejohen nga legjislacioni i Palës kërkuese, ose, sa i takon autoriteteve kompetente të Palës kërkuese, kur kërkesa nuk është autorizuar as nga gjyqtari as nga një autoritet tjetër gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe prokurorin publik, autoritete që veprojnë në fushë të veprave penale.

4. Bashkëpunimi i parashikuar në ndarjen 4 të këtij kreu mud të refuzohet gjithashtu kur:

a. legjislacioni i Palës së kërkuar nuk parashikon konfiskimin për tipin e veprës penale, me të cilën ka të bëjë kërkesa; ose

b. pa dëmtuar detyrimin sipas nenit 13, paragrafi 3, ai do të binte ndesh me parimet e të drejtës së brendshme të Palës së kërkuar përsa i përket mundësive të konfiskimit lidhur me lidhjet midis një

vepre penale dhe :

i. avantazhit ekonomik që mund të jetë përfshirë në produktin e tij; ose

ii. pasurive që mund të jenë përfshirë në instrumentet e tij; ose

c. në bazë të legjislacionit të palës së kërkuar, vendimi për konfiskim nuk mund të jepet ose të ekzekutohet për shkak të parashkrimit; ose

d. kërkesa nuk ka të bëjë me një dënim të mëparshëm, as me një vendim me karakter gjyqësor, as me një deklaratë që figuron në një vendim të tillë, deklaratë sipas së cilës janë kryer një ose disa vepra penale, dhe që ka qenë në themel të vendimit ose të kërkesës për konfiskim; ose

e. ose konfiskimi nuk është i ekzekutueshëm në Palën kërkuese, ose ai është objekt ankimi sipas rrugëve të zakonshme; ose

f. kërkesa lidhet me një vendim konfiskimi të dhënë në mungesë të personit ndaj të cilit është dhënë vendimi dhe kur, sipas Palës së kërkuar, procedimi i filluar nga Pala kërkuese dhe që ka shpënë në këtë vendim nuk ka përmbushur të drejtat minimale të mbrojtjes që i njihet çdo personi të akuzuar për një vepër penale.

5. Në vështrim të paragrafit 4.f të këtij neni, vendimi nuk konsiderohet se është dhënë në mungesë të të akuzuarit:

a. kur ai është konfirmuar ose dhënë pas kundërshtimit nga personi i interesuar; ose

b. kur ai është dhënë në apel, me kusht që apeli të jetë kërkuar nga personi i interesuar.

6. Në shqyrtimet që bëhen, për qëllimet e paragrafit 4.f të këtij neni, nëse të drejtat minimale të mbrojtjes janë respektuar, Pala e kërkuar do të mbajë parasysh faktin që personi i interesuar ka kërkuar qëllimisht t'i fshihet drejtësisë ose që ky person, pasi ka pasur mundësi të paraqesë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë, ka preferuar të mos paraqesë një ankim të tillë. Do të konsiderohet njëlloj kur personi i interesuar, pasi është thirrur rregullisht për t'u paraqitur në gjyq, ka preferuar të mos paraqitet ose të mos kërkojë shtyrjen e shqyrtimit të çështjes.

7. Pala nuk mund të pretendojë të ngrejë çështjen e sekretit bankar për të justifikuar refuzimin e saj për çfarëdo bashkëpunimi të parashikuar në këtë kre. Kur e drejta e vet e brendshme e kërkon, Pala mund të kërkojë që kërkesa për bashkëpunim, që do të passjellë heqjen e sekretit bankar, të lëshohet ose nga gjyqtari ose nga një autoritet tjetër gjyqësor, duke përfshirë edhe prokurorin publik, autoritete që veprojnë në fushë të veprave penale.

8. Pa dëmtuar motivin e refuzimit të parashikuar në paragrafin 1.a të këtij neni:

a. fakti që personi, që është bërë objekt i një hetimi të ndërmarrë ose i një vendimi për konfiskim i marrë nga autoritetet e Palës kërkuese është një person juridik, nuk mund të ngrihet nga Pala e kërkuar si pengesë për çfarëdo bashkëpunimi në bazë të këtij kreu;

b. fakti që personi fizik, ndaj të cilit është dhënë një vendim për konfiskimin e produkteve, më pas ka vdekur si dhe fakti që personi juridik, ndaj të cilit është dhënë një vendim për konfiskimin e produkteve, më pas është shuar, nuk mund të paraqiten si pengesa për ndihmën e ndërsjellë të parashikuar nga neni 13 paragrafi 1.a

Neni 19

Shtyrja

Pala e kërkuar mund të shtyjë ekzekutimin e masave të parashikuara në një kërkesë kur ato rrezikojnë të dëmtojnë hetimet ose procedimet e ndërmarra nga autoritetet e veta.

Neni 20

Pranimi i pjesshëm ose me kusht i kërkesës

Para se të refuzojë ose të shtyjë për më vonë bashkëpunimin në bazë të këtij kreu, Pala e kërkuar shqyrton, kur e kërkon rasti pas konsultimeve me Palën kërkuese, nëse mund t'i japë të drejtë asaj pjesërisht ose me rezervë kushtesh që ajo e çmon të nevojshëm.

Ndarja 6 – Njoftimi dhe mbrojtja e të drejtave të të tretëve

Neni 21
Njoftimi i dokumenteve

1. Palët u japin njëra-tjetrës, sa më shumë të jetë e mundur, ndihmën e ndërsjellë për njoftimin e akteve gjyqësore personave përkatës lidhur me masat e përkohshme dhe konfiskimin.

2. Asgjë në këtë nen nuk mund të bëhet pengesë:

a. për mundësinë e dërgimit të akteve gjyqësore në rrugë postare drejtpërdrejt personave që ndodhen jashtë shtetit;

b. për mundësinë e nëpunësve të ministrive, funksionarëve ose personave kompetentë të Palës së origjinës për të bërë veprime lidhur me njoftimin ose dorëzimin e akteve gjyqësore drejtpërdrejt me anë të autoriteteve konsullore të kësaj Pale ose me anë të nënpunësve të ministrive, funksionarëve ose personave të tjerë kompetentë të Palës destinatare, veç kur Pala destinatare i ka bërë një deklaratë të kundërt Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

3. Gjatë njoftimit të akteve gjyqësore jashtë shtetit personave përkatës që kanë të bëjën me masa të përkohshme ose vendime konfiskimi të urdhëruara në Palën e origjinës, kjo Palë i informon këta persona për të drejtën e garantuar nga legjislacioni për ankim në gjykatë.

Neni 22
Njohja e vendimeve të huaja

1. E vënë në lëvizje nga një kërkesë bashkëpunimi sipas ndarjeve 3 e 4, Pala e kërkuar njeh çdo vendim gjyqësor të dhënë në Palën kërkuese përsa i përket të drejtave që kërkohen nga të tretët.

2. Njohja mund të refuzohet:

a. kur të tretët nuk kanë pasur mundësi të mjaftueshme për të kërkuar të drejtat e tyre; ose

b. kur vendimi është i papajtueshëm me një vendim të mëparshëm të dhënë në Palën kërkuese për të njëjtën çështje; ose

c. kur ai është i papajtueshëm me rendin publik të Palës së kërkuar; ose

d. kur vendimi është dhënë në kundërshtim me dispozitat në fushë të kompetencës ekskluzive të parashikuar nga e drejta e Palës së kërkuar.

Ndarja 7 – Procedura dhe rregulla të tjera të përgjithshme

Neni 23
Autoriteti qendror

1. Palët caktojnë një autoritet qendror ose, kur e lyp nevoja, disa autoritete të ngarkuara me dërgimin e kërkesave të formuluara në bazë të këtij kreu, për t'iu përgjigjur, për t'i ekzekutuar ose për t'ua transmetuar autoriteteve që kanë kompetencë për ekzekutim.

2. Çdo Palë i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, emërtimin dhe adresën e autoriteteve kompetente të caktuar për zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 24
Korrespondenca e drejtpërdrejtë

1. Autoritetet qendrore komunikojnë drejtpërdrejt midis tyre.

2. Në raste urgjente, autoritetet gjyqësore, duke përfshirë prokurorin publik, të Palës kërkuese mund t'u dërgojnë drejtpërdrejt kërkesat dhe komunikimet e parashikuara nga ky kre autoriteteve homologe të Palës së kërkuar. Në raste të tilla, një kopje duhet t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit qendror të Palës së kërkuar me ndërmjetësinë e autoritetit qendror të Palës kërkuese.

3. Çdo kërkesë ose komunikim i formuluar në zbatim të paragrafëve 1 e 2 të këtij neni mund të paraqitet me ndërmjetësinë e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

4. Kur një kërkesë paraqitet në bazë të paragrafit 2 të këtij neni dhe kur autoriteti i vënë në

lëvizje nuk është kompetent për t'i dhënë rrugë, ai ia transmeton atë autoritetit kompetent të vendit të vet dhe informon për këtë drejtpërdrejt Palën kërkuese.

5. Kërkesat ose komunikimet e paraqitura në bazë të ndarjes 2 të këtij kreu, që nuk passjellin marrjen e masave shtrënguese, mund të transmetohen drejtpërdrejt nga autoriteti kompetent i Palës kërkuese autoritetit kompetent të Palës së kërkuar.

Neni 25

Forma e kërkesave dhe gjuhët

1. Të gjitha kërkesat e parashikuara nga ky kre bëhen me shkrim. Lejohet edhe përdorimi i mjeteve moderne të telekomunikimit, të tilla si faksi.

2. Me rezervën e dispozitave të pragrafit 3 të këtij neni, nuk do të kërkohet përkthimi i kërkesave ose shkresave që u aneksohen atyre.

3. Çdo Palë mundet, në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të rezervojë të drejtën të kërkojë që kërkesat dhe shkresat që u aneksohen atyre të shoqërohen me përkthim në gjuhën e vet ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës ose në atë gjuhë që ajo do të caktojë. Çdo Palë mundet, me këtë rast, të deklarojë se ajo është e gatshme të pranojë përkthime në çdo gjuhë tjetër që ajo do të caktojë. Palët e tjera mund të zbatojnë rregullën e reciprocitetit.

Neni 26

Legalizimi

Dokumentet e transmetuara në zbatim të këtij kreu nuk u nënshtrohen asnjë formaliteti të legalizimit.

Neni 27

Përmbajtja e kërkesës

1. Çdo kërkesë bashkëpunimi e parashikuar nga ky kre duhet të saktësojë:

a. autoritetin që e ka bërë dhe autoritetin e ngarkuar të kryejë hetimet ose procedimet;

b. objektin dhe motivin e kërkesës;

c. çështjen, duke përfshirë aty faktet që lidhen më të (të tilla si data, vendi dhe rrethanat e veprës penale), me të cilën lidhen hetimet ose procedimet, veç në rast se kërkesa përmban një njoftim;

d. në masën që bashkëpunimi passjell marrjen e masave shtrënguese:

i. tekstin e dispozitave ligjore ose, kur kjo nuk është e mundur, brendinë e ligjit përkatës të zbatueshëm; dhe

ii. një tregues sipas të cilit masa e kërkuar ose çdo masë tjetër që ka efekte të ngjashme mund të merret në territorin e Palës kërkuese në bazë të legjislacionit të vet;

e. kur është e nevojshme, dhe kur është e mundur:

i. detaje lidhur me personin/personat përkatës, duke përfshirë emrin, datën dhe vendlindjen, shtetësinë dhe vendndodhjen e tij/tyre, dhe, në rast se është person juridik selinë e tij; dhe

ii. pasuritë, lidhur me të cilat kërkohet bashkëpunimi, vendndodhjen e tyre, lidhjet e tyre me personin/personat në fjalë, çdo lidhje me veprën penale si dhe çdo informacion që disponohet lidhur me interesat për këto pasuri që lidhen me të tjerë; dhe

f. çdo procedim i veçantë që dëshirohet nga Pala kërkuese.

2. Kur kërkesa për masë të përkohshme e paraqitur në bazë të ndarjes 3 synon kapjen e një pasurie që mund të jetë objekt i një vendimi për konfiskim që ka të bëjë me detyrimin për pagimin e një shume parash, kjo kërkesë duhet të tregojë shumën maksimale që kërkohet për t'u marrë për këtë pasuri.

3. Përveç treguesve të përmendur në paragrafin 1, çdo kërkesë e formuluar në zbatim të ndarjes 4 duhet të përmbajë:

a. në rastin e nenit 13, pagrafi 1a:

i. kopje e vërtetuar konform e vendimit të konfiskimit dhënë nga gjykata e Palës kërkuese dhe

paraqitja e motiveve që janë vënë në themel të vendimit, kur ato nuk përmenden në vetë vendimin;

ii. vërtetimin e autoritetit kompetent të Palës kërkuese, sipas të cilit vendimi për konfiskim është i ekzekutueshëm dhe nuk është objekt ankimi sipas rrugëve të zakonshme;

iii. informacione lidhur me masën, gjer ku do të vejë ekzekutimi; dhe

iv. informacione lidhur me domosdoshmërinë e marrjes së masave të përkohshme;

b. në rastet e nenit 13, paragrafi 1.b, një paraqitje e fakteve të referuara nga Pala kërkuese që të jetë e mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Palës së kërkuar të marrë vendim në bazë të së drejtës së brendshme të saj;

c. kur persona të tretë kanë pasur mundësi të kërkojnë të drejta, dokumentet që tregojnë se ata e kanë pasur këtë mundësi.

Neni 28
Të meta të kërkesave

1. Kur kërkesa nuk është konform me dispozitat e këtij kreu, ose kur informacionet e dhëna nuk janë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Palës së kërkuar të marrë vendim për kërkesën, kjo Palë mund t'i kërkojë Palës kërkuese të modifikojë kërkesën ose t'a plotësojë atë me informacione suplementare.

2. Pala e kërkuar mund të caktojë një afat për të marrë këto modifikime ose infomacione.

3. Në pritje të marrjes së modifikimeve ose informacioneve të kërkuara lidhur me një kërkesë të paraqitur në zbatim të ndarjes 4 të këtij kreu, Pala e kërkuar mund të urdhërojë të gjitha masat e parashikuara në ndarjet 2 e 3 të këtij kreu.

Neni 29
Konkurrim kërkesash

1. Kur Pala e kërkuar merr me shumë se një kërkesë të paraqitura në bazë të ndarjeve 3 e 4 të ketij kreu lidhur me të njejtin person ose të njejtat pasuri, konkurrimi i kërkesave nuk e pengon Palën e kërkuar t'i trajtojë kërkesat që passjellin marrjen e masave të përkohshme.

2. Në rast konkurrimi kërkesash të paraqitura në bazë të ndarjes 4 të këtij kreu, Pala e kërkuar duhet të ketë parasysh të konsultohet me Palët kërkuese.

Neni 30
Detyrimi për motivim

Pala e kërkuar duhet të motivojë çdo vendim që refuzon, që shtyn ose që i vë kushte çdo bashkëpunimi të kërkuar në bazë të këtij kreu.

Neni 31
Informimi

1. Pala e kërkuar informon pa vonesë Palën kërkuese:

a. për dhënien rrugë menjëherë kërkesës së formuluar në bazë të këtij kreu;

b. për rezultatin përfundimtar të dhënies rrugë të kërkesës;

c. për vendimin që refuzon, që shtyn ose i vë kushte, tërësisht ose pjesërisht, çdo bashkëpunimi të parashikuar nga ky kre;

d. për të gjitha rrethanat që bëjnë të pamundur ekzekutimin e masave të kërkuara ose që rrezikojnë ta vonojnë shumë atë; dhe

e. në rast të masave të përkohshme të marra për një kërkesë të formuluar në zbatim të ndarjes 2 ose 3 të këtij kreu, për dispozitat e të drejtës së vet të brendshme që do të shkaktonin automatikisht heqjen e masës.

2. Pala kërkuese informon pa vonesë Palën e kërkuar:

a. për çdo rishikim, vendim ose fakt tjetër që i heq tërësisht ose pjesërisht vendimit të konfiskimit karakterin e ekzekutueshëm të tij;

b. për çdo ndryshim, në fakt dhe në ligj, që e bën të pajustifikuar këtej e tutje çdo veprim të

ndërmarrë në bazë të këtij kreu.

3. Kur njera Palë kërkon konfiskimin e pasurive në disa Palë mbi bazën e të njëjtit vendim konfiskimi, ajo informon për këtë të gjitha Palët përkatëse për ekzekutimin e vendimit.

Neni 32
Përdorimi i kufizuar

1. Pala e kërkuar mund t'ia nënshtrojë ekzekutimin e një kërkese kushtit që informacionet ose elementet e provave të marra, pa miratimin e saj paraprak, të mos përdoren ose transmetohen nga autoritetet e Palës kërkuese për qëllim hetimesh ose procedimesh të ndryshme nga ato të saktësuara në kërkesë.

2. Çdo Palë mundet, në çastin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit të saj, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë se informacionet ose elementet e provave të dhëna prej saj në bazë të këtij kreu, pa miratimin e saj paraprak, nuk mund të përdoren nga autoritetet e Palës kërkuese për qëllime hetimesh ose procedimesh, të ndryshme nga ato të saktësuara në kërkesë.

Neni 33
Konfidencialiteti

1. Pala kërkuese mund të kërkojë nga Pala e kërkuar që ajo të ruajë konfidenciale kërkesën dhe brendinë e saj, veç kur është e nevojshme për ekzekutimin e kërkesës. Kur Pala e kërkuar nuk mund t'i përmbahet këtij kushti të konfidencialitetit, ajo duhet të informojë për këtë Palën kërkuese brenda një afati shumë të shpejtë.

2. Pala kërkuese duhet, kur për këtë i është bërë kërkesë dhe me kusht që kjo të mos bie ndesh me parimet themelorë të së drejtës së vet të brendshme, të ruajë konfidencialë të gjitha provat dhe infomacionet e komunikuara nga Pala e kërkuar, veç kur është e nevojshme për qëllim të hetimeve ose të procedimit të përshkruar në kërkesë.

3. Me rezervën e dispozitave të së drejtës së vet të brendshme, Pala që ka marrë një transmetim të vetvetishëm informacionesh në bazë të nenit 10, duhet t'i përmbahet kushtit të konfidencialitetit të kërkuar nga Pala që transmeton informacionin. Nëse Pala tjetër nuk mund t'i përmbahet një kushti të tillë, ajo duhet të informojë për këtë Palën që transmeton informacionin në afat sa më të shpejtë.

Neni 34
Shpenzimet

Shpenzimet e zakonshme të bëra për të ekzekutuar një kërkesë janë në ngarkim të Palës së kërkuar. Kur del e nevojshme kryerja e shpenzimeve të mëdha ose të jashtëzakonshme për t'i dhënë rrugë kërkesës, Palët merren vesh për të fiksuar kushtet në të cilat kjo do të ekzekutohet si dhe mënyrën sesi do të mbulohen shpenzimet.

Neni 35
Shpërblimi i dëmit

1. Kur një person ka ngritur padi mbi përgjegjësinë për dëmet që rezultojnë nga një akt ose një ometim në kuadër të bashkëpunimit të parashikuar nga ky kre, Palët përkatëse duhet të konsultohen midis tyre, dhe kur është rasti, të përcaktojnë shlyerjen eventuale të dëmshpërblimit të duhur.

2. Pala që është objekt i një kërkesë për shpërblim të dëmit detyrohet të informojë për këtë pa vonesë Palën tjetër kur kjo mund të ketë interes në çështjen.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 36
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës dhe për Shtetet jo anëtarë që kanë marrë pjesë në hartimin e saj. Këta Shtete mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u bashkuar me:

a. nënshkrimin pa rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

b. nënshkrimin, me rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi, që vijohet me ratifikim, pranim ose miratim.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

3. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës kur tre Shtete, nga të cilët të paktën dy Shtete anëtarë të Këshillit të Evropës, do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u bashkuar me këtë Konventë, konform dispozitave të paragrafit 1.

4. Për çdo Shtet nënshkrues që do të shprehë më pas pëlqimin e vet për t'u bashkuar me Konventën, kjo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës së shprehjes të pëlqimit për t'u bashkuar me Konventën konform dispozitave të paragrafit 1.

Neni 37
Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konventë, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mundet, pasi është konsultuar me Shtetet kontraktues të Konventës, të ftojë çdo Shtet jo anëtar i Këshillit të Evropës për të aderuar në këtë Konventë me anë të një vendimi që merret me shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me unanimitetin e përfaqësuesve të Shteteve kontraktues që gëzojnë të drejtën e anëtarit të Komitetit.

2. Për çdo Shtet aderues, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumenteve të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 38
Zbatimi territorial

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo Shtet mundet, në çdo çast tjetër më pas, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të caktuar në deklaratë. Konventa do të hyjë në fuqi për këtë territor ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mëparshëm mund të tërhiqet, përsa i takon çdo territori të caktuar në deklaratë, me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të ketë efektet e veta ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 39
Marrëdhëniet me konventat dhe marrëveshjet e tjera

1. Kjo Konventë nuk prek të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga konventa ndërkombëtare shumëpalëshe lidhur me çështje të veçanta.

2. Palët në Konventë mund të përfundojnë midis tyre marrëveshje dypalëshe ose

shumëpalëshe lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, me qëllim të plotësimit ose përforcimit të dispozitave të kësaj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që ajo mishëron.

3. Kur dy ose disa Palë kanë përfunduar tashmë një marrëveshje ose një traktat për një objekt që mbulohet nga kjo Konventë, ose kur ato kanë vendosur sipas një mënyre tjetër marrëdhëniet e tyre lidhur me këtë subjekt, ato do të kenë të drejtë të zbatojnë atë marrëveshje, traktat në vend të kësaj Konvente, nëse ai lehtëson bashkëpunimin ndërkombëtar.

Neni 40
Rezervat

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të deklarojë se do të përdorë një ose disa rezerva që figurojnë në nenet 2 paragrafi 2; 6, paragrafi 4; 14 paragrafi 3; 21 paragrafi 2; 25 paragrafi 3; dhe 32 paragrafi 2. Asnjë rezervë tjetër nuk pranohet.

2. Çdo Shtet që ka formuluar një rezervë në bazë të paragrafit të mëparshëm mund ta tërheqë atë tërësisht ose pjesërisht, duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja do të fillojë efektet në datën e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Pala që ka formuluar një rezervë lidhur me një dispozitë të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë për zbatimin e kësaj dispozite nga një Palë tjetër; ajo mundet, nëse rezerva është e pjesshme ose me kusht, të pretendojë për zbatimin e kësaj dispozite në atë masë që ajo e ka pranaur atë.

Neni 41
Amendamentet

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamente ndaj kësaj Konvente dhe çdo propozim do t'u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës Shteteve anëtarë të Këshillit dhe çdo Shteti jo anëtar që ka aderuar ose është ftuar të aderojë në këtë Konventë konform dispozitave të nenit 37.

2. Çdo amendament i propozuar nga një Palë i komunikohet Komitetit Evropian për problemet kriminale, i cili i paraqet Komitetit të Ministrave mendimin e vet për amendamentin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave shqyrton amendamentin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga Komiteti Evropian për problemet kriminale, dhe mund të miratojë amendamentin.

4. Teksti i çdo amendamenti të miratuar nga Komiteti i Ministrave konform paragrafit 3 të këtij neni u transmetohet Palëve për pranim.

5. Çdo amendament i miratuar konform paragrafit 3 të këtij neni do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pasi të gjitha Palët të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.

Neni 42
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Komiteti Evropian për problemet kriminale të Këshillit të Evropës është i detyruar të informojë për interpretimin dhe zbatimin e kësaj Konvente.

2. Në rast mosmarrëveshjesh midis Palëve për interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, Palët do të përpiqen të arrijnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes me bisedime ose me çdo mjet tjetër paqësor i zgjedhur sipas dëshirës së tyre, duke përfshirë këtu paraqitjen e mosmarrëveshjes Komitetit Evropian për problemet kriminale, një gjykate arbitrale që do të marrë vendime që i lidh Palët në mosmarrëveshje, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sipas një marrëveshje të përbashkët të Palëve përkatëse.

Neni 43
Denoncimi

1. Çdo Palë mundet, në çdo çast, të denoncojë këtë Konventë duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Denoncimi do të fillojë efektet ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Megjithatë, kjo Konventë vazhdon të zbatohet për ekzekutimin e konfiskimit, në bazë të nenit 14, të kërkuar konform dispozitave të saj para se të fillojë efektet denoncimi.

Neni 44
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë Shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo Shtet që ka aderuar në këtë Konventë për:

a. çdo nënshkrim;

b. depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

c. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente konform neneve të saj 36 dhe 37;

d. çdo rezervë në bazë të nenit 40 paragrafi 1;

e. çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë.

Me këtë mirëbesim, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 8 nëntor 1990, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj të besueshëm, në një ekzemplar të vetëm që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'u komunikojë nga një kopje të vërtetuar konform secilit nga Shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës, Shteteve jo anëtarë që kanë marrë pjesë në hartimin e Konventës dhe çdo Shteti të ftuar për të aderuar në të.

L I G J
Nr.8647, datë 24.7.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8030, DATË 15.11.1995
"PËR KONTRIBUTIN E SHTETIT PËR FAMILJET E PASTREHA"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 2 paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

"Familjet e pastreha që banojnë në banesa shtetërore ish-pronë private, trajtohen nga shteti si kategori emergjente. Shteti u siguron atyre banesë nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, me sipërfaqe banimi aq sa u takon sipas normave të strehimit dhe përbërjes familjare para datës 1.12.1992, por jo më tepër sesa disponon. Privatizimi i këtyre banesave kryhet sipas kritereve të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, duke i shtuar tarifës indeksin e korrigjimit të çmimeve.

Qiramarrësit në banesa ish-pronë private, që kërkojnë të sigurojnë banesë nëpërmjet tregut të lirë, përfitojnë falas nga shteti diferencën e vlerës sipas kostos aktuale të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave, me tarifën e indeksuar."

Neni 2

Pas nenit 2 shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje:

"Familjet e konsideruara të pastreha, që në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë në përbërje të tyre invalidë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ish-partizanë, luftëtarë antifashistë që kanë marrë pjesë në formacionet antifashiste para datës 29 nëntor 1944, përfitojnë strehim falas nga shteti sipas kritereve të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995."

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Të gjitha veprimet financiare për dhënien e kredive dhe të subvencioneve shtetërore do të kryhen nga Banka e Kursimeve. Për banesat e ndërtuara ose të blera në tregun e lirë nga Enti Kombëtar i Banesave, subvencionet shtetërore për familjet e pastreha do të trajtohen nga vetë Enti Kombëtar i Banesave."

Neni 4

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Deri në zgjidhjen e strehimit, qytetarët e pastrehë që banojnë në banesa ish-pronë private, do të paguajnë qira sipas tarifave që paguanin në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve"."

Neni 5

Në zbatim të këtij ligji ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për procedurat e veprimeve që do të kryhen nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe për sigurimin e burimeve financiare.

Neni 6

Të gjitha dispozitat ligjore dhe nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 7

Ky ligj dhe efektet e tij financiare hyjnë në fuqi më 1 janar 2001.

Shpallur me dekretin nr.2711, datë 28.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

V E N D I M
Nr.455, datë 24.7.2000

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 17 pika 3 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Byrosë së Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Zoti Gaspër Kokaj zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
II.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

D E K R E T
Nr.2705, datë 28.07.2000

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË ORGANEVE TË PUSHTETIT VENDOR

Në mbështetje të nenit 92, germa "gj" të Kushtetutës, si dhe të neneve 4,75 dhe 63, të ligjit nr.8609, datë 08.05.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

D E K R E T O J:

Neni 1

Zgjedhjet për organet e pushtetit vendor të zhvillohen ditën e dielë, datë 1 tetor 2000.

Në qoftë se në raundin e parë të zgjedhjeve asnjeri prej kandidatëve konkurues nuk fiton shumicën e votave, raundi i dytë të zhvillohet ditën e dielë, datë 15 tetor 2000.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.360, datë 14.7.2000

PËR LIRIMIN NGA SHËRBIMI CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21,23,24 dhe 29, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Dorëheqja

1. Nëpunësi largohet nga detyra edhe kur jep dorëheqjen. Afati i njoftimit të dorëheqjes është deri në 45 ditë. Në raste të justifikuara dhe me miratimin e eprorit të drejtpërdrejtë ky afat mund të jetë më i shkurtër, por jo me pak se 10 ditë.

2. Dorëheqja i paraqitet me shkrim eprorit të drejtpërdrejtë dhe për dijeni drejtorit të personelit të institucionit përkatës.

3. Mosrespektimi i afateve nga nëpunësi, të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, përbën shkelje të rëndë disiplinore.

Paaftësia përfundimtare, për shkak të gjendjes shëndetësore

4. Nëpunësi civil është detyruar të paraqesë deri më 10 janar të çdo viti pranë Drejtorisë së personelit, të institucionit çertifikatën e kontrollit shëndetësor.

5. Nëpunësi civil largohet nga shërbimi civil kur bëhet i paaftë, përgjithmonë, për të kryer detyrat për shkak të gjendjes shëndetësore. Paaftësia shëndetësore përcaktohet nga Drejtoria e Personelit, në bazë të çertifikatës së kontrollit shëndetësor dhe sipas kritereve të paaftësisë shëndetësore.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, përcakton kriteret e paaftësisë shëndetësore.

Ristrukturimi i institucionit

7. Vendimi për kalimin e nëpunësit në listën e pritjes, për shkak të ristrukturimit të institucionit, merret nga sekretari i përgjithshëm i këtij institucioni.

8. Vendimi i sekretarit të përgjithshëm, për kalimin e nëpunësit në listën e pritjes, (sipas pikës 10 të këtij vendimi), për shkak të ristrukturimit të institucionit, mbështetet në krahasimin e përshkrimit të punës që ka kryer nëpunësi deri në çastin e ristrukturimit me përshkrimin e punës për vendet e mbetura, të ristrukturuara, apo me vendet e reja, të krijuara, si dhe në vlerësimin e rezultateve individuale në punë, dy viteve të fundit.

9. Nëpunësit, të cilët kanë kryer punë me përshkrim të njëjtë apo të ngjashëm, me përshkrimin e vendeve të reja, të krijuara apo të mbetura, dhe të ristrukturuara dhe që janë vlerësuar pozitivisht në dy vitet e fundit, do të mbahen në punë në kufirin e përgjithshëm të vendeve të miratuara.

10. Nëpunësit e larguar, në kuadër të ristrukturimit të institucionit regjistrohen në një listë pritjeje, që mbahet nga Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore dhe nga departamenti, drejtoria apo seksioni i personelit, drejtoria e personelit e institucioneve të pavarura, të cilët, në rastin e parë, kur rezulton një vend i lirë dhe nëse kandidati plotëson kërkesat e veçanta për vendin e lirë, e emërojnë në atë vend, pa konkurim.

Ndryshimi i kërkesave për vendin e punës

11. Pika 10 e këtij vendimi, zbatohet edhe në rastet e lirimit nga detyra, pas periudhës së përshtatjes profesionale, kur vërehet papërshtatshmëri me vendin e ri, për shkak të ndryshimit të kërkesave për vendin e punës.

Lirimi për paaftësi

12. Menjëherë me dhënien e vlerësimit të dytë negativ, sipas dispozitave përkatëse për vlerësimin e rezultateve individuale në punë, eprori i drejtpërdrejtë i propozon Departamentit të Administratës Publike, për institucionet qendrore, apo drejtorisë, departamentit apo seksionit të personelit për institucionet e pavarura lirimin e nëpunësit nga shërbimi civil.

13. Departamenti i Administratës Publike apo njësia e personelit, pasi dëgjon nëpunësin civil dhe eprorin e drejtpërdrejtë vendos:

a) mospranimin e propozimit.

b) pranimin e propozimit dhe lirimin nga detyra.

14. Vendimi jepet me shkrim dhe i njoftohet nëpunësit si dhe institucionit përkatës brenda 2 ditëve nga marrja e tij.

15. Në rast ankimi, pasi shqyrton çështjen komisioni i shërbimit civil vendos:

a) shfuqizimin e vendimit.

b) lënien në fuqi të vendimit.

16. Vendimi i komisionit i dërgohet zyrtarisht nëpunësit, institucionit dhe Departamentit të Administratës Publike.

17. Në rastin e shfuqizimit të vendimit nga komisioni i shërbimit civil nëpunësi merr dhe pagën e plotë, që nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare.

Njoftimi në Departamentin e administratës Publike

18. Institucionet e administratës qendrore, brenda 2 ditëve, sipas pikave të mësipërme, dërgojnë në Departamentin e Administratës Publike shkresat me lirimet nga detyra së bashku me gjithë dokumentet përkatëse.

Dorëzimi i detyrës

19. Nëpunësi që largohet nga detyra duhet të bëjë të gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e

detyrës, në mënyrë korrekte dhe në përputhje me etikën e nëpunësit civil.

20. Nëpunësi duhet t'i bëjë pasardhësit dorëzimin e plotë të dokumentacionit, të pajisjeve dhe të mjeteve të punës në inventar, ose në pamundësi, eprorit të drejtpërdrejtë apo një nëpunësi tjetër civil, të cilit eprori ia delegon këtë detyrë.

21. Dorëzimi i detyrës, dokumentacionit, pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar, bëhet, si rregull, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit të lirimit. Në raste të veçanta dhe me urdhër të sekretarit të përgjithshëm ky afat mund të zgjatet edhe deri me 5 ditë të tjera.

22. Mosdorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar brenda afateve të përcaktuar në pikën 21, të këtij vendimi përbën shkelje të rëndë disiplinore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.373, datë 14.7.2000

PËR RIVENDOSJEN E SISTEMIT TË KUJDESTARËVE DHE TË ROJEVE, NË OBJEKTET MONUMENT KULTURE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8279, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000" dhe të neneve 2 dhe 116, të ligjit nr.7867, datë 12.10.1994, "Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme", me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Rivendosjen e sistemit të kujdestarëve dhe të rojeve, në objekt monument kulture.

2. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e vitit 2000, t'i shtohet fondi prej 3 270 000 (tre milionë e dyqindeshtatëdhjetë mijë) lekësh, në zërin "shpenzime operative".

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që:

a) të hartojë listën e monumenteve të kulturës, që do të vendosen nën kujdestari, apo në ruajtje;

b) të bëjë shpërndarjen e fondit, të miratuar sipas listës së mësipërme;

c) të nxjerrë aktet në zbatim të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.413, datë 27.7.2000

PËR TRAJTIMIN E PROBLEMEVE TË NGRITURA NGA FAMILJET QË U JANË PËRMBYTUR TOKAT NGA UJËMBLEDHËSI I HIDROCENTRALIT TË FIERZËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të dekretit nr.886, datë 12.7.1994, të Presidentit,

“Për dhënie kredie banorëve të zonave të përmbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë e Pukë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, ministrit të Pushtetit Lokal, ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, ministrit të Financave, ministrit të Punëve Publike, ministrit të Shtetit dhe ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Familjeve, që u janë përmbytur tokat nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës dhe që nuk dëshirojnë të lëvizin në një vendbanim tjetër, kur vërtetojmë, sipas ligjit pronësinë mbi tokën e përmbytur, u njihet e drejta e pjesëmarrjes në privatizimin e hidrocentralit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Familjet, që vullnetarisht kanë kërkuar të lëvizin, të sistemohen në rrethet Durrës, Kurbin, Lezhë dhe Lushnjë dhe të trajtohen, me tokë e kredi, sipas kritereve të përcaktuara në vendimin nr.306, datë 30.6.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për masat që do të merren për zonat e përmbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë”, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 20.2.1995, për zbatimin e vendimit të sipërpërmendur, ndryshuar me vendimin nr.125, datë 26.2.1996, të Këshillit të Ministrave.

Këto familje të vërtetojnë me dokumente, sipas ligjeve e akteve nënligjore në fuqi, pronësinë për sipërfaqen e tokës që u është përmbytur, si dhe të paraqesin vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose zyra e kadastrës së rrethit të tyre, që nuk kanë përfituar tokë, sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991.

Familjeve që lëvizin u jepet tokë në natyrë, sipas sipërfaqes që vërtetojnë se kanë pasur pronësi dhe që u është përmbytur, duke u konvertuar me koeficientin e përcaktuar në vendimin nr.306, datë 30.6.1994, të Këshillit të Ministrave, por jo më shumë se 1800 m2 për çdo familje. Familjet që trajtohen sipas kësaj pike gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procesin e privatizimit të hidrocentraleve, vetëm për pjesën e tokës, në pronësi, që nuk u është dhënë, sipas përcaktimit në këtë pikë të vendimit.

Për efekt të këtij vendimi do të trajtohen vetëm familjet që kanë qenë të regjistruara në regjistrin e gjendjes civile deri më 31 dhjetor 1994.

3. Lëvizja e familjeve që u janë përmbytur tokat nga ndërtimi i hidrocentralit, të realizohet duke filluar nga viti 2001 e ndarë proporcionalisht në vitet në vazhdim në varësi me fondet që do të përcaktohen në buxhetin e shtetit për vitet përkatëse.

4. Numri dhe radha e lëvizjes së familjeve në vite do të përcaktohet nga organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me prefekturat, sipas planit të dërguar nga Ministria e Pushtetit Lokal, në përputhje me fondet e parashikuara në buxhet për vitin përkatës, duke u dhënë përparësi familjeve me gjendje më të vështirë ekonomike.

5. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Komisioni qeveritar për ndarjen e tokës të riaktivizojnë komisionet e ndarjes së tokave në organet përkatëse të qeverisjes vendore pritëse dhe të parashikojnë në buxhetin e saj vjetor fondet e nevojshme për funksionimin e komisioneve të ndarjes së tokës. Pranë këtyre komisioneve në organet e qeverisjes vendore pritëse, të caktohet një përfaqësues i organit të pushtetit vendor nisës dhe një përfaqësues i shoqatës së tokave të përmbytura.

6. Ministria e Punëve Publike, në bashkëpunim me seksionet e urbanistikës së organeve pritëse të pushtetit vendor, të hartojë studimet urbanistike të vendimeve të reja, dhe, duke filluar nga viti 2001, të parashikojë në buxhetin vjetor fondet që nevojiten për ndërtimin e infrastrukturës në këto vendbanime, si dhe fondin e nevojshëm për kreditimin e ndërtimit të shtëpive, nëprëmet Entit Kombëtar të Banesave.

7. Ministria e Punëve Publike të parashikojë në buxhetin e saj vjetor fondet e nevojshme për përmirësimin e infrastrukturës në vendbanimet e reja ku janë sistemuar familjet që kanë lëvizur deri më sot, në zbatim të vendimit nr.306, datë 30.6.1994, të Këshillit të Ministrave. Për vitin në vazhdim, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, t’i shtohet kësaj ministrie një fond prej 2 361 mijë lekësh, në zërin “Studim e projektim”, për hartimin e projekteve për furnizimin me ujë të pijshëm dhe ndërtimin e kanaleve të ujërave të zeza (sipas pasqyrës bashkëlidhur) për vendbanimet ku janë sistemuar familjet që kanë lëvizur deri më sot.

8. Ministria e Pushtetit Lokal të parashikojë në buxhetin e saj vjetor fondet e nevojshme për ndërtimin apo përmirësimin e rrugëve lidhëse rurale të vendbanimeve, ku janë sistemuar familjet që

kanë lëvizur deri më sot, në zbatim të vendimit nr.306, datë 30.6.1994, të Këshillit të Ministrave, si dhe, duke filluar nga viti 2001, të parashikojë fondet në buxhet për vendbanimet e tjera, ku do të sistemohen familjet e parashikuara për të lëvizur.

9. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, brenda kuadrit ligjor, të trajtojë me përparësi familjet me banim në këto zona, që kanë më shumë nevojë ekonomike.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Punëve Publike, Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, organet e qeverisjes vendore dhe prefekturat përkatëse të rretheve nisëse dhe pritëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Tabela e fondeve të nevojshme për zërin "Studim – Projektim" për vendbanimet e familjeve të strehuara deri sot

Nr	Rrethi	Nr. i familjeve	Nr.i frymëve	Fonde Studim-Projektim 000/lekë		
				Furnizim me ujë	KUZ	Total
1.	Rrethi i Durrësit	400	1733	540	330	870
2.	Rrethi i Kurbinit	61	377	165	75	240
3.	Rrethi i Tiranës	90	468	270	180	450
4.	Rrethi i Tiranës	26	130	30	30	60
5.	Rrethi i Lezhës	83	435	210	81	291
6.	Rrethi i Lushnjës	70	478	240	120	360
7.	Rrethi i Durrësit	22	138	60	30	90
	Shuma	**752**	**3759**	**1515**	**846**	**2361**

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi, Anëtar i""
Zija Vuci, Anëtar i""
Alfred Karamuço, Anëtar i""
Kristofor Peçi, Anëtar i""
Bardha Selenica, Anëtar i""
Kujtim Puto, Anëtar i""
Sokol Sadushi, Anëtar i""

Hajredin Fuga, Anëtar i“““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 26.06.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.42, Akti që i përket:

KËRKUES: ZYDI ELEZI, i përfaqësuar nga avokati Sokol Agolli, me prokurë.

O B J E K T I:

Shfuqizimin e vendimit nr.239, datë 23.06.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të sipërcituar të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

- Është shkelur neni 414 i Kodit të Procedurës Penale sepse akti i rekursit të prokurorit të Apelit nuk i është komunikuar të pandehurit apo avokatit të tij, gjë që del qartë nga aktet e dosjes.

Mosrespektimi i këtij detyrimi, ka sjellë si pasojë që i pandehuri të mos ushtrojë të drejtën për t'u dëgjuar para kolegjit penal, duke u shkelur neni 33 pika 1 e Kushtetutës.

Shkelja e të drejtës kushtetuese për t'u dëgjuar e bën procesin ligjor jo të rregullt, në kuptim të nenit 42 pika 1 e Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuesit, që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Kërkuesi Zyhdi Elezi, me vendimin nr.1, datë 05.01.1999 të gjykatës së rrethit Kavajë, është dënuar me 13 muaj burgim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 290/1 dhe 273 të Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Durrës, mbi ankimin e të pandehurit të ushtruar nëpërmjet mbrojtësit të emëruar nga të afërmit e tij, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit, konform nenit 59 të Kodit Penal për një kohë prej dy vjetësh.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, ka ushtruar rekurs prokurori pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe kolegji penal i Gjykatës së Lartë, pa prezencën e mbrojtësit të të pandehurit, me vendimin nr.239, datë 23.09.1999 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës me ndryshimin që revokohet pezullimi i ekzekutimit të këtij vendimi.

Nga materialet e dosjes rezulton se nuk ka asnjë dokument apo veprim që të vërtetojë se të pandehurit apo mbrojtësit të tij, t'i jetë komunikuar rekursi i ushtruar nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Në këtë mënyrë, është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 414 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin shprehet "Akti i ankimit u njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin". Duke mos u përmbushur ky detyrim ligjor, të pandehurit nuk i është dhënë mundësia që të dijë se çështja e tij do të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë dhe njëkohësisht të dëgjohet e të mbrohet, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, rreth parashtrimeve të bëra nga prokurori në rekursin e tij. Mohimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, përbën shkelje me karakter kushtetues, të cilat e bëjnë procesin ligjor jo të rregullt, në kuptim të nenit 42 pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 germa "f" dhe 134 të Kushetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.239, datë 23.06.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po kësaj Gjykate.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 18.07.2000
Nr.42 i Regj.Themeltar
Nr.44 i Vendimit

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i""
Zija Vuci,	Anëtar i""
Alfred Karamuço,	Anëtar i""
Kristofor Peçi,	Anëtar i""
Kujtim Puto,	Anëtar i""
Sokol Sadushi,	Anëtar i""
Hajredin Fuga,	Anëtar i""

me sekretare Arbenka Lalica, më datat 29.05.2000 dhe 05.06.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.43 Akti që i përket:

KËRKUESE: BASHKIA E TIRANËS, e përfaqësuar nga juristja Dhurata Çupi, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë.
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.
3. MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, e përfaqësuar nga Irena Dule dhe Ervin Treza, me autorizim.

O B J E K T I

Shfuqizimi i nenit 9 të ligjit nr.8578, datë 10.02.2000 "Për Teatrin".

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e nenit 49 të ligjit "Për Teatrin.".

Shkelet pavarësia dhe autonomia e pushtetit vendor të sanksionuar në nenet 13,113 e vijues të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Shkelen dispozitat e ligjit nr.7572, datë 10.06.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal", nenet 1,3,14 etj.

Godina e Teatrit të Kukullave ka qenë dhe është në varësi të pushtetit vendor, që është administruar dhe mirëmbajtur nga Bashkia.

Gjatë gjykimit, pala kërkuese shtoi se Teatri i Kukullave është administruar nga Bashkia e Tiranës, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.350, datë 10.08.1992 "Për mënyrën e klasifikimit të ndërmarrjeve shtetërore në kombëtare dhe lokale", si dhe Udhëzimit përkatës të Këshillit të Ministrave nr.6. të vitit 1992, akte këto që nuk janë shfuqizuar dhe se neni 49 është shtuar në ligj në mënyrë arbitrare dhe pa u marrë mendimi i Bashkisë së Tiranës dhe komunitetit artistik.

pasi dëgjoi përfaqësuesen e palës kërkuese që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që u shpreh për rrëzimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Shkaqet e parashtruara nga pala kërkuese për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 49 të ligjit nr.8578, datë 10.02.2000 "Për Teatrin", nuk qëndrojnë dhe për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

Teatri i Kukullave Tiranë, sikundër pranohet edhe nga vetë pala kërkuese, është pronë publike që është lënë në administrimin dhe varësinë e Bashkisë së Tiranës. Në bazë të nenit 49 të ligjit "Për Teatrin", godina dhe infrastruktura e Teatrit të Kukullave shndërrohet në Qendrën Kombëtare për Fëmijë, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ky veprim i kryer me akt të organit kompetent shtetëror, që kalon një objekt nga administrimi i pushtetit vendor në administrim të një organi qendror, nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, sepse nuk ka cënuar autonominë vendore, në kuptim të nenit 13 të Kushtetutës dhe të Kartës së Autonomisë Vendore. Sipas nenit 3 të Kartës së Autonomisë Vendore, në të cilën përkufizohet koncepti i autonomisë vendore, bashkësitë vendore ushtrojnë të drejtat për të rregulluar dhe për të drejtuar brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsisë së tyre një pjesë të mirë të çështjeve publike. Në rastin konkret, kalimi i të drejtës së administrimit nga pushteti vendor në atë qendror është bërë me ligj dhe në të mirë të përgjithshme, pra të ndryshimit të funksionit të këtij institucioni, siç tregohet në nenin 48 të ligjit "Për Teatrin", që Teatri i Kukullave shndërrohet në Kompaninë Teatrore Shtetërore Qendrore e Teatrit Kombëtar për Fëmijë. Edhe në vështrim të nenit 4 pikat 1 e 4 të Kartës së Autonomisë Vendore, kompetencat e bashkësive vendore caktohen nga Kushtetuta dhe ligji e mund të kufizohen vetëm brenda ligjit, ashtu sikurse është vepruar edhe në rastin konkret.

Duke u parë problemi në këtë këndvështrim, nuk ndodhemi para shkeljes së parimit të autonomisë vendore, siç pretendohet nga pala kërkuese dhe për rrjedhojë nuk ka shkelje të karakterit kushtetues. Përsa i përket kërkesës për papajtueshmëri të nenit 49 të ligjit "Për Teatrin" me ligjin nr.7572, datë 10.06.1992 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.350, datë 10.08.1992, ajo nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 134 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë si dhe nenin 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 24.07.2000
Nr.34 i Regj. Themeltar.
Nr.45 i Vendimit.

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi, Anëtar i ““
Zija Vuci, Anëtar i““
Hajredin Fuga, Anëtar i““
Alfred Karamuço, Anëtar i““
Bardha Selenica, Anëtar i ““
Kujtim Puto, Anëtar i ““
Sokol Sadushi, Anëtar i ““
Kristofor Peçi, Anëtar i““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 03.07.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.45, Akti që i përket:

KËRKUES: ZEF BRUNGA, i përfaqësuar nga Dino Leli, me prokurë.

O B J E K T I

Shfuqizimin si antikushtetues i vendimit nr.338, datë 12.10.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit:

Gjykata e Lartë shprehet në vendim se rekursi i paraqitur nga i pandehuri nuk është nënshkruar nga mbrojtësi siç parashikohet në nenin 435/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Ky arsyetim është alogjik dhe jo i vërtetë sepse rekursin e ka nënshkruar avokati Pjetër Brozi, i autorizuar nga ana ime me prokurë të posaçme.

Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë më ka hequr padrejtësisht të drejtën e ankimit të garantuar me Kushtetutë.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuesit që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Shkaqet e paraqitura nga kërkuesi, ndonëse qëndrojnë nuk janë të atilla që të passjellin shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë. Është e vërtetë se ky kolegj ka gabuar kur arsyeton në vendim se rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi. Por ky nuk është i vetmi arsyetim i vendimit dhe nuk është ai që ka determinuar në mospranimin e rekursit. Ky mospranim, sipas arsyetimit të gjykatës, është bërë për faktin se rekursi i paraqitur përmban shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale. Mosnënshkrimi i rekursit nga avokati është një nga shkaqet për të cilat gjykata ka vendosur mospranimin, por ai nuk është i vetmi dhe përderisa nuk janë parashtruar shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i gjykatës nuk mund të preket për këtë shkak.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 134 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 28.07.2000
Nr.45 i Regj.Themeltar
Nr.46 i Vendimit

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.338, datë 12.10.1999 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, duhet të ishte pranuar për këto shkaqe:

Në kundërshtim nga se arsyetohet në vendimin e shumicës, mospranimi i rekursit është bërë për shkak se, sipas kolegjit penal, ai nuk ishte nënshkruar nga mbrojtësi, pra ishin shkelur kërkesat e nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale. Ky është i vetmi shkak i mospranimit dhe jo se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale. Po të ishte për këtë të fundit, gjykata nuk kishte pse të përmendte shprehimisht se rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi dhe t'i referohej nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, në pjesën hyrëse të vendimit thuhet se Zef Brunga parashtron si shkak për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit mosfirmosjen e rekursit nga avokati sipas nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale. Paraqitja si më sipër nuk i përgjigjet realitetit, sepse rekursi i ndodhur në dosje përmban shkaqe të tjera dhe aspak mungesën e nënshkrimit, të cilën edhe po të ishte e vërtetë, i gjykuari nuk kishte arsye ta reklamonte. Në këto rrethana, vendimi është kontradiktor dhe alogjik sepse gjykata pa të drejtë i atribuon rekursit ato shkaqe, të cilat i përmend si argument në vendimin e saj, për më tepër kur ato nuk janë të vërteta.

Nga ana tjetër, gjykata e bazon vendimin në nenet 435/2 dhe 420 të Kodit të Procedurës Penale dhe jo në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon mospranimin e rekursit kur bëhet për këto të ndryshime nga ato që lejon ligji. Duke mos zbatuar këtë nen, por nenin 435/2, gjykata ka patur bindjen se nuk janë shkaqet e ndryshme, por mungesa sipas saj e nënshkrimit të mbrojtësit në rekurs.

Por, meqenëse ky shkak nuk është i vërtetë sepse rekursi është nënshkruar rregullisht nga mbrojtësi i pajisur me prokurë, gjykata pa të drejtë ka vendosur mospranimin e rekursit.

Në këtë mënyrë, është shkelur e drejta e mbrojtjes në procesin penal që është një e drejtë kushtetuese. Prandaj, vendimi i kolegjit penal të Gjykatës së Lartë, duhej të ishte shfuqizuar si antikushtetues për t'i dhënë mundësi të pandehurit të realizojë të drejtën e tij nëpërmjet një procesi të rregullt në të gjitha shkallët e gjykimit.

ANËTAR
K.Peçi

ANËTAR
B.Selenica

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Zija Vuci,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Bardha Selenica	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Kujtim Puto,	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Sabri Rrapi,	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 05.07.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me

dyer të hapura çështjen nr.46, Akti që i përket:

KËRKUESE: SHOQATA E KRYETARËVE TË BASHKIVE, e përfaqësuar nga Natasha Kondi dhe Ermela Mallkuçi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga z.Gjon Ndreu dhe Malo Hizdri.

O B J E K T I

Shfuqizimi i pikave 2.2/4, 2.2/5 dhe 2.3/6 të V.K.M., nr.217, datë 05.05.2000 "Për kontrollin financiar".

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e pikave 2.2/4,2.2/5 dhe 2.3/6 të VKM, nr.217, datë 05.05.2000 "Për kontrollin financiar".

Shkelet pavarësia dhe autonomia e Pushtetit Vendor të sanksionuara në nenin 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.8548, datë 11.11.1999.

Ushtrimi i këtij kontrolli mund të bëhet vetëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga Ministria e financave dhe nga Prefekturat dhe vetëm, në fusha e për probleme të caktuara.

Ky kontroll i parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave bie në kundërshtim me pikën 1 të po këtij vendimi ku thuhet, se kontrolli financiar është një funksion brenda subjektit për të vlerësuar veprimtarinë e tij.

Në pikën 2.3/6 të këtij vendimi, parashikohen kompetenca tepër të zgjeruara të organeve të kontrollit si dhe një ndërhyrje në organet, që gëzojnë të drejtën për shqyrtimin dhe vlerësimin e këtyre veprimeve.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësueset e palës kërkuese që u shprehën për pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Shkaqet e parashtruara nga pala kërkuese për shfuqizimin si antikushtetues të pikave 2.2/4, 2.2/5 dhe 2.3/6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.217, datë 05.05.2000 "Për kontrollin financiar", nuk qëndrojnë për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

Vendimi i Këshillit të Ministrave, si akt normativ, ka përcaktuar rregullat, për kontrollin financiar në njësitë e Qeverisjes Vendore. Asnjë nga këto pika nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore. Ato nuk kanë cënuar autonominë vendore në kuptim të nenit 13 të Kushtetutës dhe të Kartës së Autonomisë Vendore. Neni 8 i Konventës parashikon kontroll administrativ të bashkësive vendore. Sipas nenit 3 të Kartës së Autonomisë Vendore, autonomia vendore konceptohet si e drejtë dhe aftësi efektive e bashkësive vendore për të rregulluar e për të drejtuar nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsive të tyre një pjesë të mirë të çështjeve publike. Kusht themelor është, që kjo veprimtari të ushtrohet sipas ligjit dhe brenda kufijve që parashikon ligji. Edhe në ligjin nr.8399, datë 09.09.1998 "Për buxhetin Lokal" dhe në Vendimin mr.217, datë 05.05.2000 "Për kontrollin financiar" nuk parashikohet ndonjë normë që vlerëson oportunitetin e vendimeve të marra nga organet e pushtetit vendor, por përcaktohen organet e rregullat për kontrollin e zbatimit të ligjeve për buxhetin me qëllim, që të mbrojë vetë subjektet nga dëmtimet e humbjet financiare. Në rastin konkret, në nenin 12 të ligjit për "Buxhetin Lokal" është ngarkuar Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit që të kryejnë në organet e pushtetit lokal kontrollin për zbatimin e buxhetit si një nga llojet e kontrollit administrativ. Në nenin 20, është ngarkuar Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal të nxjerrin akte nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Në bazë të nenit 178/1 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky ligj është në fuqi dhe do të zbatohet

derisa nuk është shfuqizuar, prandaj në bazë të tij, Qeveria ka marrë masa duke riorganizuar strukturat përkatëse të kontrollit financiar. Në pikat 2.2/4 të vendimit nr.217, datë 05.05.2000 "Për kontrollin financiar", theksohet, se Ministria e Pushtetit Lokal, me anë të strukturës së saj të kontrollit, për probleme të veçanta, me urdhër të ministrit përkatës, mund të ushtrojë kontroll edhe të drejtpërdrejtë në njësitë e Qeverisjes Vendore, duke respektuar pavarësinë e tyre. Këtu është fjala vetëm për kontrollin financiar, gjë, që del qartë nga përmbajtja e gjithë vendimit. Për më tepër sipas pikës 2.2/4 të këtij vendimi, kontrolli financiar i Ministrisë së Pushtetit Lokal kufizohet vetëm në atë pjesë të buxhetit të shtetit që i është transferuar pushtetit lokal nga pushteti qendror dhe vetëm për probleme të veçanta. Është përjashtuar në këtë vendim e drejta e organeve të kontrollit të hyjnë në kontrollin e pjesës së buxhetit të pavarur dhe në vendimmarrjen e pushtetit vendor, çka del qartë nga togfjalëshi i fundit i pikës së lartpërmendur.

E papranueshme është kërkesa e shoqatës së kryetarëve të bashkive edhe për pikën 2.2/5 të VKM., nr.217, datë 05.05.2000. Në këtë pikë, parashikohet kontrolli financiar i drejtorive të kontrollit në prefektura, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore dhe nuk shkelet parimi kushtetues i autonomisë vendore, pasi kjo e drejtë e tyre buron nga ligji "Për Prefekturat", nga ligji "Për buxhetin Lokal" nr.8399, datë 09.09.1998, neni 12/1 i tij si dhe nga ligji 8379, datë 20.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Republikës së Shqipërisë". Vihet në dukje, se kontrolli nga prefektura do të ushtrohet në rastet dhe sipas kritereve ligjore që i përmendën më lart, pra, vetëm për anën finanicare pa përfshirë anë të tjera të veprimtarisë së subjektit vendor dhe vetëm, për fondet e transferuara nga pushteti qendror në pushtetin lokal.

Nuk merret parasysh nga Gjykata Kushtetuese as kërkesa për shfuqizimin e pikës 2.3/6 e vendimit të Qeverisë që parashikon të drejtat e organeve të kontrollit të marrin vendime për ndalimin e përkohshëm të veprimeve, që bien ndesh me ligjet e shtetit ose cënojnë interesat ekonomike të tij deri në shqyrtimin përfundimtar nga organet përktëse që i kanë në përgjegjësi. Të drejtën për ta marrë këtë vendim e kanë drejtuesit e strukturës së kontrollit, sipas paragrafit të dytë të pikës 2.3/6 të vendimit të K.M. Kjo pikë e vendimit nuk shkel autonominë e pushtetit vendor, veçse, shmang pasojat që vijnë nga zbatimi i veprimeve të kundërligjshme. Pra, organet e kontrollit, nuk marrin vendime përfundimtare, veçse ndërpresin për një periudhë kohe, ato veprime që vijnë në kundërshtim me ligjet dhe që dëmtojnë interesat shtetërore.

Fusha e zbatimit të këtyre vendimeve të përkohshme, siç u përmend më lart, është e kufizuar dhe përfshin vetëm veprimtarinë administrative, duke ruajtur të paprekur veprimtarinë e organeve vendimmarrëse të pushtetit vendor.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese konkludon, se vendimi nr.217, datë 05.05.2000 i Këshillit të Ministrave në pikat 2.2.4, 2.2.5 dhe 2.3/6 nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore. Nuk ndodhemi para shkeljes së parimit të Autonomisë Vendore dhe nuk ka asnjë shkelje të karakterit kushtetues.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenin 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 28.07.2000
Nr.46 i Regj.Themeltar
Nr. 47 i Vendimit

ARSYETIM PARALEL

Jam për rrëzimin e kërkesës, por jo për themelin e saj, ashtu siç arsyeton shumica, po për mungesë legjitimimi të subjektit që ka drejtuar kërkesën.

Ky arsyetim ka të bëjë tërësisht me interpretimin e kuptimin e nenit 134 të Kushtetutës.

Në bazë të kësaj dispozite, janë një rradhë subjektesh, duke përfshirë edhe organet e Qeverisjes Vendore, të cilët mund të bëjnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese "vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre".

Problemi shtrohet nëse kushti "interes" do të kuptohet e zbatohet vetëm në kuptim literal apo edhe me gjerë, duke qenë përcaktues edhe në natyrën e gjykimit kushtetues (abstrakt ose konkret).

Në radhë të parë "interesi" kushtëzon subjektet përkatëse për të drejtuar kërkesë kur kjo lidhet me realizimin e detyrimeve e të drejtave të tyre që rrjedhin drejtpërdrejt nga Kushtetuta apo ligjet. Por për mendimin tim, dhe kjo është e rëndësishme për çështjen në shqyrtim, interesi nuk prezumohet e as diktohet me anë leximi apo shqyrtimi të ligjit apo aktit të kontestuar, por gjatë zbatimit konkret, sepse ligji dhe akti zbatohen dhe më mirë se kudo kushtetushmëria e ligjshmëria e tyre konstatohen gjatë zbatimit praktik.

Prej këtej rrjedh konkluzioni, se "interesi" i subjekteve përkatëse duhet të rrjedhë (të ketë lindur) nga zbatimi praktik, pra të ketë të bëjë me një çështje konkrete.

Në këto kushte, i qëndroj mendimit se organet e qeverisjes vendore e vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje konkrete që lidhen me interesat e tyre, e si të tilla ato i nënshtrohen shqyrtimit konkret.

Ndryshe ndodh me kërkesat e subjekteve të tjera, të parashikuar nga neni 134 (germa a deri d) të cilat i nënshtrohen edhe shqyrtimit abstrakt sepse nuk janë të kushtëzuara nga vetë teksti i Kushtetutës.

Kërkesën, Shoqata e Kryetarëve të Bashkive nuk e ka mbështetur tek probleme konkrete të lindura gjatë zbatimit të aktit në praktikë por thjesh nga shqyrtimi i tij, duke kërkuar në këtë rast një gjykim abstrakt të aktit – kërkesë për të cilën nuk legjitimohet.

ANËTAR
A. Karamuço

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa duhet të ishte pranuar sepse vendimi i Këshillit të Ministrave nr.217, datë 05.05.2000 është antikushtetues për këto arsye:

1. Sipas nenit 118/1 të Kushtetutës, aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve, ndërsa paragrafi i dytë i po këtij neni përcakton se ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

Në hyrje të vendimit të Këshilllit të Ministrave nr.217, thuhet se ai del në mbështetje të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të shtetit" por ky ligj (si dhe ndryshimet e tij të nënshkruara) në asnjë dispozitë nuk përmend se autorizon Këshillin e Ministrave për të nxjerrë akte nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave edhe në përmbajtjen e tij është antikushtetues. Kështu, pikat 2.2/4, 2.2/5 dhe 2.3/6 të tij që autorizojnë organet e kontrollit financiar në ministri dhe në prefektura që të ushtrojnë në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, shkelin parimin kushtetues të decentralizimit dhe autonomisë vendore të parashikuar në nenin 13 të Kushtetutës. Gjithashtu në nenin 8 të Kartës së Autonomisë Lokale përcaktohet se çdo kontroll në njësitë e qeverisjes vendore duhet të jetë në format dhe rastet e parashikuara nga Kushtetuta dhe nga ligji. Duke u caktuar format dhe rastet e kontrollit me vendim të Këshillit të Ministrave është shkelur edhe ky nen i Kartës së Autonomisë Lokale.

Për këto arsye Gjykata Kushtetuese, e cila garanton respektimin e kushtetutës duhej ta shfuqizonte vendimin e Këshillit të Ministrave nr.217, datë 05.05.2000 si antikushtetues.

ANËTAR
K.Peçi

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa e Shoqatës së Kryetarëve të Bashkive duhej pranuar dhe për rrjedhojë pikat 2.2.4 dhe 2.2.5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.217. datë 05.05.2000 "Për Kontrollin Financiar", duhej të shfuqizoheshin si antikushtetues.

Vendimi i KM vendos norma të reja juridike në fushën e kontrollit financiar duke krijuar edhe struktura të tilla në Ministrinë e Financave, në Ministrinë e Pushtetit Lokal e në prefektura, të cilave u jepet e drejta të ushtrojnë kontroll administrativ mbi njësitë e qeverisjes vendore. Në pikën 2.2.4 të V.K.M, thuhet "…Për probleme të veçanta, me urdhër të ministrit përkatës, ajo mund të ushtrojë kontroll edhe të drejtpërdrejtë në njësitë e qeverisjes vendore, duke respektuar pavarësinë e tyre".

Kjo dispozitë nënligjore shkel në mënyrë të drejtpërdrejtë parimin kushtetues të decentralizimit dhe të autonomisë së pushtetit vendor, parashikuar nga neni 13 i Kushtetutës së RSH. Sipas nenit 8, pika 1 të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, "çdo kontroll administrativ mbi bashkësitë vendore mund të ushtrohet vetëm sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose nga ligji". Kjo dispozitë e Kartës përbën një detyrim për të gjitha shtetet, të cilat, janë angazhuar të zbatojnë rregullat e parashikuara, të cilat me ratifikimin janë bërë të detyrueshme.

Vendimi i K.M, objekt shqyrtimi në këtë çështje ka parashikuar format dhe rastet e ushtrimit të kontrollit administrativ mbi bashkësitë vendore, në një kohë që as Kushtetuta dhe as ligji nuk kanë përcaktuar një gjë të tillë. Pikërisht rregullat e vendosura në pikën 2.2.4 dhe 2.2.5, sipas të cilave organet e pushtetit qendror kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll edhe të drejtpërdrejtë në njësitë e qeverisjes vendore, përbëjnë një tejkalim të normave të detyrueshme ndërkombëtare të sanksionuara në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore dhe shkelje të parimit të decentralizimit.

Pretendimi që ka përdorur shumica në vendimin e saj për të argumentuar rrëzimin e kërkesës, sipas të cilit në V.K.M, nuk është shkelur Kushtetuta e RSH dhe neni 8 i Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, sepse neni 12 i Ligjit "Për Buxhetin Lokal ka ngarkuar Ministrinë e Financave dhe të Pushtetit Lokal të kryejnë kontrollin administrativ mbi pushtetin vendor, nuk është i drejtë.

Ligji "Për Buxhetin Lokal" në nenin 12 të tij ka parashikuar të drejtën e ushtrimit të kontrollit të buxhetit lokal nga organet e caktuara me ligj, por pikërisht kjo dispozitë e sipërcituar nuk ka përcaktuar as format dhe as rastet se si, kur dhe ku, duhet ushtruar ky kontroll. Format dhe rastet e ushtrimit të kontrollit administrativ financiar në kundërshtim me nenin 8 të Kartës Evropiane i ka parashikuar Vendimi i K.M. "Për Kontrollin Financiar". Këtu qëndron antikushtetutshmëria e këtij vendimi.

Parimi i decentralizimit të pushtetit vendor dhe në tërësi kuptimi i vetë Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore nuk duhet kuptuar sikur janë kundër ekzistencës dhe ushtrimit të kontrollit administrativ mbi qeverisjen vendore, por që ky kontroll administrativ duhet të jetë konform rregullave që parashikojnë aktet e mësipërme duhet që format dhe rastet e tij t'i ketë parashikuar Kushtetuta ose ligji.

Megjithëse kërkesa e Shoqatës së Kreytarëve të Bashkive ishte e përqëndruar vetëm në shfuqizimin e tre pikave të këtij vendimi, mendimi im për shfuqizimin e këtyre dispozitave nënligjore si antikushtetuese e bën pothuajse të pakuptimtë ekzistencën e mëtejshme të vendimit. Prandaj Vendimi i K.M., duhej vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese në tërësinë e tij, duke ju referuar nenit 48 të Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" sipas të cilit, çështja mund të shqyrtohet edhe tej objektit dhe shkaqeve të paraqitura nga kërkuesi.

Në këtë aspekt i gjithë Vendimi i K.M., është antikushtetues, jo vetëm nga argumentimi i mësipërm, por edhe nga fakti se është shkelur neni 118 i Kushtetutës së RSH. Kjo dispozitë kushtetuese nuk lejon organin përkatës të administratës shtetërore që të nxjerrë një akt nënligjor, nëse ligji nuk ka autorizuar nxjerrjen e aktit, organin kompetent, çështjen që do të rregullojë akti dhe parimet në bazë të të cilit ai do të nxirret. Këto detyrime kushtetuese në nxjerrjen e vendimit të mësipërm nuk janë respektuar nga ana e Këshillit të Ministrave. Në pjesën hyrëse të këtij vendimi, Këshilli i Ministrave i është referuar Ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndërkohë që ky ligj nuk autorizon KM në ndonjë dispozitë konkrete për të nxjerrë një akt të

tillë nënligjor që të rregullojë marrëdhëniet në fushën e kontrollit financiar. Mjafton dhe ky argument që në tërësi Vendimi i K.M., nr.217, datë 05.05.2000 "Për Kontrollin Financiar" të konsiderohet në kundërshtim me Kushtetutën.

Anëtar
S. Sadushi

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i ""
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Hajredin Fuga,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Sokol Sadushi,	Anëtar i ""
Kujtim Puto,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço,	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 05.07.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.47 Akti që i përket:

KËRKUES: Avokat Sokol Paruca, me cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të Arben Lukës.

OBJEKTI:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.480, datë 22.12.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi, si në kërkesë ashtu edhe në seancë gjyqësore, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të mësipërm:

1. Është caktuar si mbrojtës i të dënuarit Arben Luka, me prokurë të lëshuar para noterit nga prindërit e të sipërpërmendurit. Megjithatë, Kolegji Penal këtë përfaqësim e konsideron të paligjshëm e për rrjedhim mbrojtësit të palegjitimuar.

2. Prokurori në gjykimin e faktit ka pushuar një akuzë ndaj të pandehurit Arben Luka, si dhe ka ngritur ndaj tij dy akuza të reja. Edhe pse i pandehuri ka kërkuar kthimin e çështjes për hetim, gjykata nuk ka pranuar duke shkelur kërkesat e nenit 374 të K.Pr.Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit, administroi provat dhe shqyrtoi çështjen në tërësi, vëren:

Me vendimin nr.606, datë 01.07.1998, Gjykata e Tiranës ka dënuar Arben Lukën, Ardian Freskina e Arjan Zoga, respektivisht me 20, 11 dhe 12 vjet burg, për akuzë vjedhje me përdorim, arme në bashkëpunim (nenet 140 e 25 të Kodit Penal).

Këtë vendim ka lënë në fuqi edhe Gjykata e Apelit në Tiranë, me vendimin e saj nr.331, datë 1 15.10.1998.

Meqenëse të pandehurit gjykoheshin në mungesë, Gjykata e Rrethit pasi ka deklaruar këtë fakt, ka vendosur t'u caktojë mbrojtës atyre. Në këto kushte, në Gjykatën e Lartë kanë bërë rekurs avokat Fatos Shanaj, caktuar nga Gjykata e Rrethit si mbrojtës i të pandehurit Ardian Freskina ndërsa avokat Sokol Paruca, ka qenë i ngarkuar si mbrojtës i Arben Lukës me prokurë të posaçme nga babai i të pandehurit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.480, datë 22.12.1999 ka vendosur mospranimin e ankimit (rekursit) të mbrojtësve të të gjykuarve pasi ata nuk legjitimohen.

Në arsyetimin e vendimit gjykata pranon se nuk rezulton që mbrojtësit të jenë pajisur me akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji, kërkesë kjo e domosdoshme e parashikuar nga pika 2 e nenit 410 të K.P.Penale.

Duke rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur në vendimin nr.17 datë 07.04.2000, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se vendimi nr.480, datë 22.12.1999 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është antikushtetues dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

Në dosjen gjyqësore ekziston një prokurë e posaçme, e lëshuar para noterit, më datën 20.08.1999 nga babai i Arben Lukës për avokat Sokol Parucën, bazuar në nenet 48 e 410/2 të K.Pr.Penale, e cila përbën akt përfaqësimi të vlefshëm të cilin Gjykata e Lartë ishte e detyruar ta pranonte e të shqyrtonte rekursin. Mospranimi i një akti përfaqësimi, të lëshuar konform ligjit e për pasojë mospranimi i ankimit të mbrojtësit, të caktuar me këtë akt përfaqësimi, e bën procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja kushtetuese duke cënuar të drejtat themelore të mbrojtjes dhe ankimit, parashikuar nga nenet 31 e 43 të Kushtetutës. Njëkohësisht, këto qëndrime vijnë ndesh me sa përcaktohet në nenin 2/2 të Protokolllit Nr.7 të Koventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe të nenit 14/5 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Përsa i përket shkakut tjetër të ngritur nga mbrojtja, ai që lidhet me shkeljen e nenit 374 të K.Pr.Penale, Gjykata Kushtetuese e shpall atë jashtë juridiksionit. Ky shkak nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë dhe për pasojë nuk mund të përbëjë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, në kuptim të shkronjës "f" të nenit 131 të Kushtetutës, i cili është si kusht shqyrtimi përcakton shterimin e të gjitha mjeteve juridike për mbrojtjen e së drejtës,

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 dhe 134 të Kushtetutës dhe të neneve 72, 77 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.480, datë 22.12.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Çështja i dërgohet për shqyrtim Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 28.07.2000
Nr.47 i Regj.Themeltar
Nr.48 i Vendimit

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese që vendosi shfuqizimin e vendimit nr.480, datë 22.12.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për këto arsye:

Sipas nenit 410 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale "kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji". Duke qenë e drejta e ankimit, sipas nenit 50 të Kodit të Procedurës Penale, një e drejtë që i rezervohet personalisht të "pandehurit", askush përfshirë edhe të afërmit të tij, nuk mund të marrin atribute që ligji procedurial nuk ua lejon. Duke mos pasur të shprehur vullnetin e të pandehurit për ankimin e vendimit, Gjykata e Lartë me të drejtë ka vendosur mospranimin e ankimit për mungesë të legjitimitetit të avokatëve të autorizuar nga të afërmit e të pandehurit, sepse në të kundërt shkelet e drejta e ankimit dhe e drejta e mbrojtjes, të drejta kushtetuese, për të cilat disponon vetë i pandehuri.

ANËTARI
H.Fuga

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar “
Zija Vuci,	Anëtar “
Alfred Karamuço,	Anëtar “
Kristofor Peçi,	Anëtar “
Kujtim Puto,	Anëtar “
Sokol Sadushi,	Anëtar “
Hajredin Fuga,	Anëtar “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.7.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen me nr.të Aktit, që i përket :

KËRKUES : AVOKATI I POPULLIT, përfaqësuar ng z . Ermir Dobjani.
SUBJEKTE TË INTERESUARA :
1.KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë
2.KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë

O B J E K T I

Interpretimi i pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe në kërkesën e tij .

Ndër subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese përshihet edhe Avokati i Popullit , por sipas nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, kërkesën mund ta bëjë “vetëm, për çështje që lidhen me interesat e tij”. Përcaktimi nëpërmjet interpretimit, të rrethit të çështjeve që përbëjnë interesa të “Avokatit të Popullit, në këtë moment paraqet rëndësi për funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit. Këto interesa mund të ishin:

Çështjet, që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve apo grup individësh , siç përcaktohet në nenin 60, pika 1 e Kushtetutës dhe Ligji nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Çështjet që lidhen me pavarësinë e tij në ushtrimin e funksionit, që përcaktohen në nenin 60, pika 2 e 63 të Kushtetutës dhe ligjit organik “Për Avokatin e Popullit”.

Çështjet, që kanë të bëjnë me buxhetin, strukturën, organikën, pagat, etj.

Çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e zgjedhjes, imunitetin e pagës, kohëzgjatja në detyrë dhe papjatueshmërinë në këtë funksion, që parashikohen nga nenet 61 e 62 të Kushtetutës dhe nga ligji organik.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi kërkuesin si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Sipas nenit 134 të Kushtetutës, subjektet që mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese ndahen në dy grupe; në subjekte që mund të ushtrojnë kërkesë në mënyrë të pakushtëzuar dhe në subjekte, që mund të ushtrojnë kërkesë të kushtëzuar “vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”. Ky dallim, del nga përmbajtja e pikës 2, të nenit 134 të Kushtetutës dhe në këtë kategori

subjektesh që mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të kushtëzuar, përfshihet edhe Avokati i Popullit. Më konkretisht, në pikën 2 të nenit 134 thuhet: " subjektet e parashikuara në paragrafet dh..... të paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen për interesat e tyre".

Sipas nenit 131 të Kushtetutës dhe të neneve të tjera të saj, në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese përfshihen mjaft çështje për të cilat kjo vendos, por nga fryma e Kushtetutës që gjen zbërthim në ligjin nr. 8577,datë 10.02.2000 " Për organizimin dhe funkionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë "Avokati i Popullit ka të drejtë të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare (neni 49), për pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me kushtetutën (neni 52) dhe për interpretimin e Kushtetutës (neni 71), gjithnjë kur çështja lidhet me interesat e tij.

Në bazë të paragrafit të parë, të nenit 60 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit ka për funksion të tij "të mbrojë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike". Në këtë kuptim, me çështje që lidhen me interesat e Avokatit të Popullit do të jenë pikërisht ato çështje, që lidhen me këtë funksion kushtetues të ngarkuar Avokatit të Popullit, kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, e aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike, këto interesa janë cënuar duke shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve, shkelje këto, të konstatuara në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij.

Kushtetuta, në nenin 60, paragrafi 2 e 3 , në nenin 61 dhe 62 të saj, vendos rregulla të organizimit dhe të funksionimit të institucionit të Avokatit të Popullit . Në kuptim të nenit 134, paragrafi 2 të Kushtetutës, me interesa të Avokatit të Popullit do të konsiderohen edhe rastet e cënimit të këtyre rregullave kushtetuese, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit, pavarësisht, nëse janë vërtetuar ose jo pasojat.

PËR KËTO ARSYE,

Gykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 134, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenet 71, 72 dhe 79 të Ligjit nr. 8577,datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri

V E N D O S I

1.Avokati i Popullit, në kuptim të nenit 134, paragrafi 2 të Kushtetutës mund t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rastet e parashikuara në nenet 49, 52 dhe 71 të ligjit 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë", për çështje që lidhen me funksionin e tij në mbrojtje të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, kur këto janë shkelur nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike e të konstatuara nga Avokati i Popullit, si dhe kur janë cënuar rregullat kushtetuese pë organizimin dhe funskionimin e institucionit të tij.

2. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi nga miratimi i Kushtetutës.

U shpall sot me datë 31.07.2000
Nr.51 i Rregj. Themeltar
Nr. 49 i Vendimit

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Sabri Rrapi, Anëtar i““
Zija Vuçi, Anëtar i ““
Hajredin Fuga, Anëtar i ““
Alfred Karamuço, Anëtar i ““
Kujtim Puto, Anëtar i ““
Sokol Sadushi, Anëtar i ““
Kristofor Peçi, Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica e Noela Ruço, në datat 03.07.2000, 06.07.2000 dhe 18.07.2000 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 46 Akti, që i përket:

KËRKUES : Myfit Zito, përfaqësuar nga Avokat Ylli Golemi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA :

1. Këshilli i Ministrave, në mungesë.
2. Ministria e Pushtetit Lokal, përfaqësuar nga z Malo Hidri, Tomorr Malaj, Blendi Vathi, Osman Losha dhe Ali Zeneli me autorizim.
3. Prefektura Elbasan, përfaqësuar nga z.Artan Spahiu me autorizim.

O B J E K T I

Shfuqizim si antikushtetues i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 260, datë 25.05.2000 “Për lirimin nga funksioni i kryetarit të Komunës Stravaj të rrethit Librazhd”.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit:

- Në motivacion nuk përmendet të jetë shkelur ndonjë dispozitë kushtetuese.
- Nuk përmendet asnjë fakt që të vërtetojë se ku konsistojnë shkeljet e kryera.
- Dërgimi për konfirmim në Prefekturë i akteve të Këshillit të Komunës, është detyrë e sekretarit.
- Lirimi nga detyra si Kryetar Komune është bërë për motive politike.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit, përfaqësuesve të subjekteve të interesuar dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Këshilli i Ministrave, me vendimin e tij nr. 260, datë 25.05.2000, në bazë të neneve 100 dhe 115 të Kushtetutës, ka vendosur shkarkimin e kërkuesit Myfit Zito nga funksioni i Kryetarit të Komunës Stravaj, të rrethit Librazhd. Sipas këtij vendimi, shkarkimi është bërë për shkelje të ligjeve nr. 7572, datë 10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, nr. 7608, datë 22.09.1992 “Për Prefekturat”, nr. 7971, datë 26.07.1995 “Për prokurimin publik”, nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, nr. 6942, datë 24.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare” dhe nr. 2703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Shkeljet e këtyre ligjeve janë konstatuar nga kontrollet e organizuar nga Prefektura Elbasan dhe Ministria e Pushtetit Lokal në Komunën e Stravaj, për të cilat subjektet e interesuara kanë ngarkuar me përgjegjësi kërkuesin.

Gjykata çmon, se në tërësinë e shkeljeve të ligjeve, të konstatuara në këtë komunë, duhet të veçohen ato me karakter të rëndë për të cilat, Këshilli i Ministrave në bazë të nenit 115 të Kushtetutës, ka të drejtë të shkarkojë organin e zgjedhur drejtpërdrejt të qeverisjes vendore.

Nisur nga kërkesat e kësaj dispozite kushtetuese, Gjykata Kushtetuese konfirmon qëndrimin e mbajtur me vendimin nr. 25, datë 04.05.2000, se kuptimi e saktë dhe i drejtë i konceptit shkelje e rëndë e ligjit vlerësohet në tërësi nga disa faktorë, që kanë të bëjnë me rëndësinë e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura nga shkelja e tij, kohëvazhdimin e këtyre pasojave si dhe qëndrimin subjektiv që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer.

Në këtë aspekt, u vërtetua së kërkuesi ka shkelur rëndë kërkesat e nenit 16 të ligjit nr. 7572,

datë 10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” sepse ka caktuar mbledhjen e Këshillit të Komunës në kundërshtim me ligjin. Kështu, më datën 25.04.2000, kërkuesi ka thirrur mbledhjen e Këshillit të Komunës për datën 26.04.2000, duke përcaktuar edhe rendin e ditës prej 7 pikash.

Në pikën e parë ka caktuar zbatimin e vendimit nr.6, datë 24.4 2000 të Këshillit të rrethit për zëvendësimin e tre këshilltarëve në komunën Stravaj, në kundërshtim me kërkesat e nenit 84 të ligjit nr. 7573, datë 16.06.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”. Si caktimi i mbledhjes, ashtu edhe zhvillimi i saj është bërë në kundërshtim me ligjin, pa u siguruar pjesëmarrja e nevojshme e këshilltarëve. Në këtë mbledhje, ndër të tjera u vendos edhe për zëvendësimin e dy këshilltarëve duke qënë të pranishëm 5 këshilltarë nga 11 që janë gjithsej. Thirrja dhe organizimi i mbledhjes së Këshillit të Komunës nga kërkuesi Myfit Zito në kundërshtim me ligjin dhe duke bërë zëvendësimin e dy këshilltarëve pa të drejtë, përbën shkelje të rëndë të ligjit.

Shkelje të rënda të ligjit në veprimtarinë e kërkuesit përbëjnë edhe tre urdhërat për emërimin në detyrë të pagatorit Florian Vreto dhe magazinierëve Ibrahim Vreto e Përparim Leka, përkatësisht të datave 01.11.1998, 24.12.1999 dhe 16.07.1999, të cilët nuk kanë numër akti, nuk janë protokolluar dhe për pasojë nuk janë dërguar për konfirmim në Prefekturë, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 8209, datë 22.04.1997 “Për Prefekturat”

Gjithashtu, nga kërkuesi Myfit Zito nuk janë vulosur katër urdhëra të Këshillit të Komunës, duke sjellë si pasojë pengimin e veprimtarisë së Këshillit për konfirmim të vendimeve në Prefekturë dhe zbatim të tyre, çka përbën shkelje të rëndë të ligjit.

Përsa i përket shkeljeve të tjera të ligjit, të përmendura në relacionin që i bashkëngjitet vendimit të Këshillit të Ministrave dhe konkluzioneve të kontrollit të Prefekturës Elbasan të datave 28.09.1999 dhe 23.02.2000, nga subjektet e interesuar nuk u sollën argumenta për të përligjur përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të kërkuesit. Ndërsa shkeljet e konstatuara në urdhërat e prokurimit nuk janë të asaj natyre, që konsiderohen si shkelje të rënda të ligjit.

Lidhur me pagesën e disa punonjësve dhe të bashkëshortes së kërkuesit, për të cilat ky i fundit kërkoi pezullimin e shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese e çmon të arsyeshme të mos shprehet për to, sepse është bërë kallëzim për ndjekje penale dhe çështja ndodhet për gjykim në gjykatën e rrethit Librazhd.

Veprimet e përmendura më sipër tregojnë qartë, se kërkuesi Myfit Zito me dashje e ka shkelur rëndë ligjin, duke krijuar pasoja të rënda në veprimtarinë e komunës, prandaj vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e tij nga detyra është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 31.07.2000
Nr.44 i Rregj. Themeltar
Nr. 50 i Vendimit

MENDIM I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës. Jam për pezullimin e çështjes, pa u dhënë tani për tani vendimi përfundimtar, për këto arsye:

Shkeljet e ligjit, mbi bazën e të cilave kërkuesi është shkarkuar nga detyra, gjatë shqyrtimit

gjyqësor e njohjen me provat, dolën që ishin në tre grupe kryesore :

a) Shkelje të cilat nuk mund të konsiderohen të "rënda" në kuptimin kushtetues si bëhet fjalë tenderat, administrimi i vulës etj.

b) Shkelje e rëndë, si të tilla, shumica ka përcaktuar thirrjen dhe organizimin e mbledhjes së Këshillit të datës 26.04.2000. Në fakt marrja e vendimeve të rëndësishme me një mbledhje ku mungonin më shumë se gjysma e anëtarëve përbën shkelje të rënda por nuk duhet anashkaluar fakti që mbledhjen e drejtoi Kryetari i Këshillit të Rrethit dhe se vendimet e paligjshme u morrën nga anëtarët e këshillit. Veprimi i vetëm i kërkuesit që edhe ne e konsiderojmë shkelje ka qenë thirrja brenda një dite e mbledhjes së këshillit. Megjithatë ky veprim nuk ka qënë shumë determinant i marrjes së vendimeve të kundërligjshme. Në një arsyetim të tillë nisemi nga faktet që u evidentuan gjatë procesit si dhe nga domosdoshmëria e egzistencës të lidhjes shkakësore midis veprimit dhe pasojave, kusht vendimtar për procedimin disiplinor.

c) Shkelje të rënda por që vërtetimi i tyre mund dhe duhet të bëhet nga organet gjyqësore. Gjat shqyrtimit të kërkesës doli se kërkuesi është denoncuar për ndjekje penale për disa veprime për të cilat së shpejti do të shqyrtohen në gjykatat e zakonshme. Pikërisht, pezullimi i çështjes deri në një vendim përfundimtar nga ana e gjykatave, ka qenë mendim i pakicës. Kjo në kushtet kur ashtu siç u theksua më lart shkeljet e tjera nuk përbënin shkak ligjor per shkarkimin e kërkuesit nga detyra.

ANËTAR
A. Karamuço

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Agron Lama	Anëtar
Bashkim Caka	"
Artan Hoxha	"
Metush Saraçi	"
Natasha Sheshi	"
Nikoleta Kita	"
Petrit Plloçi	"
Vangjel Kosta	"
Valentina Kondili	"
Vladimir Metani	"
Vladimir Bineri	"

Në seancën gjyqësore të datës 21.6.2000 morën në shqyrtim çështjen civile që u përket:

PADITËS: Shoqëria tregtare "Cicek" sh.p.k, Shëngjin, përfaqësuar nga Av.Flutra Guri.
TË PADITUR: 1. Porti Detar Shëngjin në mungesë.
2. Firma private "England" sh.p.k në mungesë.
3. Muhamet Balla, banues në Lezhë në mungesë.
BAZA LIGJORE: Nenet 982 e 1000 të Kodit Civil.

O B J E K T I:

Detyrimin e Portit Detar Shëngjin të paguajë shumën e 2.450.000 lekë, si dhe interesin 5% mbi këtë shumë.

Gjykata e rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin Nr.610, datë 20.10.1995 ka vendosur:

Detyrimin e Portit Detar Shëngjin t'i paguajë Firmës "CICEK" sh.p.k, shumën prej 2.350.000

lekë së bashku me kontratën ligjore të kësaj shume që nga data 4 gusht e deri në datën e ekzekutimit të vendimit.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.287, datë 26.1.1996 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.610, datë 20.10.1995 të gjykatës së rrethit Lezhë dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

Gjykata e rrethit gjyqësor Lezhë, me vendimin nr.539, datë 30.8.1996 ka vendosur:

Detyrimin e firmës "ENGLAND" sh.p.k që t'i paguajë "CICEK" sh.p.k 2.350.000 lekë, mbi këtë shumë interesat bankare deri në ditën e ekzekutimit të detyrimit.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.6278, datë 20.11.1996, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit Lezhë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.1067, datë 19.9.1997 ka vendosur:

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.277, datë 5.3.1998 kanë vendosur:

Mospranimin e kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm në interes të ligjit, për mungesë legjitimimi të tij.

Kundër vendimeve të mësipërme ka ushtruar rekurs në interes të ligjit, në bazë të nenit 473 të K.Pr.Civile firma "ENGLAND"-sh.p.k duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Ka shkelje të rënda procedurale, është ndërtuar keq ndërgjyqësia;

- Është zbatuar keq ligji dhe kërkesat e kontratës së lidhur midis paditësit, firmës "CICEK" sh.p.k dhe palës së paditur, Portit Detar Shëngjin, sepse ne nuk jemi palë në kontratë, nuk kemi marrë përsipër ndonjë detyrim dhe nuk mund të vendosen detyrime ndaj nesh;

- Arsyetimi i vendimit është haptazi alogjik;

- Të dy gjykatat dalin në konkluzione arbritare sepse nuk bazohen në provat e administruara gjatë gjykimit;

Gjithashtu ka ushtruar rekurs edhe "CICEK" sh.p.k, duke parashtruar këto shkaqe:

Vendimet e të tre shkallëve të gjykimit janë haptazi jo logjike dhe në kundërshtim me ligjin.

Ne kemi paditur Portin Detar dhe ai duhet të përgjigjet për përgjegjësi direkte dhe jo personat e tretë, të cilët nuk i njohim dhe nuk i kemi autorizuar të kryejnë veprime në emër e për llogarinë tonë.

Ndërgjyqësia është krijuar drejt në fillim të gjykimit. "ENGLAND" sh.p.k, nuk është thirrur nga ne si e paditur dhe gjykimi është zhvilluara pa prezencën e saj.

Gjykata gabimisht është marrë me mosmarrëveshjet midis "ENGLAND" sh.p.k dhe Muhamet Ballës për të shkarkuar përgjegjësinë civile të palës së paditur, Portit Detar. Pala e paditur pasi të na likujdojë neve si palë e dëmtuar ka të drejtë t'i drejtohet transportuesit Muhamet Balla.

Kolegji seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.13, datë 28.2.2000 ka vendosur:

Kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relatimin e gjyqtarëve Thimjo Kondi e Vladimir Bineri, përfaqësuesin e paditëses, firmës "CICEK" sh.p.k, Av.Flutra Guri, që kërkoi prishjen e vendimeve;

prokurorin Arqile Lole që kërkoi prishjen e vendimeve;

e pasi e biseduan çështjen në tërësi, vendosën që nëpërmjet këtij vendimi të unifikojë praktikën gjyqësore lidhur me problemet e mëposhtme;

1. *A ka të drejtë gjykata që shqyrton çështjen që, në kundërshtim me disponimin e paditësit, të thërrasë si të paditur një person të tretë dhe të vendosë detyrimin e kërkuar nga paditësi prej të padituri të thirrur prej tij ti'a ngarkojë personit të tretë?*

2. *Cilat janë veçantitë dhe dallimet midis mjeteve procedurale që përdor paditësi dhe i padituri në një gjykim civil: padia, prapësimi dhe kundërpadia.*

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi shqyrtuan aktet e çështjes

V Ë R E J N Ë

Nga materialet e çështjes rezulton si më poshtë:

Midis palës paditëse shoqëria tregtare "CICEK" sh.p.k dhe palës së paditur Portit Detar të Shëngjinit më datë 20.6.1994 është lidhur një kontratë sipas së cilës pala paditëse do të dërgonte pranë

palës së paditur sasinë prej 2000 ton miell, nga të cilët 1500 tonë do të tërhiqeshin direkt me mjetet e paditësit, kurse 500 tonë do të magazinoheshin dhe do të mbaheshin në ruajtje për t'u tërhequr më vonë.

Konflikti midis palëve ka lindur për një sasi mielli prej 100 tonë nga sasia prej 500 tonësh të depozituar. Pala paditëse, firma "CICEK" sh.p.k, ka pretenduar se këtë sasi nuk e ka tërhequr, as vetë ajo, as ndonjë subjekt tjetër i autorizuar prej saj, prandaj ka kërkuarme padinë e paraqitur detyrimin e Portit Detar t'i shpërblejë kundërvleftën e mallit prej 2.450.000 lekë, si dhe interesin 5% mbi këtë shumë.

Gjykata e shkallës së parë Lezhë (vendimi nr.610, datë 20.10.1995) duke shqyrtuar konfliktin e palëve brenda kuadrit të kontratës së lidhur midis tyre ka vendosur pranimin e padisë.

Gjykata e Apelit Tiranë (vendimi nr.287, datë 26.1.1996) e ka prishur vendimin e shkallës së parë me arsyetimin se vendimin i saj bazohej në dokumente të fotokopjuara (jo origjinale dhe të pa vërtetuara që janë të njëjta me origjinalet), dhe se nuk është përcaktuar konkretisht shuma e interesit që i detyrohet i padituri. Gjykata e Apelit, i ka lënë detyrë shkallës së parë që të caktojë një grup ekspertësh për të kontrolluar dokumentacionin e palëve. *(Kjo detyrë është e pazbatueshme për shkallën e parë në rigjykim sepse verifikimi i vërtetësisë së dokumenteve, i pranueshmërisë dhe i vlefshmërisë së tyre si prova është detyrë eksluzive e gjykatës dhe jo ekspertëve. Misioni i ekspertëve përcaktohet qartë në nenin 80 të K.Pr.Civile, ndërsa neni 81/3 i K.Pr.Civile përcaktohet se"Nuk është në misionin e ekspertit të japë një mendim juridik").*

Gjithsesi, sa më lart përmendet vetëm për efekt udhëzimi që gjykatat të mos përsërisin gabime të tilla në të ardhmen, ndërsa përsa i përket vendimit në fjalë të gjykatës së Apelit që ka kthyer çështjen për rigjykim, bazueshmëria e tij nuk është objekt shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara.

Gjykata e shkallës së parë gjatë rigjykimit të çështjes e ka filluar çdo gjë nga e para dhe i ka shtrirë kufijtë e gjykimit tej kuadrit të konfliktit midis palëve të çështjes. Pala e paditur e gjykimit të filluar, Porti Detar Shëngjin, në rigjykimin e çështjes ka paraqitur një kërkesë me shkrim që e ka quajtur "kundër-padi", të cilën gjykata e ka pranuar për gjykim si të tillë duke pranuar Portin Detar Shëngjin si kundërpaditës, si dhe ka thirrur si të paditur firmën private "ENGLAND" sh.p.k, e shtetasin Muhamet Balla.

Në përfundim të gjykimit, të dy gjykatat, shkalla e parë dhe Apeli, kanë pranuar zgjidhen e çështjes në këtë mënyrë: *Detyrimin e firmës private "ENGLAND" sh.p.k, t'i paguajë firmës private "CICEK" sh.p.k, shumën prej 2.350.000 lekë si dhe interesin bankar të kësaj shume deri në datën e ekzekutimit të vendimit.*

Me këtë zgjidhje të dy gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me kërkesa e neneve 2 dhe 6 të K.Pr.Civile.

Sipas nenit 2/1 të K.Pr.Civile *"Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe",* ndërsa sipas nenit 6, *"Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet"*. Në rastin konkret gjykata është vënë në lëvizje nga firma "CICEK" sh.p.k, e cila ka paditur Portin Detar. Mosmarrëveshja e tyre ka lindur lidhur me detyrimin e të padituri për të paguar një shumë të caktuar, që përbën dëmin e krijuar prej mospërmbushjes së detyrimit që rrjedh nga kontrata e depozitës së një sasie mielli prej 100 tonë.

Në çdo rast që shqyrton një padi civile gjykata është e detyruar të shprehet në përfundim të gjykimit lidhur me pranimin ose mospranimin e të gjitha kërkimeve ndaj të padituri të thirrur prej tij.

Është në disponimin e paditësit thirrja me cilësinë e të padituri e personave të tjerë. Gjykata nuk mund të dalë jashtë kufijve procedurialë të gjykimit midis palëve në konflikt. Gjykata, si rregull, nuk mund të krijojë ndërgjyqësi të ndryshme nga ajo që kërkojnë palët.

Në rastin në shqyrtim gjykata ishte e detyruar të shprehej lidhur me kërkimet e paditësit, "CICEK" sh.p.k, kundrejt të padituri, Portit Detar, duke vendosur përfundimisht për pranimin ose rrëzimin e padisë (tërësisht apo pjesërisht). Duke mos u shprehur lidhur me kërkimet e paditësit ndaj të padituri të thirrur prej tij, gjykata, në aspektin procedurial, e ka lënë të pazgjidhur konfliktin midis tyre, ndërsa duke thirrur kryesisht si të paditur "ENGLAND" sh.p.k, e shtetasin Muhamet Balla e duke vendosur detyrimin e "ENGLAND" sh.p.k, ndaj "CICEK" sh.p.k ka dalë jashtë kufijve të gjykimit midis palëve në konflikt. Ajo ka vendosur në favor të firmës "CICEK" sh.p.k, një detyrim të pakërkuar prej saj. Duke vepruar kështu është shkelur parimi procedurial i disponibilitetit të kërkimeve të palëve (neni 6 i K.Pr.Civile).

Paditësi disponon vullnetin e tij nëpërmjet kërkimeve të përcaktuara në mënyrë të shprehur në objektin e padisë, ndërsa i padituri vullnetin e tij e disponon duke pranuar tërësisht ose pjesërisht kërkimet e paditësit, apo duke mos i pranuar ato.

Në një gjykim të filluar i padituri mund të përdorë për t'u mbrojtur, sipas disponimit të tij, mjete të caktuara të cilat i paraqet procedurialisht nëpërmjet prapësimeve apo kundërpadisë.

Prapësimi, si mjet procedurial mbrojtjeje i të padituri ndaj një padie të ngritur kundër tij, parashikohet në mënyrë implicite në nenin 31/2 të K.Pr.Civile, sipas të cilit, "Padia i jep të drejtën palës tjetër kundërshtare për të diskutuar mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi". Nisur nga formulimi i dispozitës së mësipërme, rezulton se i padituri në një gjykim të filluar mund t'i kundrejtojë paditësit arsyet që nga pikëpamja e faktit apo e ligjit, i bëjnë të papranueshme kërkimet e tij të paraqitura me anë të padisë. Në rastin e paraqitjes së prapësimit i padituri nuk del me kërkime të veçanta ndaj paditësit, prandaj gjykimi i çështjes përqendrohet brenda kuadrit të kërkimeve të paditësit të shprehura në objektin e padisë.

Në rastin në shqyrtim kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Porti Detar Shëngjin, përmban pjesërisht tiparet e një prapësimi. Kundrejt kërkimit të paditësit, të paraqitur në objektin e padisë për pagimin e kundërvleftës së sasisë prej 100 ton miell dhe të kamatës përkatëse, i padituri ka paraqitur arsyet që e bëjnë të papranueshëm këtë këkim. I padituri, Porti Detar Shëngjin, ka prapësuar duke pretenduar që midis paditësit "CICEK" sh.p.k, dhe "ENGLAND" sh.p.k, ka pasur një kontratë furnizimi për një sasi miell dhe se sasia prej 100 ton është tërhequr nga shtetasi Muhamet Balla në emër dhe për llogari të "ENGLAND" sh.p.k, sipas porosisë së kësaj të fundit.

Në këto rrethana, në qoftë se pala e paditur do të provonte këtë prapësim, atëherë çështja do të zgjidhej duke rrëzuar padinë.

Në kundërshtim me kërkesat proceduriale të mësipërme, gjykata e ka formuluar ndërgjyqësinë duke i dhënë "CICEK" sh.p.k, cilësinë e paditësit të kundërpaditur, Portit Detar cilësinë e të padituri kundërpaditës, si dhe duke thirrur si të paditur edhe "ENGLAND" sh.p.k e shtetasin Muhamet Balla. Gjykata ka pranuar si objekt të kundërpadisë: "Rrëzimin e padisë së firmës "CICEK" sh.p.k e pagimin e shumës përkatëse të 100 ton miell", pa përcaktuar se nga kush kërkohet ky detyrim dhe në favor të kujt.

Formimi i ndërgjygjësisë si më sipër, ecuria e gjykimit dhe mënyra e vendosjes së detyrimit me vendimin përfundimtar përbëjnë shkelje të rëndë të rregullave proceduriale dhe shkak absolut për cënimin e vendimeve.

Kundërpadia nuk mund të ngrihej. Kërkesa e paraqitur dhe e pranuar nga gjykata nuk i plotëson nga pikëpamja formale elementet përbërës të një kundërpadie, në kuptim të nenit 160 të K.Pr.Civile.

Sipas nenit 160/1 të K.Pr.Civile, "I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë, ose kur midis tyre mund të bëhet kompensim".

Në kuptim të dispozitës së mësipërme, kundërpadia është padia e të padituri që drejtohet kundër paditësit, e paraqitur në një gjykim të filluar, deri sa nuk ka përfunduar hetimi gjyqësor. Që padia e të padituri kundër paditësit të cilësohet si kundërpadi dhe të pranohet të gjykohet së bashku me padinë në gjykimin e filluar duhet të plotësojë të paktën njërin nga dy elementët substanciale të kërkuar nga neni 106/1 i K.Pr.Civile, lidhjen (koneksitetin) midis kërkimeve dhe/ose mundësinë e kompensimit (ndërshlyerjes) të detyrimeve të ndërsjellta. Duke qenë se si padia dhe kundërpadia mund të trajtohen secila si padi më vete në gjykime të veçanta, sipas çmimit të gjykatës, kuptohet që kur gjykohen së bashku në një gjykim të vetëm, në vendimin përfundimtar eventualisht mund të vendoset: a) Pranimi i padisë dhe i kundërpadisë, duke vendosur, kur është rasti, edhe kompensimin e detyrimeve të ndërsjellta; b) pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë; c) rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë; ç) rrëzimin e padisë dhe të kundërpadisë.

Në rastin konkret gjykata nuk ka vendosur dhe nuk mund të vendoste në asnjërën nga mënyrat e mësipërme.

Gjithashtu kur gjykohen së bashku një padi e një kundërpadi, bazuar në vendimin procedurial për bashkimin e tyre në një çështje të vetme (neni 55 i K.Pr.Civile), si rregull, nuk mund të thirren si paditësa apo të paditur edhe persona të tjerë, me kërkime të pavarura nga ato të përcaktuara në objektin e padisë e në objektin e kundërpadisë. Këta persona mund të thirren për t'u bashkuar proceduralisht në kërkime të përbashkëta me paditësin e kundërpaditur ose me të padituri kundërpaditës vetëm kur janë kushtet e krijimit të bashkëndërgjyqësisë sipas neneve 161-162 të

K.Pr.Civile.

Në rastin në shqyrtim nuk kemi të bëjmë as me ndërhyrje kryesore dhe as dytësore të personave të tretë në një gjykim civil (neni 181-191 të K.Pr.Civile). ndërhyrja e personit të treët bazohet në vullnetin e disponimin e tij dhe nuk kërkohet nga palët apo urdhërohet kryesisht nga gjykata. Në këtë rast nuk ndodhemi as edhe përpara thirrjes së personit të tretë në kushtet e neni 192 të K.Pr.Civile sipas kësaj dispozite, "secila palë mund të thërrasë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen, ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim që lidhet me përfundimin e çështjes". "ENGLAND" sh.p.k dhe shtetasi Muhamet Balla, nuk legjitimohen për t'u thirrur në mënyrë të detyruar si persona të tretë në gjykimin e filluar midis "CICEK" sh.p.k dhe Portit Detar Shëngjin.

Personi i tretë, për të cilin pala që e thërret mendon se e ka të përbashkët çështjen, mund e duhet të thirret si bashkëndërgjyqës me të kur plotësohen kriteret e bashkëndërgjyqësisë të parashikuara në nenin 161 të K.Pr.Civile, të cila janë: a) ekzistenca e të drejtave ose detyrimeve të përbashkëta mbi objektin e padisë; b) situata juridike sipas të cilës të drejtat dhe detyrimet e tyre nga pikëpamja e faktit ose e ligjit kanë po atë bazë.

Sipas nenit 192 të K.Pr.Civile, personi i tretë mund të thirret edhe nga pala që mendon se prej tij mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes (rastet e denoncimit të padisë personit të tretë).

Në kushtet e nenit 192 të K.Pr.Civile, personi i tretë thirret nga pala përkatëse për t'u bashkuar me të në të njëjtën pozitë proceduriale, nisur nga një marrëdhënie juridike e përbashkët me të dhe me palën tjetër në konflikt. Në rastin konkret "ENGLAND" sh.p.k nuk mund të bashkohet në një pozitë proceduriale me Portin Detar d.m.th, si bashkë të paditur nga "CICEK" sh.p.k, sepse jo vetëm paditësi nuk e ka kërkuar një gjë të tillë, por edhe sepse marrëdhënia juridike që mund të jetë krijuar midis Portit Detar nuk ka lidhje me marrëdhëniet juridike që mund të jenë krijuar midis Portit Detar me "ENGLAND" sh.p.k, apo subjekte të tjera. Pa pëlqimin e paditësit i padituri nuk mund t'ua kalojë detyrimin subjekteve të tjera.

Nisur nga arsyetimet e mësipërme, duke qenë se gjykatat nuk i kanë dhënë zgjidhje konfliktit midis palëve në padi, "CICEK" sh.p.k dhe Porti Detar, çështja duhet të kthehet për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë Lezhë. Kjo gjykatë duhet të shprehet nëse padia është e bazuar në prova e në ligj e duhet të pranohet d.m.th, nëse është i mbështetur ligjërisht dhe provohet pretendimi i paditësit sipas të të cilit sasia e miellit prej 100 ton padrejtësisht i është dorëzuar shtetasit Muhamet Balla, i cili as ka qenë me ndonjë detyrë zyrtare pranë "ENGLAND" sh.p.k dhe as është autorizuar prej saj, apo prej vetë "CICEK" sh.p.k për tërheqjen e mallit. Në këto rrethana konkludohet se pala e paditur, në mënyrë të kundërligjshme e me faj (neglizhencë) i ka shkaktuar "CICEK" sh.p.k, një dëm efektiv kontraktor të cilin do të duhet të detyrohet ta shpërblejë. Përsa u përket kamatave asnjëra prej gjykatave nuk është shprehur për bazën faktike dhe ligjore të kërkimit të tyre.

Por, në rigjykim, krahas kërkimit paditësit "CICEK" sh.p.k, të bazuar në kontratën e depozitës të lidhur midis palëve, gjykata duhet të marrë në shqyrtim edhe prapësimin e të paditurit Portit Detar Shëngjin, sipas të cilit paditësi "CICEK" sh.p.k, sasinë e miellit prej 250 ton, ku përfshihet edhe sasia prej 100 ton që përbën objektin e padisë, ia ka shitur "ENGLAND" sh.p.k, me kontratën e lidhur midis tyre datë 21.7.1994. Për këtë duhet të administrohen e vlerësohen si prova kontrata e shitjes midis shitësit "CICEK" sh.p.k, dhe blerësit "ENGLAND" sh.p.k, datë 21.7.1994 si dhe fatura nr.6, datë 21.7.1994.

Në bazë të legjislacionit civil të kohës gjykata duhet të vlerësojë vlefshmërinë e kontratës së shitjes, si dhe nëse pronësia e mallit të shitur i ka kaluar blerësit "ENGLAND" sh.p.k, dhe cili është çasti i kalimit të pronësisë. Në qoftë se rezulton që me këtë kontratë shitjeje malli i është dorëzuar blerësit "ENGLAND" sh.p.k, në depot e depozitarit dhe pronësia e tij i ka kaluar blerësit, atëherë kontrata e depozitimit datë 20.6.1994 e lidhur midis depozituesit firmës "CICEK" sh.p.k dhe depozitarit, Portit Detar Shëngjin quhet e përfunduar. Për rrjedhojë marrëdhëniet juridike të lindura më vonë midis Portit Detar Shëngjin, "ENGLAND" sh.p.k, shtetasit Muhamet Balla etj, nuk i interesojnë këtij gjykimi të filluar mbi bazën e padisë së "CICEK" sh.p.k

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485 të K.Pr.Civile,

VENDOSËN

1. Prishjen e vendimit nr.1067, datë 19.9.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, e vendimit nr.6278, datë 20.11.1996 të gjykatës së Apelit Tiranë, e vendimit nr.539,datë 30.8.1996 të gjykatës së rrethit Lezhë dhe dërgimin e çështjes për gjykimin e padisë së "CICEK" sh.p.k kundër Portit Detar Shëngjin në gjykatën e rrethit gjyqësor Lezhë.

Pushimin e gjykimit të kundërpadisë nr.112 Prot, datë 24.2.1996 të Portit Detar Shëngjin kundër "CICEK" sh.p.k, "ENGLAND" sh.p.k, dhe shtetasit Muhamet Balla, sepse kërkimi i Portit Detar nuk mund të ngrihet në formë kundërpadie (neni 299, pika "C" dhe neni 468 i K.Pr.Civile).

2. Ky vendim për njehsimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botin në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 14.7.2000
Nr.1803 e Regj.Themeltar
Nr.901 i Vendimit

KËRKESË

Kërkuese: Floresha Abduramani e bija e Aliut dhe Zenepes, lindur më 1963 në Berat, banues në Darzez Fier.

Objekti: Shpallje të zhdukur të bashkëshortit Nazmi Abduramani në bazë të N.375 e vijues të K.Pr.C.

Gjykata pasi administroi aktet, dëgjoi pretendimet e kërkueses dhe shqyrtoi çështjen në tërësi.

Floresha Abduramani kërkon që të shpallet i zhdukur bashkëshorti i saj.

Nazmi Abduramani në datën 13.11.1991 është nisur në drejtim të Italisëë së bashku me disa shtetas të tjerë duke udhëtuar me gomone. Që nga ajo datë familjarët e tij nuk kanë dijeni për të. Ata janë interesuar nëpërmjet Kryqit të Kuq Shqiptar dhe Italian por nuk kanë asnjë informacion. Në këto rrethana gjykata pasi dëgjoi dëshmitarët rezultoi se shtetasi Nazmi Sulo Abduramani duhet të shpallet i zhdukur.

Sa më sipër dolën të provuar nga aktet e administruara në seancën gjyqësore.

KËKUESE
Floresha Abduramani

KËRKESË

Kërkuese: Margarita Dhoska, e bija e Mistos dhe Dhoksisë, lindur më 1930 në Përmet, banuese në Patos.

Objekti: Shpall të vdekur shtetasin Nastas Dhoska në bazë të N.375 e vijues të K.Pr.C e N.15 e vijues të K.C.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e kërkueses administroi provat dhe shqyrtoi çështjen në tërësi.

Kërkuesja Margarita Dhoska kërkon të shpallë të vdekur vjehrrin e saj.

Në vitin 1926 ai është larguar në shtetin Turk për emigrim ekonomik.

Ka mbi 20 vjet që familjarët e Nastasit nuk kanë asnjë të dhënë mbi ekzistencën e tij. Pretendimet kërkuesja i provon me thëniet e dëshmitarëve Sokrat Pitushi e Sotir Mitro, bashkëfshatarë të shtetasit Nastas Dhoska. Gjithashtu kërkuesja i ka paraqitur gjykatës dhe çertifikatën në bazë të cë cilës Nastasi figuron i datëlindjes 7.3.1900.

Në këto rrethana gjykata konkludoi të shpallë të vdekur shtetasin Nastas Dhoskë Dhoska në dt.31.12.1970.

KËRKUESJA
Margarita Dhoska

U dorëzua për shtyp më 4.8.2000
Doli nga shtypi më 4.8.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 200 lekë